Perspektivat islame rreth shkencës

DIJA DHE PËRGJEGJËSITË

Perspektivat islame rreth shkencës

DIJA DHE PËRGJEGJËSITË

Kuruar prej Ali Ünal

PRIZMI

* Titulli i origjinalit: *Islamic Perspectives on Science*
-Knowledge and responsibility-

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara

Ndalohet shumëfishimi, botimi, fotokopjimi dhe depozitimi elektronik, mekanik apo me anë të ndonjë sistemi tjetër regjistrimi i teksteve dhe figurave të krejt librit apo të një pjese të tij, pa leje me shkrim nga shtëpia botuese.

KURUAR PREJ ALI ÜNAL

PERSPEKTIVAT ISLAME RRETH SHKENCËS

- Dija dhe Përgjegjësitë -

Përktheu: Dritan Hoxha
Redaktoi: Silvester Manaj

ISBN: 978-9928-156-14-3

Design: Indrit Isufi

Shtëpia Botuese "PRIZMI"
Adresa: Rr. Abdi Toptani
Torre Drin
K. 11, Nr. 112, Tiranë
www.prizmi.com

Tiranë, 2014

PËRMBAJTJA

Autorët 7

Parathënie 10

Islami dhe shkenca: Një vështrim i përgjithshëm / Abasi Kiyimba 15

- Parashtrimi i problemit 15
- Identifikimi i çështjes 17
- Shkenca nuk është diçka e huaj për botën myslimane 18
- Shkencëtarët myslimanë përgjatë historisë 21
- Konflikti shkencë-fe: realitet apo mit? 23
- Shkenca në Kuran 25
- Myslimanët dhe problemet e parashtruara prej shkencës moderne 32
- Realizueshmëria e një shkence islame 37
- Një pikë e mundshme takimi 39
- Përfundim 42
- Burime shtesë 44

Shkenca dhe feja / M. Fethullah Gülen & Ali Ünal 46

- Shkenca dhe feja 46
- Qytetërimi që krijoi Islami 46
- Shkenca dhe qasja moderne shkencore 50
- Konflikti mes fesë dhe shkencës 54
- A përmban Kurani gjithçka? 60
- Koncepti i shkencës dhe teknologjisë 64
- Dy fusha të ndryshme për shkencën dhe fenë? 69
- Dualizmi kartezian 70
- Natyra shfaq Unicitetin Hyjnor 73
- Çfarë domethënieje ka urdhri "Lexo?" 77
- A aludon Kurani në lidhje me zhvillimet shkencore? 79
- Shembuj 83
- Përse i referohemi shkencës dhe fakteve shkencore? 96

Rastësia dhe botëkuptimi Kuranor / Yamime Mermer 102

Çfarë domethenieje ka guri që bie nga lart? / Salih Atkin 112

Universi nën dritën e fizikës moderne / Salih Adem 119

Feja dhe shkenca: Përgjegjësitë përbashkëta / M. Saif Islam 125

- Qëllimi i shkencës 125
- Shkenca pa fe, feja pa shkencë 126
- Shkenca dhe shfrytëzimi 129
- Qëndrimi Islam ndaj shkencës 131
- "Beso, që të kuptosh!" 133
- Një mentalitet i dominimit 137
- Një teori fushe e njësuar 139

Referencat 140

Degradimi mbarë-botëror prej materializmit shkencor /Suat Yildirim 141

Matematika është reale: pse dhe si? / Bayram Yenikaya 147

- Gjuha e numrave 147
- Çfarë na zbulojnë lulet? 151

Shënime 153

AUTORËT

ABASI KIYIMBA i diplomuar në Universitetin Makerere në Ugandë, kreu studimet pasuniversitare në Shkollën e Studimeve Orientale dhe Afrikane në Bantu (Londër) në degën e Folkloristikës, dhe tani jep mësim në Universitetin Makerere.

M. FETHULLAH GYLEN është një dijetar islam si dhe mendimtar e veprimtar i shquar në fushën e dialogut ndërfetar dhe në promovimin e arsimit.

ALI ÜNAL ka studiuar për Teologji dhe Gjuhë e Letërsi Angleze, si dhe ka dhënë mësim në lëndën e gjuhës angleze për shumë vite me radhë në gjimnaze të ndryshme. Ai shkruan për gazetën e përditshme turke "Zaman" dhe aktualisht kryen edhe funksionin e redaktorit; njëkohësisht shkruan artikuj për revistën "The Fountain", si dhe merret me përkthimin në anglisht të veprave më të rëndësishme turke në fushat e fesë, shkencës dhe kulturës. Ai është autor i disa librave në këto fusha, vepra këto të botuara, si në turqisht ashtu edhe në gjuhën angleze.

YAMINE MERMER është diplomuar në Universitetin Algjer për Fizikë Teorike dhe ka kryer punimet e saj pasuniversitare për titullin Master i Shkencave dhe atë të doktoraturës në Universitetin "Durham", në Mbretërinë e Bashkuar. Komunikon rrjedhshëm në arabisht, frëngjisht, anglisht dhe turqisht, dhe ka përkthyer dhe botuar materiale në disa gjuhë.

SALIH ADEM është dy herë fitues i medaljes së artë në Olimpiadën Ndërkombëtare të Fizikës (IPHO) (në 1993, SHBA dhe 1995, Australi) si dhe fitues i çmimit special si pjesëmarrësi më i ri në historinë e IPHO (1992). Ai ka marrë pjesë në 4 olimpiada

ndërkombëtare të fizikës radhazi (një rekord botëror). Ai zotëron një titull Master i Shkencave në Biofizikë (Universiteti i Illinois në Urbana Champaign) dhe një Master i Arteve në Filozofi prej Universitetit të Maryland-it.

M. SAIF ISLAM mori titull Master i Shkencave dhe u doktorua në Inxhinieri Elektrike nga Universiteti i Kalifornisë, Los Angeles (UCLA), respektivisht në vitin 1999 dhe 2001. Dr. Islam është studiuesi kryesor i Nano-pajisjeve të integruara dhe sistemeve kërkimore (i-nano) në UC Davis, dhe është autor ose bashkëautor i më shumë se 70 artikujve dhe punimeve të paraqitura nëpër konferenca, si dhe zotëron dy patenta shpikjesh me më shumë se 30 patenta të tjera si shpikës ose bashkëshpikës, në pritje për t'iu njohur.

SUAT YILDIRIM është një nga teologët më në zë të Turqisë. Ai ka shërbyer si myfti përpara se të vijonte një karrierë të shquar akademike, si pedagog dhe shkrimtar. Ai aktualisht jep mësim në Universitetin Marmara, Stamboll, si profesor i Interpretimit. Përkthimi i tij i Kuranit përbën një nga interpretimet më popullore të botuara ndonjëherë në gjuhën turke.

BAJRAM YENIKAYA zotëron një doktoraturë në matematikë nga Universiteti i Minesotës. Ai përfaqësoi ekipin kombëtar të Turqisë në Olimpiadën Ndërkombëtare të Matematikës në Kanada, 1996, ku fitoi medaljen e argjendtë.

PARATHËNIE

Kjo përmbledhje esesh, synon t'i japë pak shpresë dhe kuptim rolit të shkencës moderne. Shkenca e sotme i ka shkëputur lidhjet me moralin dhe fenë, e madje edhe me kulturën e përgjithshme të shoqërive tona, përkundrejt faktit se jeta jonë e përditshme është tejet e ndikuar nga teknologjia që bën të mundur kjo shkencë. Njerëzit në përgjithësi mendojnë se shkenca ka rregullat dhe ecurinë e saj, e ndoshta edhe një vullnet të vetin, duke neglizhuar faktin se ajo është çështje e vullnetit të qenieve njerëzore racionale, të cilët mund të zgjedhin vetë për çfarë ata dëshirojnë të studiojnë dhe mënyrën se si ata mendojnë t'i zbatojnë në praktikë dijet dhe njohuritë e tyre.

Rrjedhimisht, krahas mrekullimit që ndiejnë kur vërejnë arritjet shkencore dhe mirënjohjes për faktin se teknologjia u ka mundësuar një jetë më të lehtë, njerëzit ushqejnë një lloj ankthi të caktuar në lidhje me shkencën dhe teknologjinë. Për shembull, ata kanë frikë se metodat e reja të mbarështimit të kafshëve dhe përpunimit të ushqimeve, herët a vonë do të shkaktojnë diçka të dëmshme për jetën e njeriut, diçka që do të gjenerojë plagë dhe sëmundje të tmerrshme. Ata shqetësohen se ndryshimet klimatike do të ndikojnë dallimet stinore dhe të ndryshojnë rrënjësisht ciklet jetësore të krijesave të vogla të panumërta, të cilat ose do të vdesin ose do të riprodhohen tej normave dhe në këtë mënyrë do ta shkatërrojnë në mënyrë të pandreqshme ekuilibrin ekologjik të një rajoni të caktuar. Ata kanë frikë se diku në ndonjë cep të botës, disa shkencëtarë, pavarësisht çdo ndalese ligjore, do të prodhojnë një organizëm identik të qenieve njerëzore për qëllime përfitimi, pavarësisht nga pasojat negative të pallogaritshme për

marrëdhëniet juridike dhe morale midis prindërve dhe fëmijëve, vëllezërve dhe motrave, si dhe për përjetimet psikologjike dhe emocionale që rezultojnë nga këto marrëdhënie.

Këto dhe lloje të tjera frikërash karakteristike, përbëjnë elementin kryesor të tematikës së librave dhe filmave me subjekt shkencën, shumica prej të cilave dalin përpara njerëzimit me hipotezën e një të ardhmeje të tmerrshme dhe të frikshme. Por akoma edhe më i madh se të gjitha këto lloje frikërash, është paniku i përgjithshëm në lidhje me idenë se shkenca dhe teknologjia janë në njëfarë mënyre të pandalshme. Qeveritë mund të caktojnë komisione për të diskutuar mbi etikën biomjekësore dhe komitete të cilat imponojnë gjoba për degradimin e mjedisit e kështu me radhë, por një gjë është e sigurtë, se shkencëtarët do të vijojnë me projektet e tyre. Përveç kësaj, konkurrenca ekonomike është ajo që është, eksperimentet dhe zbulimet shkencore do të vazhdojnë të gjejnë rrugën e tyre në teknologji dhe në jetën tonë, qoftë për mirë apo për keq.

Në thelb, ky panik i përgjithshëm rreth shkencës dhe teknologjisë, është në fakt një frikë e fuqisë sonë unike për ta kuptuar dhe për të ndërhyrë në natyrë. Shpesh duket sikur shkenca dhe teknologjia janë autonome dhe përgjigjen vetëm për proceset, rregullat, dhe projektet e tyre. Duke parë këto zhvillime, ne pyesim veten nëse ata janë duke e ushtruar me përgjegjësi rolin e tyre, dhe natyrshëm na lindin pyetje të tilla si: A janë të lidhura me autoritetin moral këto procese? A mund të rregullohen këto zhillime nëpërmjet një autoriteti politik? Cilat janë qëllimet e tyre të veçanta? A thua njerëzit që qëndrojnë prapa shkencës dhe teknologjisë bëjnë atë që duan dhe që kanë mundësi ta bëjnë, pavarësisht nëse ne e duam një gjë të tillë ose jo? Parimi me sa duket është: në qoftë se diçka është e mundur të bëhet, do të bëhet, pavarësisht kundërshtimeve tona apo pakënaqësive morale. Ndoshta, (duke huazuar një shembull nga mitologjia e lashtë greke), ne vodhëm dijen dhe fuqinë që shkenca dhe teknologjia na mundëson që të kemi, dhe duke e konsideruar veten si hajdutë fajtorë, jemi të frikësuar se

do të kapemi dhe ndëshkohemi për atë që kemi bërë. Me fjalë të tjera, paniku ynë i përgjithshëm ka të bëjë me këtë ndjenjë faji që përjetojmë.

Secili prej nesh është i pajisur me ndërgjegje dhe me aftësinë për të reflektuar dhe për t'u shprehur. Si qenie reflektive, ne kuptojmë se ne kemi një nevojë të thellë për një dimension moral të ekzistencës sonë, si dhe për njohjen e qëllimit të epërm të kësaj ekzistence. Ideja e klonimit të njerëzve e tmerron shumicën prej nesh, sepse ajo e bën të pakuptimtë vdekjen. Nëse ekzistenca e secilit prej nesh do të mund të përsëritej, "jeta" jonë nuk do të përfundonte kurrë. Pa një fund, nuk mund të ketë asnjë qëllim, konkluzion, apo largim përfundimtar. Mundësia reale e jetës së përjetshme në këtë tokë, papritmas na bën të kuptojmë se ne në të vërtetë nuk e duam atë. Ajo që ne duam vërtet është të kuptojmë dhe të arrijmë t'i japim domethënie jetës sonë.

Këndvështrimi tradicional fetar është se një periudhë e kufizuar dhe e përkohshme e jetës në Tokë përbën një bekim, dhe se vdekja është një derë që të shpie drejt përsosmërisë së mundshme në një formë tjetër të jetës, një përsosmëri që është edhe e pamundur dhe e pakonceptueshme të arrihet në këtë botë. Nëse ne e mbyllim atë portë, e kemi lënë veten jashtë kësaj shprese për përsosmëri, duke mbetur në mënyrë të përhershme brenda gjithë këtij konfuzioni, mungese përsosmërie, gjithë këtyre mizorive, padrejtësive, dështimeve dhe zhgënjimeve të jetës sonë aktuale.

Ndërmarrjet e shkencës moderne, rregullat e saj, proceset dhe perspektivat teknologjike, me sa duket janë vetëm dukuri globale. Kjo është ndoshta pjesa më e rëndësishme dhe më e fuqishme e kulturës moderne perëndimore. Themi globale, sepse për gati tre shekuj me rradhë, qytetërimi perëndimor ka ushtruar një shkallë të paparë dominimi ushtarak dhe ekonomik ndaj të gjitha shoqërive, kulturave dhe qytetërimeve të tjera. Gjatë kësaj periudhe, qytetërimi perëndimor ka qenë i distancuar nga traditat e veta fetare dhe morale duke lëvizur kështu drejt iluzionit të krijimit të një shkalle gjithnjë e më të gjerë të lirive të individit, në mënyrë

që ai të përzgjedhë se cili autoritet intelektual ose moral është më i këndshëm për të.

Në shoqëritë më të përparuara perëndimore, si dhe ato pjesë të shoqërive joperëndimore të cilat e kanë pranuar dhe imituar Perëndimin në çdo aspekt, feja e institucionalizuar ka mbijetuar duke iu dashur të bëjë kompromis me këtë tendencë. Megjithatë, ndjekja e kësaj rruge, e ka bërë fenë edhe më të ngushtë, më personale dhe private, sa puna ka arritur deri aty që praktikisht funksioni i saj publik është vetëm për të ruajtur disa gjurmë të një lidhjeje me të kaluarën, ose ka mbetur si shenjë e një identiteti kolektiv kombëtar apo kulturor.

Është një çështje parimi fakti se kërkimi shkencor nuk i detyrohet asgjë autoriteteve fetare, të dikurshme apo të sotme, por nga ana tjetër, prej tij nuk duhet bërë ndonjë supozim tjetër përveç supozimeve minimale të nevojshme metodologjike për të kryer një studim të disiplinuar. Mbi të gjitha, shkenca nuk duhet të bëjë asnjë supozim rreth origjinës ose qëllimit përfundimtar të fenomeneve për të cilët ajo heton, sepse detyra e saj e vetme është për të gjetur se si funksionojnë gjërat dhe mënyrën sipas së cilës funksionimi i një gjëje, ndikon në funksionimin e një gjëje tjetër. Nuk është për t'u habitur që fryti më i qëndrueshëm i një qasjeje të tillë studimore është fuqia teknologjike, për arsye se të kuptuarit dhe aftësimi në lidhje me disa efekte të shkaktuara, na jep një përparësi mekanike mbi to. Një avantazh i tillë, na lejon pastaj të llogarisim dhe të manipulojmë mjaftueshëm secilin nga proceset e përfshira në studim, me qëllim përfitimin afatshkurtër, kudo dhe kurdoherë të na nevojitet.

Megjithatë, pavarësisht dështimit të qytetërimit modern perëndimor për të përmirësuar në mënyrë të ndjeshme mirëqenien tonë në çdo sferë tjetër përveçse në aspektin fizik dhe material, njerëzit në përgjithësi besojnë se nuk ekziston tjetër alternativë. Ne ose e pranojnë mënyrën perëndimore të qasjes ndaj shkencës dhe mënyrat e të menduarit dhe të jetuarit që janë në përputhje me të, ose mundohemi t'i shmangim këto zhvillime. Në qoftë

se zgjedhim këtë të fundit, ne e dënojmë veten për të pasur një mënyrë jetese të kufizuar dhe primitive, e cila nuk hyn në marrëdhënie tregtare dhe kulturore me shoqëritë e tjera, që do të thotë se vetë jeta jonë intelektuale dhe kulturore e humbet dinamizmin e vet dhe qëndron në vendnumëro.

Shënim: Të gjitha referencat që identifikojnë njerëz, apo që shpjegojnë konceptet janë marrë nga www.brittanica.com, përveç rasteve kur jepet veçanërisht burimi përkatës.

ISLAMI DHE SHKENCA: NJË VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Abasi Kiyimba

Parashtrimi i problemit

Marrëdhënia mes të Islamit dhe shkencës ka qenë një pikë qendrore e debateve dhe polemikave mes dijetarëve që prej një periudhe mjaft të gjatë kohore. Në vitin 1983, Jameelah e sulmoi kështu shkencën moderne:

> Shkenca moderne nuk udhëhiqet nga asnjë vlerë morale, por nga mate-rializmi i zhveshur dhe arroganca. E gjithë sfera e dijes, ashtu si edhe fushat e saj të zbatimit, janë kontaminuar nga e njëjta e keqe. Shkenca dhe teknologjia janë krejtësisht të varura mbi bashkësinë e idealeve dhe vlerat e ushqyera nga anëtarët e saj. Nëse rrënjët e një pemë kalben, atëherë kalbet e gjithë pema; prandaj të gjitha frytet e saj janë të kalbura.[1]

Gati 700 vjet më parë, dijetari i njohur mysliman Imam el-Gazaliu,[2] kishte shprehur frikën se qartësia dhe saktësia e demonstrimeve matematikore, mund t'i çojë ata që i studiojnë ato (në mënyrë sipërfaqësore), të mohojnë cilësitë e Allahut. Kundërshtimi i tij nuk kishte të bënte me matematikën si shkencë, por me pasojat e saj të mundshme, siç vërehet në fragmentin e mëposhtëm:

> Edhe pse gjeometria dhe aritmetika nuk përmbajnë nocione që janë të dëmshme për besimin fetar, unë prapseprapë kam frikë se dikush mund të tërhiqet nëpërmjet tyre drejt doktrinave që janë të rrezikshme.[3]

Pikëpamje të ngjashme janë shprehur edhe nga studiues të ndryshëm, secili sipas bindjeve të tij dhe kohës në të cilën ka jetuar. Por, siç pritet, nuk ekziston ndonjë konsensus mes dijetarëve myslimanë mbi

këtë temë. Jamal al-Din el-Afgani[4] është shprehur haptazi:

> Ata që ndalojnë shkencën dhe dijen në fe me argumentin se janë duke mbrojtur fenë islame, në të vërtetë janë duke u sjellë si armiq të kësaj feje. Feja islame është më e afërt se çdo fe tjetër me shkencën dhe dijen, dhe nuk ka asnjë mospërputhje ndërmjet shkencës e dijes dhe shtyllave kryesore të fesë islame.[5]

Seyed Ahmed Khan,[6] një dijetar mysliman, i cili ka shprehur një qëndrim të ngjashëm, megjithëse më të butë, ka deklaruar se shkenca është vepër e Allahut, të cilën herë pas here shkencëtarët kanë nderin ta kuptojnë:

> Unë jam plotësisht i bindur se Vepra dhe Fjala e Allahut nuk mund të jetë kurrsesi antagoniste me njëra-tjetrën; ka raste kur për faj të njohurive tona të pamjaftueshme, ndonjëherë ndodh të bëjmë gabime në të kuptuarët e thelbit të Fjalës Hyjnore.[7]

Në ditët tona, Sardar ka shprehur një pikëpamje, e cila gëzon popullaritet të konsiderueshëm në mesin e dijetarëve bashkëkohorë dhe liderëve të opinionit publik mysliman:

> Ndërsa shkenca në vetvete është neutrale, është qëndrimi me të cilin ne i qasemi shkencës ai që e bën atë laike apo islamike. Qasja islame i njeh kufizimet e mendjes dhe arsyes njerëzore, dhe pranon që e gjithë dija është pronë e Zotit.[8]

Të tilla pikëpamje dhe të tjera si këto, tregojnë se dijetarët myslimanë nuk pajtohen në lidhje me idenë se çfarë qëndrimi duhet të mbajë Islami në drejtim të shkencës moderne. Debati kohët e fundit është zhvendosur nga refuzimi i zbulimeve shkencore si "të rrezikshme" për Islamin, në kërkimin e mënyrave më të përshtatshme të bashkëekzistencës së tij me shkencën moderne. Këndvështrimet variojnë që nga pranimi i përgjithshëm i metodave dhe paradigmave perëndimore, e deri në një refuzim total të tyre, dhe thirrjet për krijimin e një shkence alternative islame. Ky debat ka angazhuar si dijetarët myslimanë ashtu edhe ata jomyslimanë.

Identifikimi i çështjes

Në këtë artikull, unë jam përpjekur të trajtoj mënyrën se si Islami i qaset shkencës moderne, duke u përpjekur që të paraqes një sfond në lidhje me debatin aktual përsa i përket kësaj çështjeje. Probleme të tilla mund të shërbejnë si referencë, për diskutime, debate apo studime të ndryshme. Përveç kësaj, meqenëse pikëpamjet tona rreth Islamit dhe shkencës ndryshojnë sipas kohës dhe vendit, unë do t'i përkufizoj ato në vijim.

Islami është një besim fetar dhe mënyrë jetese që ia atribuon gjithë fuqinë dhe rregullin Qenies Supreme, Zotit, i Cili ka krijuar çdo gjë dhe na ka urdhëruar për të adhuruar vetëm Atë. Ai e ka udhëzuar njerëzimin nëpërmjet Librit të Tij, Kuranit, si dhe nëpërmjet të Dërguarve të Tij dhe profetëve, prej të cilëve Profeti Muhammed është i fundmi.[9] Islami i ofron sukses njerëzimit si në këtë botë ashtu edhe në botën tjetër, nëpërmjet një pakete e cila përfshin paqen dhe mirëqenien ndërmjet çdo personi dhe Zotit, si dhe midis çdo personi dhe fqinjit të tij ose të saj. Ai na mëson rrugën për të nxjerrë përfitim nga çdo gjë që përmban krijimi, duke qenë njëkohësisht të vetëdijshëm për fatin tonë shpirtëror. Islami pra, ofron një kod të plotë të udhëzimeve morale, shoqërore, politike, ekonomike si dhe një gamë të gjerë çështjesh të tjera.

Shkenca është një pjesë e njohurive që kemi fituar përmes vëzhgimit dhe analizës. Termi është mjaft i gjerë, për shkak se pothuajse çdo degë e hulumtimit dhe studimit të njeriut, mund të quhet një shkencë. Duke pasur parasysh këtë, ne mund të flasim në lidhje me shkencat fetare dhe sociale. Në këtë punim, unë kam përdorur termin shkencë për të paraqitur shkencat fizike, qofshin ato teorike apo aplikative, të cilat përdorin eksperimentimin konsistent, vëzhgimet dhe që nxjerrin përfundime, në një përpjekje për të kuptuar universin fizik dhe material. Një marrëdhënie e tillë mes shkencës dhe Islamit, është çështja thelbësore e këtij debati.

Gjendja aktuale e shkencës në botën islame ka qenë një pikë

kyçe në disa nga këto diskutime. Në disa raste, studiues të tillë si Hoodbhoy, kanë arritur në përfundime tepër të pasakta rreth Islamit dhe shkencës.[10] Për të qenë të drejtë në vlerësim, ne duhet t'i kujtojmë vetes sonë se gjendja e shkencës në botën e sotme myslimane, nuk reflekton pozitën e lartësuar që Islami i jep shkencës dhe formave të tjera të dijes. Në të kaluarën, udhëheqësit myslimanë e kanë trajtuar kërkimin shkencor si një përparësi dhe kanë siguruar nxitje dhe lehtësira për shkencëtarët, duke sjellë si rezultat një lulëzim të shkencës në mbarë tokat myslimane. Kështu, kjo periudhë e prosperitetit shkencor përbën një pjesë të domosdoshme të sfondit në këtë diskutim.

Shkenca nuk është diçka e huaj për botën myslimane

Shkenca moderne është paraqitur shpeshherë si një diçka huaj me të cilën Islamit i duhet të përshtatet, ose për të cilën duhet gjetur një vend në Islam, si një domosdoshmëri e diktuar nga ndryshimi i periudhave kohore. Prandaj është e nevojshme të theksohet fakti se historia islame regjistron një mori shembujsh veprimtarish shkencore nga shkencëtarët myslimanë, të cilët ishin njëkohësisht edhe teologë edhe filozofë të shquar të fesë islame. Ghiles vëren se:

> Në kulmin e vet, pra rreth një mijë vjet më parë, bota myslimane dha një kontribut të çmuar për shkencën, matematikën e avancuar dhe mjekësinë. Bagdadi në kulmin e tij dhe Spanja Jugore ndërtuan universitete në të cilat u dyndën me mijëra njerëz. Sundimtarët e rrethuan veten me shkencëtarë dhe artistë.[11]

Kjo meritë është një nga të shumtat që studiuesit perëndimorë po ia njohin, megjithëse me mjaft vonesë, qytetërimit mysliman. Sarton shprehet:

> Që nga gjysma e dytë e shekullit të tetë e deri në fund të shekullit të njëmbëdhjetë, arabishtja ishte gjuha e shkencës dhe e progresit për mbarë njerëzimin [...], kujtdo që dëshironte të ishte i mirëinformuar me të rejat më të fundit, i duhej të studionte arabisht...[12]

Ai, mandej, paraqet një listë të gjatë të shkencëtarëve mys-

limanë, të cilët mbartnin pishtarin e qytetërimit, ndërsa, sipas fjalëve të Hoodbhoy, "evropianët ishin të zënë me nxjerrjen e zorrëve të heretikëve ."[13] Duke cituar punën e një shkencëtari mysliman, Sarton shkruan në vijim në lidhje me përkthimit nga ana e Robertit të Chester-it të veprës së el-Khuarizmit[14]: "Vështirë të quhet ekzagjerim rëndësia e këtij përkthimi të veçantë. Ajo mund të thuhet pa frikë se shënon fillimin e algjebrës evropiane."[15]

Gandz e përpunon edhe më tej shpjegimin rreth idesë së borxhit që shkenca moderne i ka qytetërimit islam:

> Jemi mjaft të vonuar në njohjen e algjebrës se Al - Khuarizmit si baza dhe guri themeltar i shkencës. Në njëfarë kuptimi, është më e drejtë të quhet el-Khuarizmi si "babai i algjebrës", sesa Diophantusi, pasi Al-Khuarizmi ishte i pari që e shpjegoi algjebrën në një formë elementare për qëllimet e tij, [ndërsa] Diophantusi u mor kryesisht me teorinë e numrave.[16]

Rosenthal i mëshon të njëjtës ide kur shkruan:

> Shkenca dhe mjekësia islame janë të rëndësishme si pjesë e vazhdimësisë së traditës klasike, si në Lindje, ashtu edhe në Perëndim, ku ky i fundit, në një masë të madhe, është borxhli ndaj qytetërimit mysliman përsa i përket këtyre fushave.[17]

Profesor de Santillana i Massachusetts Institute of Technology shprehet kësisoj në lidhje me al-Biruni-n:

> Tek El-Biruni, shkencëtari më i madh i Islamit, ne ndeshemi me një mendje të ndritur, aspak të ndryshme nga mendjet më të ndritura në fushën e shkencës në Perëndim. Besimi i tij fetar është solid, por ... megjithatë kjo nuk e pengon lirinë e tij të gjykimit, dashurinë e tij për faktet, kuriozitetin e tij të pakufishëm, sarkazmën e tij të lehtë, kultin e tij të rreptë dhe të kujdsshëm të integritetit intelektual.[19]

Hoodbhoy, ndërsa është mjaft kritik ndaj shkencës islame, thotë fjalë të mira për shkencëtarët e Epokës së Artë të qytetërimit islam:

> Sot sjellim ndër mend Nasir al-Din al-Tusi [1201-1274] për trigonometrinë e tij, `Khayyam Umar'-in për zgjidhjen e ekuacioneve kubike, Xhabir ibni Hajran-in, [shek. 8-9] për gjenialitetin e aparatit të tij kimik, Al-Jazari-in [shek. 12] për makinat e tij të ndërlikuara...[20]

Shpikja e zeros nga matematikanët myslimanë është një nga kontributet më spektakolare të qytetërimit islam në shkencën moderne. Është e vështirë të imagjinohet një matematikë moderne pa të. Në lidhje me këtë kontribut, el-Daffa vëren se:

> Krijimi i zeros hapi rrugën për konceptimin e tërë numrave algjebrikë pozitivë dhe negativë, të cilët përdoren për llogaritje, identifikimi e ngarkesave elektrike, në lundrim, etj.[21]

Natyrisht që shkencëtarët myslimanë u paraprinë nga të tjerë, sidomos ata të civilizimeve të hershme greke dhe romake. Larg anashkalimit dhe konsiderimit të tyre si të parëndësishme, myslimanët e studiuan veprën e tyre dhe nxorrën përfitim nga puna e Euklidit (lulëzoi rreth 300 p.e.s.), Arkimedit (v. 211 p.e.s.), Apollonios (l. 212 p.e.s.), Pitagoras (v. 497 pes), Efes, Vitruvius Pergam, Ptolemeu, dhe të tjerët. Për ta, shkenca ka qenë një disiplinë e eksperimentit dhe vëzhgimit korrekt. Një shkencëtar, Ebu Abdullah al Faraj Ta'ib (vd. 1043) thekson:

> Në studimet tona kemi ndjekur gjurmët e paraardhësve tanë dhe jemi lodhur mjaft për të kuptuar siç duhet veprat e tyre. Për sa i takon pohimeve të mjegullta dhe shpjegimeve të tyre të paqarta, ne kemi zbuluar gjithashtu një numër idesh që shkojnë përtej asaj që ata kanë thënë.

Shkencëtarët e hershëm myslimanë punonin në një atmosferë përfitimi, pranimi, dhe rinovimi të veprës së pararardhësve të tyre. Shkenca moderne, shumëçka prej së cilës i atribuohet Perëndimit, ka huazuar mjaft nga shkencëtarët që kanë jetuar në botën islame (prej të cilëve jo të gjithë ishin myslimanë), edhe pse ky fakt rrallëherë është pranuar. Al-Hassan dhe Hill raportojnë se *el-Muradi*, një shkencëtar mysliman i shekullit të njëmbëdhjetë, e pati huazuar teknologjinë gjetkë (përfshirë edhe pjesën veriore të Evropës) për të ridizenjuar orën e famshme arabe me ujë.[22] Më vonë, orët e tij u përhapën në të gjithë Evropën dhe ende mund të vërehen nëpër ato zona evropiane ku vlerësohet veçanërisht antikiteti.

Është e qartë se ka ekzistuar një marrëdhënie e fortë e ndërvarësisë shkencore midis qytetërimit mysliman dhe domenit aktual të

shkencës moderne: qytetërimit perëndimor. Megjithatë kur përshkruajmë shkencën moderne, shpeshherë harrojmë të përmendim faktin se shkencëtarët myslimanë luajtën një rol të madh historik në formësimin e saj, siç shprehet edhe Hoodbhoy:

> [Shkenca] është si një ndërtesë gjithmonë në përdorim, por në riparim të përhershëm, vazhdimisht në zgjerim në madhësi, duke shtuar në vetvete hapësira dhe ndarje të reja .... [dhe] individët shkencëtarë, ashtu si milingona punëtore që rropaten përditë duke punuar, janë ndërtuesit më të vlefshëm të cilët ndihmojnë në krijimin e kësaj depoje gjigande të dijes njerëzore.[23]

Myslimanët duhet ta shohin këtë deklaratë në kontekstin e vëzhgimit të Sardar, sipas të cilit e gjithë dituria është pronë e Zotit. Bota myslimane ka kontribuar përmes shkencëtarëve që ajo ka prodhuar. Ne gjithashtu duhet të theksojmë, se këta shkencëtarë myslimanë patën sukses pjesërisht edhe për shkak të interesit dhe mbështetjes së udhëheqësve të asaj epoke. Suksesi i vëllezërve Benu Musa të Bagdadit, të favorizuar zyrtarisht, është një shembull i mirë në këtë pikë. Al-Hassan dhe Hill raportojnë në lidhje me Kalifin el-Mutakid (v. 902), se: "Kalifi Mutakid, për shembull, u ka siguruar atyre strehim të pallatin e tij, madje edhe dhoma për të gjitha degët e shkencave, dhe profesorët paguheshin me shpërblime të posaçme për të dhënë mësim atje."[24]

Shkencëtarët myslimanë përgjatë historisë

Al-Hassan dhe Hill, Sarton, Nasri, dhe të tjerë, kanë paraqitur lista të gjata, por aspak shteruese të shkencëtarëve myslimanë bashkë me arritjet e tyre. Disa prej këtyre shkencëtarëve kanë qenë tepër imponues për t'u injoruar, qoftë edhe vetëm për shkak se ata kanë diktuar drejtimet në shkencën moderne. Midis tyre shquhet *el-Khuarizmi*, studimet origjinale të të cilit në algjebër ishin një gur themeli për matematikën moderne. *Ebu el-Fat'h Umar ibn Ibrahim al-Khayyami* (Omar Khajam, 1038/48-1123/24), nderohet pothuajse në të njëjtën shkallë. Thabit ibni Kura (836-901),

një Sebian nga Harrani, mbahet mend për punën e tij autoritative në matematikë, fizikë, mjekësi dhe astronomi. Maslama al-Majrifi (v. 1007), një autoritet i shquar i alkimisë dhe autor i *Hapi i Sag*ës dhe *Q*ëllimi i *të mençurit*, ishte gjithashtu një matematikan dhe astronom i shquar. Nasir al-Din al-Tusi (1201-1274), i renditur nga disa si shkencëtari më i madh mysliman pas Ibn Sinas (Avicena, 980-1037), ishte një historian, astronom dhe matematikan i madh. Mahmud ibni Mas `ud Kutb el-Din el-Shirazi (vdiq më 1311), i cili shkëlqeu në matematikë dhe astronomi. Jo më pak të rëndësishëm janë al-Jazari (shek. 12), autor i *Përmbledhja e teorisë dhe praktikës së arteve mekanike*, si dhe vëllezërit Banu Musa të shekullit të nëntë në Bagdad, të cilët kishin akses në Bejt el-Hikmah. Libri i tyre, *Libri i pajisjeve gjeniale*, pati një ndikim të madh mbi studimet e mëvonshme në matematikë dhe inxhinieri.[26]

Në mjekësi, Ibn Sina është legjendar edhe në Perëndim. *Kanoni i tij i Mjekësisë* dhe *Libri i shërimit* ishin prodhime afatgjata për akademikët e universitetit, sidomos në Francë. Muhamed ibn el-Zakarija el Razzi (Rhaziu, 865-925) mbahet mend për veprën e tij *Sekreti i sekreteve* dhe për të punimin e tij të shquar mjekësor *Traktat mbi linë dhe fruthin*. Ebu ʻAli al-Hassan Ibn al-Hajtham (Alhaz, 965-1039) ishte një fizikant i madh, libri i të cilit mbi optikën i dha atij një vend të veçantë në historinë e shkencës botërore. Ibn Rushd (Averroes, vd. 1198), ka studiuar si shkencë, ashtu edhe filozofi, duke bërë interpretime të paçmueshme mbi veprat e Aristotelit. Al-Biruni (973-1050), i përshkruar nga de Santillana si shkencëtari më i madh mysliman, është i respektuar si në Lindje dhe në Perëndim për angazhimin dhe këmbënguljen e tij në kërkimin e dijes. Ai është autor i *Kronologjia e kombeve të lashta* dhe i shumë veprave të tjera.

Shkencëtarë të tjerë të mëdhenj me famë ishin filozofi - shkencëtar i krishterë Hunejn ibn Is'hak (vd. 809-73), i cili shkroi *Aforizmat e filozofëve*; Yakub Ebu Jusuf ibn Is'hak (801-873), një filozof-shkencëtar; Xhabir ibn Haj'jan (lulëzoi rreth 776), një dijetar i madh me botime të shumta që mbajnë emrin e tij, sidomos

në kimi; filozofi Abu Nasr al-Farabi (Alfarabius, vd. 950); Ebu al-Hasan al-Masudi (vd. 957), një gjeograf dhe gjeolog, dhe Bahá-al-Din (vd. 1621), një filozof, teolog, matematikan dhe arkitekt mjaft i njohur.

Këtu mund të shtohen lehtësisht edhe shumë emra të tjerë. Emrat e disa shkencëtarëve të paraqitur këtu janë vetëm sa për t'i kujtuar lexuesit se dijetarët/shkencëtarët klasikë myslimanë dhe jomyslimanë të botës islame nuk kishin asnjë interes dogmatik mbi shkencën, përkundrazi, ata kërkonin vazhdimisht dije shkencore, dhe gjetjet e tyre ndihmuan për të hedhur themelet për atë që sot cilësohet si shkenca moderne. Një aspekt i jetës së tyre prej të cilit do të mund të përfitojnë shkencëtarët bashkëkohorë myslimanë, është se këta dijetarë ishin njëkohësisht edhe shkencëtarë dhe dijetarë të devotshëm fetarë, të cilët i ndoqën të dyja rrugët, pa parë ndonjë kontradiktë dhe mospërputhje mes tyre.

Konflikti shkencë-fe: realitet apo mit?

Islami nxit si mirëqënien materiale, ashtu edhe atë shpirtërore të njerëzimit. Meqënëse Islami i urdhëron ndjekësit e tij që të kërkojnë dhe të shfrytëzojnë dijen për të përmirësuar jetën e tyre si këtu ashtu edhe në jetën e përtejme, myslimanët duhet t'i studiojnë shkencat, qoftë edhe vetëm për të mbrojtur strukturat politike dhe sociale të qytetërimit islam. Profeti Muhamed pati luftuar për të mbrojtur Islamin duke përdorur armët e kohës. Kjo do të thotë se myslimanët e asaj periudhe kanë luftuar për barazi teknologjike, pse jo edhe për superioritet ndaj bashkëkohësve të tyre. Sardar shkruan:

> Shkenca është një mjet bazë për zgjidhjen e problemeve të çdo qytetërimi. Pa shkencë një qytetërim nuk mund t'i mbajë në këmbë strukturat e veta politike dhe sociale, apo të plotësojë nevojat themelore të popullit dhe kulturës së vet. Me pak fjalë, shkenca është mjeti që e formëson përfundimisht një qytetërim: ajo është një shprehje e botëkuptimit të tij fizik.[27]

Shumë dijetarë të respektuar i kanë cekur marrëdhëniet ndërm-

jet Islamit dhe shkencës dhe e kanë bërë të qartë se në parim, Islami nuk përmban asnjë kundërshti me shkencën. Ne gjithashtu kemi theksuar më lart pohimin e Sardar, sipas të cilit e gjithë diturija përfshirë edhe diturinë shkencore, është pronë e Zotit. Ky pohim është i pranuar nga të gjithë dijetarët bashkëkohorë myslimanë. Pyetja që shtrohet tani është nëse shkenca moderne është e pranueshme ashtu siç është, nëse ajo duhet të zbatohet sipas parimeve islame, apo myslimanët duhet të braktisin çdo marrëdhënie të drejtpërdrejtë me shkencën moderne dhe të zhvillojnë shkencën islame.

Në të kaluarën, dijetarët myslimanë me bindje të veçanta, ndonjëherë e kanë kritikuar shkencën si të pafe dhe të pamoralshme, duke i përndjekur shkencëtarët dhe duke refuzuar risitë e tyre, me pretekstin se ato ishin të gjitha sajime, dhe të gjitha shpikjet si të rrezikshme për besimin. Kjo është një nga arsyet përse shkenca perëndoi në tokat myslimane. Për shembull, el-Kindi, shkencëtar i madh, i cili me gjykimet e tij ishte shndërruar në të preferuarin e kalifit Ma `Mun, u detyrua të largohej përjetë nga vendi, kur al-Mutauakil mori pushtetin. Ai vdiq i vetmuar dhe i hidhëruar. Ibn Ithaldun (1332-1406), njëri nga mendimtarët e mëdhenj myslimanë të periudhave të mëvonshme dhe i famshëm për kontributin e tij në studimin e shkencave embrionale, u izolua nga ulematë më konservatorë të kohës së tij me akuzën se ishte shumë "racionalist" i thekur në metodat e tij të studimit.[28] Dukuritë e tilla ishin për të ardhur keq, por ne mund t'i qortojmë ato pa paragjykuar qëndrimin thelbësor të Islamit ndaj shkencës, dhe ky fakt nuk duhet të na lerë të verbër ndaj kundërshtimeve legjitime të disa dijetarëve myslimanë për disa nga metodat dhe aplikimet e ndryshme shkencore moderne.

Po me ç'sy e ka parë tradicionalisht Kisha e krishterë shkencën dhe praktikuesit e saj? Ne duhet t'i japim përgjigje kësaj pyetjeje, sepse kanë qenë kryesisht dijetarë kristianocentrikë ata që janë përpjekur të njollosin reputacionin e Islamit me portretizimet më negative, duke mbajtur një heshtje sistematike rreth përvojave të

tmerrshme të krishtërimit lidhur me këtë çështje.

Për më shumë se 1.000 vjet me radhë, Kisha i ndaloi të krishterët të besojnë se njerëz jetonin edhe në anën tjetër të planetit. Ky besim e kishte origjinën tek Shën Agustini.[29] Sipas tyre, Toka besohej të ishte e sheshtë, dhe nëse kishte njerëz në anën tjetër, ata patjetër duhej të ishin duke qëndruar me kokë poshtë, një ide kjo e fundit që Kishës i dukej krejt e papranueshme. Në mënyrë të ngjashme, nën autoritetin e Shën Palit,[30] të krishterëve iu desh të besonin se uria, sëmundjet apo murtaja dhe ndotja e ajrit, shkaktoheshin nga demonët. Kështu vaksinimi ishte i ndaluar, në një kohë kur shkencëtarë myslimanë si al-Raziu kryen kërkime në këtë fushë. Rrufeja dhe gjëmimet e motit, besohej të ishin rezultat i pesë mëkateve të pafytyrësisë, mosbesimit, mospërfilljes së detyrimeve ndaj Kishës, mashtrimit në pagimin e së dhjetës dhe të klerit, si dhe shtypjes së vartësve. Ndërsa shkencëtarët e mëdhenj myslimanë si al-Maxhriti, el-Shirazi, dhe al-Masudi kishin shkruar gjerë e gjatë mbi astronominë, gjeografinë dhe gjeologjinë, të krishterëve u ishte ndaluar të studionin trupat qiellorë dhe gjeologjinë. Jo më larg se në vitin 1850, Papa Piu IX e ndaloi mbajtjen e kongresit shkencor italian, i cili do të mbahej në Bolonjë, vetëm sepse në program bënte pjesë edhe gjeologjia. Punimet e Dr. Boylston mbi vaksinën e lisë, rrufepritësja e Benjamin Franklin-it, dhe teoria e mjegullnajës kozmike dhe yjeve e Immanuel Kant-it, që të gjitha ndeshën në pakënaqësi dhe rezistencë të madhe nga ana e Kishës.

Kur Koperniku botoi *Commentariolus*-in e tij në vitin 1514, ai u inkurajua nga Papa Klementi VII për ta zhvilluar atë më tej në atë që më vonë u bë *De Revolutionibus Orbium Coelestium* (Mbi Rrotullimin e sferave qiellore), botuar në 1543. Kjo vepër në fushën e astronomisë, e fshiu nga faqja e dheut sistemin gjeocentrik të Ptolemeut dhe e zëvendësoi atë me modelin heliocentrik. Megjithatë që nga viti 1616, pikëpamjet e Kopernikut dhe tërë "revulucionit Kopernikan" u gjykuan të rrezikshme, sepse ato binin në kundërshtim me pikëpamjet e kishës mbi kozmosin. Koperniku, i cili

ishte edhe vetë një prift, një kanonik i Katedrales së Frauenburg (Poloni), dhe një doktor i ligjit kanonik, u dënua si heretik dhe u çkishërua (23 shkurt 1616), shumë kohë pas vdekjes së tij.

Edhe pse pikëpamjet e tij ishin gjykuar si kriminale nga Kisha, ato vazhduan të përhapeshin dhe shërbyen si një themel mbi të cilin Galileu, Kepleri, Hygensi, dhe Njutoni ndërtuan studimet e tyre. Galileu është bërë legjendar për konfrontimin e tij me Kishën, edhe pse një pjesë e konsiderueshme e famës së të cilit vinte edhe për faktin se ai ishte një i krishterë i devotshëm. Papa Urbani VIII, i cili e dënoi me burgim të përjetshëm, ishte një ish mik i tij dhe njëkohësisht Galileu mbrohej fort nga kardinali Maffe Barberni. Ndoshta kjo i dha Galileut një ndjenjë të rreme sigurie. Studimet shkencore të mëvonshme i dhanë të drejtë Galileut, por prapseprapë Kisha mbajti një heshtje në të cilën nuk shihej gjurmë pendese (ndoshta njëfarë sikleti po). Disa historianë janë përpjekur që të fajësojnë Galileun për këtë konflikt, siç vërehet në citimin e mëposhtëm:

> Si një publicist i talentuar, ai [Galileu] ndihmoi në popullarizimin e shkencës. Megjithatë, natyra e tij grindavece e çoi atë në një polemikë fatkeqe me Kishën.[32]

Prej një kohe të gjatë ka qenë i njohur fakti se Galileu kishte të drejtë dhe se autoritetet e Kishës ishin në gabim. Ndoshta mund të ketë qenë armiqtë e Galileut në stafin e institucionit universitar (Aristotelianët ose Neo-Platonistët), ata, të cilët duke shfrytëzuar talentin e tij për polemika, e futën atë në konflikt me Kishën. Megjithëse ky fakt nuk mund ta përligjë dot fajin e Kishës. Ajo çfarë është mjaft dëshpëruese, është fakti se Vatikanit iu deshën më shumë se 350 vjet për të artikuluar një tërheqje zyrtare nga pozicionit i tij. Më 9 maj të vitit 1983, Papa Gjon Pali II bëri një deklaratë që i ngjante një apologjie:

> Eksperienca e Kishës në çështjen Galileu dhe pas saj, ka çuar në një qëndrim më të pjekur ... Vetëm nëpërmjet një studimi të përulur dhe ngulmues (Kisha) ka mësuar të veçojë bazat e besimit nga sistemi shkencor i një epoke të caktuar.[33]

Islami, megjithatë, nuk i ka "shkëputur" kurrë sistemet shkencore nga bazat e besimit, sepse shkenca është laboratori praktik i besimit. Në qoftë se ajo trajtohet me përgjegjësi dhe udhëhiqet siç duhet, mund të jetë një ndihmëse e madhe në përmbushjen e misionit të Islamit.

Shkenca në Kuran

Kurani është një libër udhëzues që përmban një mesazh universal dhe gjithëpërfshirës për mbarë njerëzimin, pa marrë parasysh kohën dhe hapësirën. Meqë ai mbulon çdo aspekt të jetës, do të ishte e habitshme nëse nuk do ta përfshinte shkencën. Një studim i plotë i Kuranit, evidenton rrënjët e mjaft zbulimeve shkencore që janë bërë ose që do të bëhen, edhe pse dijetarët myslimanë nuk mund të jetë në një pozitë të tillë sa për të folur me kompetencë për gjëra të tilla, pa u bërë studime specifike rreth tyre. Kurani lë të kuptohet se ai mund të çojë në zbulime të mëdha në qoftë se studiohet me zell dhe imtësishëm. Kjo është arsyeja përse gjeneratat e mëparshme të dijetarëve myslimanë, të cilat ndërthurën njohuritë kuranore me kureshtjen dhe kompetencën shkencore, shkëlqyen. Dijetarët bashkëkohorë kanë analizuar referencat kuranore ndaj subjekteve të ndryshme shkencore dhe kanë nxjerrë vëllime të mëdha materialesh shkencore në astronomi, biologji embrionale, në lëvizjen e bletëve, në ndërtimin e maleve, përbërjen e Tokës, bimëve, dhe shumë e shumë subjekte të tjera. Edhe ata, të cilët dëshirojnë të mohojnë praninë e shkencës në Kuran, duhet të pranojnë humbjen kur studiojnë ajete kuranore të tilla si 96/1-5 (embriologjia), si dhe 36/36-40, 91/1-4, 21/30, 55/7, 79/28, e shumë të tjera (kozmologjia). Këto aludime japin informacion të dobishëm për studiuesit, ashtu si edhe bekimin dhe inkurajimin për myslimanët, të cilët angazhohen në shkencë. Nëse këto vargje hulumtohen me zgjuarsi dhe pa paragjykime, lënë të kuptohet se burime të tilla mund të çojnë në zbulime dhe shpikje befasuese.

Megjithatë, ekziston një traditë e tërë dijetarësh, të cilët janë përpjekur për ta lexuar shkencën, si nga brenda ashtu edhe nga jashtë Kuranit, duke e kthyer këtë si një qëllim në vetvete. Ata e "gjejnë" pothuajse çdo shpikje dhe zbulim shkencor në Kuran dhe bashkangjisin një arsyetim shkencor për çdo recetë apo ndalesë kuranore. Një pjesë e kësaj pune ka rezultuar e dobishme, sepse ajo ka rizgjuar tek myslimanët ndjenjën e vlerave të tyre të trashëguara dhe ka rindezur dëshirën për kërkime të mëtejshme, tani që ata e kuptojnë se Kurani mbështet sipërmarrje të tilla. Por në shumë raste, dijetarë të tillë ose i kanë tejkaluar kufijtë duke e ekspozuar Islamin ndaj talljeve të perëndimorëve, ose kanë ushqyer tek shumë myslimanë komplekset e inferioritetit, duke pretenduar se statusi i Kuranit si një Shpallje Hyjnore, duhet të jetë "i privuar" nga shkenca.

Në vitin 1961, shkencëtari egjiptian El-Fandy botoi librin e tij *Vargjet kozmike në Kuran*, në të cilin ai e përshkroi Kuranin si "shembullin më të mirë të shprehjes shkencore."[34] Për të ilustruar këtë pohim, ai i shpjegoi disa vargje nën dritën e zbulimeve moderne astronomike dhe teorive moderne shkencore, mes të cilave edhe teoria e "Big Bang"-ut. Bota myslimane e duartokiti atë; shkencëtarët perëndimorë buzëqeshën plot ndjenjë pronësie, të kënaqur se myslimanët nuk mund të kenë shumë për të ofruar në qoftë se ata paskan nevojë për shkencën perëndimore për të vërtetuar saktësinë e Kuranit.

Por një kurbë e tillë ishte vetëm në fillimet e saj. Azizul-Hassan Abbasi, një neuropsikiatër pakistanez, pohoi në veprën ee tij të titulluar *Kurani dhe higjiena mendore,* se ai kishte gjetur kura të bazuara në Kuran për tuberkulozin, diabetin, ulcerat e stomakut, reumatizmën, artritin, tensionin e lartë të gjakut, astmën, dizenterinë dhe paralizën.[35] Në fund, pretendime të tilla doli të ishin thjesht një "dëfrim" intelektual, sepse ai nuk i kishte kryer ato studime me shpresën për t'i ofruar botës ndonjë progres mjekësor apo ndonjë triumf të Islamit.

Në vitin 1976, kirurgu francez Maurice Bucaille botoi librin me

titull *Bibla, Kurani dhe Shkenca,* duke ndezur një valë ekzaltimi në mbarë botën myslimane. Ai e pasoi atë në vitin 1989 me një pamflet të titulluar *"Kurani dhe Shkenca"*. Libri i tij *Bibla, Kurani dhe Shkenca* është ribotuar disa herë dhe është përkthyer në gjuhë të ndryshme të vendeve myslimane. Pasi ia nënshtron, si Biblën ashtu edhe Kuranin testimeve rigoroze përkundrejt zbulimeve të shkencës moderne në astronomi, gjeologji, shkencat e kafshëve, bimëve dhe riprodhimin e njeriut, ai arriti në përfundimin se:

> Kurani padyshim nuk përmban as edhe një pohim të vetëm që bie në kundërshtim me njohuritë më moderne të ngritura mbi baza të shëndosha shkencore; zbulimet moderne të njeriut të konfirmuara dhe të verifikuara ndaj gabimeve shkencore, janë në përputhje të plotë me konceptin e përhapur në rradhët e myslimaneve që ka të bëjë me Kuranin si një Libër i Shpalljes Hyjnore.[36]

Myslimanët ishin të ngazëllyer për faktin se libri i tyre kishte "rezultuar" të sakta. Sugjerimi gjithëpërfshirës i Bucaille-s se zbulimet moderne që lidhen me "mungesën e gabimit," janë në përputhje me Kuranin, i shpëtoi komunitetit mysliman të pavëmendshëm për shkak të entuziazmit. Simbioza midis zbulimeve shkencore moderne dhe Kuranit përbënte një "martesë" plotësisht të lumtur, dhe askush prej tyre nuk mund të gabonte. Konkluzioni i tij, se "është e pamundur që të mos e pranojmë ekzistencën e gabimeve shkencore në Bibël," gjithashtu u kapërdi si kallëp i padekonstruktuar nga ana e myslimanëve dhe një veprim i tillë rrezikoi për t'i bërë ata të ecnin kundër valës së shumicës.

Myslimanët gjithmonë kishin besuar se Kurani nuk përmban gabime, sepse ajo është Fjala e Zotit, ndërsa Bibla (në formën e saj aktuale) nuk është një shpallje e vërtetë nga Zoti. Madje më tepër, tani ata kishin prova shkencore për këtë! Rregullat e lojës ndryshuan. Shkenca moderne u pranua nga një masë e gjerë e myslimanëve si arbitër midis Kuranit dhe Biblës. Bucaille u shndërrua në hero për disa prej myslimanëve. Nëpër konferencat në të cilën ai nuk ishte i ftuar, shumë njerëz e madje edhe shumë dijetarë të shquar myslimanë, e citonin atë në shkallë të gjerë. Në konfer-

enca të tjera, më shumë diskutohej për pikëpamjet e Bucaille-s sesa për besimin që buronte në vetvete në lidhje me vërtetësinë e Kuranit. Bomba me sahat që Bucaille kishte vendosur, mund të shpërthente nga çasti në çast, prej kërkimit me paramendim të ndonjërit për të gjetur gabime shkencore në Kuran, apo diçka që të provonte saktësinë shkencore të Biblës.

Në prill të vitit 1985, *Buletini i Shoqatës Mjekësore Islamike të Afrikës së Jugut,* botoi një artikull të titulluar *"Dijetari kanadez konfirmon Kuranin dhe Hadithin në librin "Embriologjia Njerëzore"."* Ende pa u shuar jehona e efektit Bucaille, na u përhap një lajm edhe më i madh për dhe në komunitetin mysliman, që shkencëtari Keith Moore, kryetar i Departamentit të Anatomisë së Shkollës së Mjekësisë të Universitetit të Torontos, kishte "zbuluar" përputhshmërinë mes Islamit dhe thelbit të embriologjisë bashkëkohore. Moore, ashtu si Bucaille, u bë mjaft i preferuar nga organizatorët e konferencave myslimane, me sa duket për ndihmesën e tij në "konfirmimin" e mëtejshëm se Kurani dhe Hadithi[37] ishin të saktë shkencërisht.

Shemsul Hak, ashtu si edhe El-Fandy para tij, sollën "prova" të mbështetura në Kuran në mbështetje të teorisë së "Big Bang"-ut duke botuar punime që trajtonin "rrënjët e teorisë së relativitetit dhe mekanikës kuantike në Kuran!"[38] Khuda ofroi dëshmi kuranore për teorinë e zhvillimit të biosferës.[39] Rahman e paraqiti Kuranin si një tekst shkencor.[40] Në këtë vëllim prej 332 faqesh, ai mbulon 27 subjekte dhe thotë se Kurani mbulon edhe më shumë. Është e qartë se ashtu si edhe të tjerët përpara tij, "zbulimet" në Kuran, ai i ka bërë tashmë nëpërmjet shkencës moderne.

Ka pasur edhe përpjekje të tjera për të "legjitimuar" reciprokisht Kuranin dhe shkencën moderne. Siç është cekur më herët, disa prej këtyre punimeve kanë qenë të dobishme, ndërsa punime të tjera kanë shkuar shumë larg dhe kanë rezultuar në absurditete. Bashirud'din Mahmood, një inxhinier bërthamor pakistanez, citohet të ketë sugjeruar se xhindët, të cilin Zoti i ka krijuar nga zjarri, duhet të përdoren si një burim energjie për të luftuar krizën

energjitike. Mjaft teologë të shquar si Ebu Is'hak el-Shabati, janë shqetësuar tejmase nga këto kërkime për shkencën në Kuran. Sejjid Kutubi, duke e përshkruar tërë këtë veprimtari si "një gabim metodologjik," i ka mëshuar fort idesë sipas së cilës megjithëse Kurani përmban udhëzime për lëndët shkencore, ai nuk është një libër shkencor.[41]

Edhe pas "zbulimeve" të tilla, myslimanët nuk ishin të përgatitur për eksperimentimet aventureske të inxhinierit egjiptian Khalifa, i cili përdori kompjuterin për të konstatuar dhe vlerësuar saktësinë e Kuranit. I fiksuar me natyrën matematikore të Kuranit, ai sajoi "teorinë e numrit 19" si një numër magjik rreth të cilit është ndërtuar Kurani.[42] Ai argumentonte kështu: Ajeti i parë i Kuranit (Bismilah, al-Rahman, el-Rahim) ka 19 shkronja. Kur 28 shkronjave të alfabetit arab u jepen vlera numerike të caktuara, dhe kur është shkruar numri 19, fjala korresponduese në alfabetin arab, është fjala *Wahid* (një nga Emrat e Zotit). Kurani ka 114 sure, një shumëfish i 19-ës; Shpallja e parë Kuranore (96:1-5) përbëhet nga 19 fjalë dhe ka 76 shkronja, një tjetër shumëfish i 19-ës; e kështu me radhë. Këtë analizë të detajuar numerologjike të Kuranit nga ana e Khalifa-s, myslimanët e kishin shumë përzemër, duke e parë atë si një mënyrë të re për të "vërtetuar" Kuranin. Kjo temë citohej shpesh nëpër konferenca lokale dhe ndërkombëtare, dhe ishte një subjekt i preferuar në mënyrë të veçantë nëpër seminare studentore myslimane. Edhe predikuesi i mirënjohur mysliman Ahmed Deedat për shembull, i përdori zbulimet e tij në pamfletin me titull " *Kurani, mrekullia sublime*."

Më vonë Khalifa tronditi edhe admiruesit e tij, kur deklaroi se ai e kishte llogaritur ditën e saktë të Gjykimit,[43] dhe se teoria e tij e numrit 19, kishte zbuluar gabime në dy ajetet e fundit të Sures el-Teube. Edhe më tronditës ishte pretendimi i tij:

> Kjo shënon ardhjen e një epoke të re në fe; një epokë ku besimi nuk është më i nevojshëm. Nuk ka nevojë për të "besuar" diçka që "dihet". Njerëzve të brezave të kaluar u kërkohej të besojnë në Zotin, dhe të kryenin urdhëresat e Tij në lidhje me besimin. Me ardhjen e provave fizike të raportuara në këtë libër, ne nuk kemi nevojë më të besojmë se

Zoti ekziston, pasi ne e dimë se Zoti ekziston.[45]

Me fjalë të tjera, "provat" shkencore i kanë bërë Shtyllat e besimit islam të ngjajnë të vjetëruara. Tani, në qoftë se ne duam të besojmë në ndonjë të vërtetë, ne kemi nevojë për "dëshmi" (dhe prova shkencore), prandaj në këtë epokë të re, nuk ka më vend për besimin (fetar). Por kjo nuk ishte e gjitha nga Khalifa. Ai përcaktoi se meqënëse tani disponojmë këto dëshmi dhe mjete shkencore, edhe profeti Muhamed nuk kishte më ndonjë rol për të luajtur në Islam, sepse kur ne kërkojmë udhëzim fetar nga Profeti apo ndonjë burim tjetër përveç Zotit, mbështesim pretendimin e djallit, se Zoti ka nevojë për një partner.[46]

Sado e pabesueshme që mund të tingëllojë, disa myslimanë e pasuan Khalifa-n edhe në këtë pikë. Kas'sim Ahmedi, dishepulli i tij në Malajzi, shkroi një pamflet në të cilin denonconte hadithin. Ky version i eksperimentit me shkencën dhe Kuranin kishte shkuar shumë larg![47] Khalifa atëherë e barazoi misionin e një shkencëtari të kësaj epoke shkencore me atë të një profeti të vërtetë, duke e përshkruar veten si një profet.[48] Nuk ka asnjë dyshim se nëse Imam el-Gazaliu, do të ishte gjallë, do ta kishte ndierë si të përligjur refuzimin ndaj matematikës, për shkak të rrezikut të saj potencial ndaj besimit. Marrëzitë shkencore të Khalifa-s na japin një shembull të mirë të mënyrës se si shkenca moderne mund të keqpërdoret nga ata që pretendojnë të mbajnë flamurin e kauzës së Islamit, si dhe të mënyrës se si mund të abuzohet me Kuranin nga ata që pretendojnë të vërtetojnë saktësinë e tij.

Myslimanët dhe problemet e parashtruara prej shkencës moderne

Çdo ditë që kalon, shkenca moderne hedh nga një hap tjetër drejt progresit. Disa prej myslimanëve trullosen prej këtyre hapave. Për shembull, ekziston një lloj habie për faktin se si është e mundur të ekzistojnë klinika të spermës që i mundësojnë një gruaje të ketë fëmijë pa baba të njohur, ose rreth përpjekjeve për të rritur organe për transplantim në trupa të njerëzve në trupin e

derrave, duke injektuar tek ata qeliza me gjenet e njeriut. Disa prej këtyre risive teknologjike janë plotësisht antagoniste me doktrinën dhe frymën e Islamit. Për më tepër, ekziston problemi i dështimit të shkencëtarëve bashkëkohorë për të vlerësuar kufizimet e tyre në çështjet e diturisë, si dhe përpjekjet e tyre për ta paraqitur mosbesimin e tyre në Zotin si një virtyt. Problemet midis Islamit dhe shkencës moderne, do të vazhdojnë të ekzistojnë derisa shkencëtarët modernë të pranojnë kufizimet njerëzore. Soliman e përmbledh këtë pikë duke i bërë një pasqyrë të shkëlqyeshme:

Meqënëse shkenca nuk është ende në gjendje që të shpjegojë mrekullitë e Profetëve, të cilat janë historikisht të vërtetuara dhe *nuk mund të nënçmohen* në asnjë mënyrë,... ne mund të gjykojmë se shkenca megjithë triumfet e saj shumë të mëdha, është ende një xhuxh. Ne gjithashtu mund të *dalim në një përfundim të sigurtë se ekzistojnë ide qiellore,* të cilat njeriu nuk mund t*'i kuptojë, sado që ai të përpiqet ta bëjë* këtë *dhe se aftësia e tij për të mësuar, e ka një limit. Prandaj ngjan paksa e çuditshme që të ekzistojë një konflikt i tillë mes dy burimeve tona të dijes.*[49]

Pavarësisht faktit se kjo qasje e këtij dijetari bashkëkohor mysliman paraqet një qëndrim shumë pajtues, studiusit kryesorë të shkencës së sotme nuk vijnë nga rradhët e muslimanëve, që të pranojnë këtë thirrje dhe të tjera të ngjashme, të cilat synojnë të vendosin një armëpushim. Kjo tregon se mospërputhjet në të vërtetë nuk janë me shkencën në vetvete, por me ata të cilët e keqpërdorin atë dhe insistojnë në karakterin e saj laik (dhe ateist), të trashëguar, siç bën për shembull Hoodbhoy:

> Nëse dikujt i pëlqen apo jo, është në mënyrë të padiskutueshme e vërtetë që shkenca moderne është tërësisht laike në karakter. Nuk ekziston asnjë nevojë për t'iu referuar autoritetit hyjnor për verifikimin e fakteve shkencore; ekzistenca e një autoriteti të tillë as është pohuar, e as mohuar ... eksperimenti dhe konsistenca logjike janë arbitrat e vetëm të së vërtetës - asnjë ndikim mbi rezultatet nuk ka as gjendja shpirtërore e shkencëtarit e as karakteri i tij moral.[50]

Por kjo nuk është e gjitha që Hoodbhoy ka për të thënë. Ai ndje-

het i irrituar për faktin se "dogmatistët fetarë të të gjitha bindjeve, e kanë sulmuar me kohë shkencën si një shkatërruese të pabesë të moralit që buron nga frymëzimi hyjnor".

Ky refuzim nën zë i aspektit dhe moralit hyjnor, është në fakt përgjegjës i vërtetë për shqetësimet e myslimanëve dhe i stepjes së tyre në marrëdhëniet me shkencën moderne. Myslimanët besojnë se e vërteta absolute vjen nga Allahu, të cilit ata i luten në paktën pesë herë në ditë dhe të cilin ata i drejtohen sa herë që ata ndjehen të habitur ose të sikletosur nga ndonjë fenomen. Por shkencëtarët modernë madje edhe shfryjnë mllefin mbi lutjen e druajtura të myslimanëve. J. W N. Sullivan mendon se është absurde për këdo për t'u lutur të bjerë shi, duke thënë se:

> Besimi se natyra është e rregullt ende nuk është universal ... ne ende gjejmë sot kongregacione që luten për të rënë shi, edhe pse ata ndoshta do të ngurronin të luteshin që dielli të qëndrojë ende në horizont. Kjo për shkak se astronomia është një shkencë më e zhvilluar se meteorologjia.[51]

Me fjalë të tjera, myslimanët do të ndalojnë së luturi për të rënë shi, kur ata të mësojnë më shumë rreth meteorologjisë. Pikëpamje të tilla i sprapsin myslimanët. Pasi vëzhgojnë rregullin që ekziston në natyrë, shkencëtarët nuk e ndërmarrin dot hapin tjetër logjik që të pyesin se kush e krijoi një rregullsi të tillë. Nuk është çudi pra, që janë ata që i irritojnë vazhdimisht dijetarët e shquar myslimanë të tillë si Ebu Ala al-Maududi.

Por të tjerë nuk janë mjaftuar vetëm me talljen e maskuar të Sullivan. Renan[52] e denoncon Islamin për mbytjen e shkencës duke dështuar për të bërë dallimin ndërmjet aspektit shpirtëror dhe atij fizik. Ai pastaj e përshkroi "dogmën" e Islamit si " vargonjtë më të rëndë që njerëzimi ka krijuar ndonjëherë."[53] Renan, një njeri i cili është mjaft mirë në dijeni të betejave historike mes shkencëtarëve dhe Kishës, i injoron ato në sulmin e tij mbi Islamin. Me fjalë të tjera, problemi i myslimanëve me shkencën moderne nuk është vetëm refuzimi i Zotit apo zbatimet shpeshherë amorale të shkencës, por edhe ata shkencëtarët të cilët tallen dhe shpifin

rreth Islamit, ndoshta për shkak të përkushtimit të tyre ndaj feve rivale [ose të asnjë feje].

Të kundërshtuarët e ekzistencës së Zotit, domosdoshmërisht çon në ndërlikime të mëtejshme, sidomos përsa i përket origjinës dhe thelbit të njerëzimit dhe materies. Shkencëtarët kanë nxjerrë teori të shumta kontradiktore në këtën fushë, gjë që e bën të gjithë këtë ndërmarrje të turbullt dhe të mjegullt, duke i dhënë kështu myslimanëve një arsye për të përjetuar një ndjenjë triumfi në këmbënguljen e tyre për ekzistencën hyjnore.

Teoria e evolucionit e Darvinit përbën ndoshta përplasjen më traumatike mes Islamit dhe shkencës. Kur'ani thotë:

> Vërtet Ne e krijuam njeriun në formën më të bukur. Pastaj e zbritëm atë në më të ulëtin e të ultëve. Përveç atyre që besuan dhe bënë vepra të mira; ata kanë shpërblim të pandërprerë (95: 4-6).

Në kontrast me këto fjalë, Darvini shprehet:

> Kur unë i pashë të gjitha qeniet jo si krijime të veçanta, por si pasardhës linearë të disa qenieve të tjera ... ky m'u duk një shpjegim më i vlefshëm.[55]

Edhe në Perëndim, teoria e evolucionit e Darvinit u prit me dyshime të mëdha. Shumë njerëz, nuk dihet nëse për shkak të devotshmërisë së tyre (të krishterë), ishin të alarmuar me idenë prejardhjes nga gjallesat më të ulëta. Një reagim spontan interesant për teorinë e Darvinit ishte:

> Gruaja e Peshkopit të Worchester, kur u informua në lidhje me teorinë e Darvinit, komentoi: "Prejardhjen nga majmuni! I dashuri im, le të shpresojmë se kjo nuk është e vërtetë, por në qoftë se është vërtet kështu, le të shpresojmë që kjo të mos bëhet e njohur botërisht."[56]

Ajo ishte duke reaguar instinktivisht për dinjitetin e ofenduar. Kurani thekson që njerëzimi u krijua në modelin më të mirë, dhe u reduktua nga Zoti në më të ulëtin e të ultëve, kur vetë njerëzimi u bë i padenjë për t'i qëndruar këtij modeli. Por Darvini dhe të tjerët si ai duan të pohojnë se njerëzimi evoluoi nga qenie të ulëta.

Nga pikëpamja islame, kjo e mohon rolin e Zotit si Krijues dhe ul dinjitetin njerëzor.

Problemi me shkencën moderne është se ndonjëherë vërejtjet e bëra mund të mos jenë të mjaftueshme për të provuar një hipotezë, edhe pse kjo mungesë e informacionit të mjaftueshëm mund t'i çojë njerëzit ta pranojnë atë si të saktë. Islami nuk ka asnjë problem me kërkimet sistematike për dije që nuk përmbajnë kurthe doktrinore dhe morale. Por ata dijetarë, të cilët Sardar i ka quajtur Bucaille-istë, kanë patur një problem të madh. Ata do të përdornin një zbulim shkencor për të shqyrtuar dhe interpretuar Kuranin, do të zhvillonin mbi këtë bazë një teori shumë mbresëlënëse dhe pastaj do ta braktisin atë, sapo konstatimi shkencor [ose teoria] hidhej poshtë. Ne pamë një zhvillim të ngjashëm kur pikëpamjet e Kopernikut përmbysën astronominë e Ptolemeut, pasi ajo kishte triumfuar për 14 shekuj me rradhë. Nëse ndonjë dijetar do të kishte përdorur kozmologjinë e Ptolemeut (e cila konsiderohej "dije moderne" përpara shekullit të gjashtëmbëdhjetë) për të "dëshmuar" vërtetësinë e Kuranit, konkluzionet do të kishin qenë dukshëm më të ndryshme nga ajo që do të ishin sot.

Duke përdorur të njëjtën linjë argumentimi, ne mund të parashikojmë se studiuesit që sugjerojnë se mishi i derrit është i ndaluar, sepse në të ndodhen mikrobe të rrezikshme të cilat nuk mund të vriten aq lehtë nga nxehtësia, do të kenë probleme në të ardhmen. Shkencëtarët mund të zhvillojnë metoda të mbarështimit, të cilat mund ta kapërcejnë këtë problem. Por, për sa i takon myslimanëve që ndjekin si Kuranin ashtu edhe shkencën, mishi i derrit prapseprapë do të mbetet i ndaluar për ta.

Hulumtimet shkencore janë vetëm një përpjekje për të kuptuar botën tonë. Nuk ka dyshim se kjo është një përpjekje shumë e dobishme, por sigurisht jo një përpjekje në të cilën, siç Hoodbhoy tenton të na detyrojë të besojmë, vëzhgimi dhe arsyetimi shkencor marrin "një pushtet dhe autoritet absolut."[57] Kjo dhe qëndrimet të ngjashme të adhurimit të shkencës dhe të botës moderne, i kanë shndërruar arritjet shkencore në një qëllim në vetvete, dhe

nga pakujdesia po e shtyjnë njerëzimin drejt vetëshkatërrimit. Njerëzit ende janë të tmerruar nga Nagasaki dhe Hiroshima, ata stresohen përditë nga konfliktet e pafundme, dhe rrinë në pritje të një katastrofe bërthamore ose mjedisore.

Islami nuk e konsideron kërkimin e dijes si një objektiv të paqëllimtë apo edhe si një qëllim në vetvete. Përkundrazi, ai është një aktivitet doktrinor dhe i përqendruar moralisht, që duhet t'i bëjë banorët e këtij planeti njerëz më të mirë, dhe në këtë mënyrë të ecet drejt qëllimit për të cilin ata janë krijuar. Shkenca moderne është e drejtuar, udhëhequr, dhe programuar nga njerëz të cilët nuk kanë të bëjnë fare me idealet islame të qëllimit dhe dinjitetit njerëzor, dhe në të vërtetë as nuk i përfillin fare këto veti, duke i flakur tej pa u menduar dy herë. Atëherë lind pyetja: A do t'i udhëheqë kjo shkencë moderne krejtësisht e"kalbur" aktivitetet që myslimanët duhet të ndërmarrin apo ekziston ndonjë rrugë tjetër?

Realizueshmëria e një shkence islame

Myslimanët kanë artikuluar reagime të shumta në lidhje me teprimet e shkencës moderne. Dijetarët e traditës Bucaille, më shumë se çdo gjë tjetër, iu përgjigjën akuzave se Islami si fe ishte i rremë dhe antishkencor. Ata ringjallën besimin psikologjik tek myslimanët më pak të sigurt. Por nëse në botë do të kishte vetëm myslimanë, këta studiues nuk do të kishin arritur asgjë sa i përket akumulimit të dijes shkencore që të çon tek fabrikat e prodhimit, makinat, aeroplanët, kompjuterat, laboratoret mjekësore, dhe objektet e tjera që na e bëjnë jetën më të lehtë. Me fjalë të tjera, "fitoret" e tyre ishin vetëm në fushën psikologjike dhe mbetën kryesisht ushtrime teorike. Ndërkohë, ata vijuan të përfitonin nga avantazhet e përparimeve të shkencës moderne.

Një grup tjetër i dijetarëve, parashtroi idenë e një shkence islame të bazuar në arsyetimin e mëposhtëm: Shkenca moderne kishte dështuar për t'u shërbyer nevojave të njerëzimit, përtej nevojave psikofizike dhe natyrore. Qysh në vitin 1968, Nasr botoi një

punim të plotë të titulluar *Shkenca dhe qytetërimi* në Islam, në të cilën ai jep të dhëna biografike rreth shkencëtarëve myslimanë përgjatë historisë, ku përshkruan kontributet e tyre për zhvillimin e shkencës, dhe ofron një kornizë filozofike brenda së cilës duhet të konceptohet shkenca në Islam. Ai e pasoi këtë botim me disa të tjerë, më të rëndësishmet e të cilave janë: *Takimi mes njeriut dhe natyrës*: *Kriza shpirtërore e njeriut modern* (1968), *Shkenca Islame: Një studim i ilustruar* (1976), *Një hyrje në doktrinat kozmologjike islame* (1978), *Islami tradicional në botën moderne* (1987), dhe *Nevoja për një shkencë të shenjtë* (1993).

Në të gjitha këto vepra, ai shpreh shqetësimin se esenca shpirtërore e njerëzimit është e kërcënuar nga industrializimi i shpejtë dhe i padoktrinë, i cili përbën gjithashtu një kërcënim për rendin natyror. Ai e përmbledh shqetësimin e tij me fjalët e mëposhtme:

> Sot, gjithnjë e më shumë njerëz po bëhen të vetëdijshëm se zbatimet e shkencës moderne ... kanë shkaktuar direkt ose indirekt fatkeqësi të papara mjedisore, duke rritur rrezikun në lidhje me mundësinë reale të kolapsit të përgjithshëm të rregullit natyror.[58]

Argumentet e Nasrit janë bindëse, dhe veprat e tij janë përvoja të mira shpirtërore, historike, e madje edhe filozofike; vepra të cilat janë me mjaft vlera përsa i takon sferës së simbolizmit kuranor në traditën gnostike. Megjithatë, ai është tepër teorik dhe i lë pyetjet praktike pa përgjigje. Shtrohet pyetja: Pasi myslimanët të arrijnë t'i njohin aspektet metafizike të shkencës islame që Nasr thekson, si mund të krijojnë lidhet e duhura me shkencën moderne që përbën tashmë një realitet? A duhet me të vërtetë ta hedhin poshtë atë dhe të fillojnë përsëri edhe një herë nga e para për llogari të tyre?

Sardar gjithashtu përkrah zhvillimin e një shkence islame e cila njeh pronësinë e Allahut mbi të gjitha njohuritë. Ai ka shkruar disa libra për këtë, më të rëndësishmit prej të cilëve janë: *E ardhmja e qytetërimeve Muslimane* (1987), *E ardhmja islame: Forma e ideve që do të vijnë* (1988), dhe *Eksplorim në shkencat islame* (1989). Është e qartë nga punimet e tij se ithtarët e shkencës islame nuk pajtohen madje as në përkufizimet bazë. Sardar ka

vërejtje për gnosticizmin e Nasrit, refuzon Bucaillie-izmin, kritikon numerologjinë absurde të Khalifa-s, dhe akuzon el-Faruqi-n se kërkon të ulë rangun e Islamit nëpërmjet "islamizimit" të formave ekzistuese të dijes. Kështu, sipas Sardar-it, dijet ekzistuese duhet t'i përshtaten Islamit në vend që t'i përshtatet Islami dijeve ekzistuese.

Sardar argumenton se një qytetërim, për të mbijetuar, duhet të posedojë një filozofi shkencore. Nëse nuk e bën këtë, atij do t'i duhet të pranojë të gjitha filozofitë joautoktone së bashku me të gjitha supozimet e tyre themelore. Ai propozon një kuadër brenda të cilit njohuritë shkencore duhet të konceptohen në Islam. Edhe pse idetë e tij janë shumë më me këmbë në tokë sesa idetë gnostike të Nasrit, problemi themelor ende mbetet i pazgjidhur: Si mund të mbijetojnë myslimanët në botën e sotme, nëse ata fillojnë përsëri nga e para të vetëm, ndërsa iu duhet të konkurrojnë me dinjitet arritjet teknologjike shkencës moderne, në mënyrë që të ruajnë qytetërimin islam? Punimet e Sardar-it janë padyshim substanciale, por arritjet e tij mbeten thjesht në rrafshin teorik, duke qenë shumë larg nga zbatimi në praktikë i këtyre ideve shkencore.

Një shkencë islame, e cila është plotësisht e pavarur prej shkencës moderne, mund të jetë një mundësi për të ardhmen, nëse shkencëtarët e përfshirë në të do të mund ta zhvillojnë atë praktikisht dhe të tregojnë se si ajo mund të përdoret për të zgjidhur probleme praktike. Por çështja e sotme që shtrohet për diskutim për myslimanët përmban dy aspekte: Cila është mënyra më e mirë për të përparuar në një botë të dominuar nga shkenca moderne pa shkelur parimet islame; dhe A duhet të bashkëpunojnë ata me shkencëtarë të tjerë për ta zhvilluar më tej shkencën moderne?

Një pikë e mundshme takimi

Shkenca nuk është e huaj për shoqërinë myslimane, siç mund të shihet nga një numër i madh i shkencëtarëve të shkëlqyer myslimanë që kanë jetuar në të kaluarën. Duke pasur parasysh këtë,

nuk ekziston asnjë arsye përse përdorimi i saj i saktë nga ana e myslimanëve të mos i ndihmojë ata të jenë myslimanë të mirë dhe qytetarë të një bote më komode. Është e rëndësishme të theksohet se shkenca moderne, në formën që ekziston sot, nuk është produkt vetëm i Perëndimit, por përmban edhe kontributet historike të shkencëtarëve myslimanë, shumica prej të cilëve ende gëzojnë mjaft respekt në komunitetin shkencor botëror. Sipas Hoodbhoy:

> *Ajo që ka ndodhur sot, është se Perëndimi e ka marrë përsipër udhëheqjen* e shkencës duke e katandisur atë në gjendjen e saj aktuale antihumane, me anë të së cilës ai dikton jetën e individëve ... dhe fut hundët madje edhe në marrëdhëniet njerëzore.[59]

"Të ecurit keq" të shkencës do të ishte një arsye jo e përshtatshme për myslimanët që të braktisin kontributet e paraardhësve të tyre dhe t'ia nisin nga e para. Ata kanë udhëzimin e tyre hyjnor dhe mund ta përdorin atë për ta vënë edhe një herë shkencën në rrugën e duhur. Por kjo nuk duhet të përbëjë një licensë për myslimanët për t'u bërë konsumatorët bosh të teknologjisë perëndimore; duke e kontrolluar atë vetëm për ato ç'janë të lejuara (hallall) dhe të ndaluara (haram). Me indikacionet dhe nxitjn e Kuranit, myslimanët duhet të ushtrojnë veten e tyre dhe të japin kontribute origjinale në kërkimin shkencor, duke investuar në të, përsa kohë që ato të jenë në përputhje me drejtimin doktrinor dhe me vlerat morale islame. Përndryshe, si mund të ankohen kundër shkencës moderne për faktin se armiqësia ndaj fesë ende vazhdon të ekzistojë, kur ata i kanë lejuar vetë të tjerët që ta udhëheqin shkencën, madje ta dominojnë dhe ta kontrollojnë atë?

Shkenca është lënë pas dore në disa nivele: në nivelin e myslimanëve të thjeshtë të cilët duhet të angazhohen në kërkime shkencore; në nivel drejtuesish fetarë të cilët duhet t'i inkurajojnë besimtarët që të studiojnë shkencën dhe në nivel udhëheqësish politikë, të cilët duhet të ndjekin shembullin e paraardhësve të tyre si Kalifi Mu'takid dhe udhëheqës të tjerë të cilët i patën përkrahur kërkimet shkencore.

Profesori Mohammed Abdus-Salam, fitues i çmimit Nobël në

vitin 1979, ka shprehur shqetësimin e tij në lidhje me këtë mosvlerësim:

> Unë i kam pyetur vazhdimisht ulema-të se pse nëpër predikimet e tyre nuk i këshillojnë myslimanët që të merren me lëndët e shkencës dhe teknologjisë, duke pasur parasysh se një e teta e Librit të Shenjtë flet për teffekur-in (gj. shq. – meditimin, shën. red.) dhe teskhir-in (shkencën dhe teknologjinë).[60]

Argumentet e tjera të tij nënkuptojnë se Islami mund të ofrojë udhëzime dhe nxitje në çështjet e vëzhgimit të saktë shkencor, por se rezultatet duhet të jenë në mënyrë të dukshme objektive, dhe se myslimanët janë po aq të aftë për ta arritur këtë sa çdo njëri tjetër në mos edhe më mirë. Ai shprehet:

> Ne [Abdus Salam dhe dy shkencëtarët e tjerë me të cilët ai ndau çmimin] ishim "ideologjikisht dhe gjeografikisht të largët nga njëri-tjetri" kur konceptuam të njëjtën teori fizike në lidhje me unifikimin e forcave elektromagnetike dhe ato të bashkëveprimit të dobët. Nëse ka ekzistuar ndonjë paragjykim drejt kësaj paradigme të unifikimit në mendjen time, ajo ka qenë e motivuar nga prejardhja ime prej myslimani.[61]

Së fundi, është e rëndësishme të theksoj se realitetet socio-politike dhe ekonomike të një rajoni të caktuar, janë mjaft të rëndësishme për përparimin shkencor. Sipas Soliman, Islami siguron kushtet për një sistem shoqëror, politik dhe ekonomik, që do t'i lejojë shkencëtarët të punojnë në qetësi, nën mbrojtjen dhe sponsorizimin e shtetit, dhe të sigurojnë rezultate të tilla si ato të prodhuara në botën myslimane, përpara ndarjes mes udhëheqësve dhe shkencëtarëve.[62] Kjo do të thotë se disa prej kushteve të nevojshme për progresin shkencor, janë jashtëshkencore. Udhëheqësit e botës myslimane nevojitet të krijojnë një sistem që u mundëson shkencëtarëve të tyre për të punuar në siguri dhe komoditet. Kur myslimanët ta bëjnë këtë, ata nuk do të kenë më nevojë të ankohen për frymën jofetare të shkencës moderne, sepse ata do të jenë në ballë të saj.

Përfundim

Unë do të doja ta përmbyll duke theksuar pikat e mëposhtme:

- Myslimanët besojnë se e gjithë dituria është pronë e Zotit, i Cili i ka dhënë njerëzimit detyrën dhe aftësinë për ta kërkuar, për ta marrë, dhe për ta përdorur një pjesë të kësaj dijeje me qëllim që të përmirësojë kushtet e tij të jetesës, ndërsa njerëzit ndodhen këtu si mëkëmbës të Zotit. Njohuritë shkencore janë një pjesë e këtij trupi të përgjithshëm të dijes, dhe ato presin zbulimin nga njerëz të gatshëm të lodhin vetveten në kërkim të tyre.
- Shkencëtarët myslimanë kanë qenë në të shkuarën kërkues të zellshëm të dijes. Sot ata nderohen edhe nga njerëz që do të ishin të lumtur për të besuar se ata nuk kanë ekzistuar kurrë. Edhe ata të cilëve nuk u janë njohur meritat, formojnë një pjesë të themeleve mbi të cilat është ndërtuar shkenca moderne.
- Kurani ofron udhëzim hyjnor, por nuk është një libër i shkencës. Përpjekjet për ta paraqitur atë si të tillë, vetëm se kënaqin ata, të cilët presin rastin për të provuar "pasaktësinë" e tij. Po ashtu, ai është një libër i shenjtë dhe nuk mund të testohet për saktësinë e tij, siç është përpjekur të bëjë Khalifa me "teorinë e tij matematike të numrit 19".
- Besimi është pasuria më e çmuar e secilit mysliman dhe nuk mund të flaket as edhe në zenitin e arritjeve shkencore.
- Shkencëtarët perëndimorë i kanë tejkaluar kufijtë me përdorimin e tyre të rezultateve të kërkimit shkencor modern. Mosbesimi në Zotin, nivelet e ulëta të moralit, dhe skllavërimi i njerëzimit ndaj makinerive dhe proceseve mekanike, janë zhvillime të rrezikshme. Është për të ardhur keq që ata janë të lidhur me veprimtari aspak dinjitoze dhe të domosdoshme të kërkimit shkencor.

  Gjendja e shkencës në vendet myslimane është për të ardhur keq, sidomos duke pasur parasysh historinë e tyre të lav-

dishme shkencore. Një arsye për këtë është se udhëheqësit e sotëm të vendeve myslimane, nuk ndjekin shembullin e paraardhësve të tyre në lehtësimin e kushteve për kërkimin shkencor.

- Shkenca moderne, siç e njohim ne sot, është ndërtuar përgjatë një periudhe të shtrirë kohore dhe përmban kontribute nga shkencëtarë të qytetërimeve të ndryshme. Qytetërimi islam ka qenë një kontribues i madh për këtë zhvillim. Kur myslimanët përdorin objektet e lejuara të shkencës moderne, ose kur vendet myslimane huazojnë teknologji të zhvilluara nga shkenca moderne, ata janë thjesht duke u kthyer në një miniaturë të tyre, duke marrë shembull nga praktika e vjetër e transferimit të teknologjisë nga ana e el-Muradit në ndërtimin e sahatëve me ujë në Evropë.

  Nuk duhet harruar se Islami i pranon dhe ende jeton krah për krah me ato aspekte të kulturës dhe arritjeve që nuk bien në kundërshtim me kredon e tij. Por shkencëtarët myslimanë kanë përpara sfidën e dhënies së kontributeve origjinale, sikurse kanë bërë paraardhësit e tyre. Ata nuk duhet të mjaftohen vetëm me "zbulimet" në fushën e embriologjisë dhe astronomisë në Kuran, pas zbulimit të tyre nga ana e shkencëtarëve modernë. Të "armatosur" me udhëzim kuranor, shkencëtarët myslimanë, mund të drejtojnë dhe të udhëheqin procesin e përgjithshëm të kërkimit shkencor. Nuk është e nevojshme që shkenca islame të nisë funksionimin edhe një herë nga e para dhe të jetë e shkëputur nga pjesa tjetër e shkencës globale. Megjithatë, ajo duhet të jetë një shkencë që e njeh vlerën e aspekteve pozitive kërkimore të mëparshme, por të jetë e pastruar nga ateizmi, e mbushur me parime morale, dhe e praktikuar në emrin e Zotit, në mënyrë që t'i shërbejë njerëzimit.

  Shkencëtarët e të gjitha bindjeve, pro apo antifetare, do të vazhdojnë të formojnë një familje kërkuesish të dijes. Megjithatë, nën një udhëheqje të mirëfilltë myslimane, veset e

shkencës moderne mund të kontrollohen, në mënyrë që bota të mund të gëzojë përfitime të parrezikshme, kësodore, bota myslimane të mund të zgjidhë më në fund "problemin" me shkencës moderne. Kjo do të kërkojë që të gjithë burrat dhe gratë, të punojnë me guxim dhe përkushtim të lartë, si për Islamin, ashtu edhe për shkencën.

Burime shtesë

- *Bulletin of the Islamic Medical Association of South Africa* (MMA), vol. 6, nr. 1 (Prill 1985): 1-2.
- Bucaille, Maurice. "The Qur'an and Science" (pamflet). 1989.
- Chandler, Robert E jr. *An Adventure in Applied Science*. Manila: International Rice Research Institute, 1982.
- Al-Daffa, Ali A. dhe John J. Stroyis. *Studies in the Exact Sciences in Medieval Islam.* Chichester, UK: John Wiley & Sons, 1984.
- Hott, Edwin P. *Arab Science*. Nashville: Thomas Nelson Ltd., 1975.
- Kennedy, E. S. *Studies in the Islamic Exact Sciences*. Beirut: American Univ. në Beirut, 1983.
- Khalifa, Rashid, *Miracle of the Qur'an*. St. Louis: Islamic Productions International, 1973.
- _____(1982a), Qur'an: *Visual Presentation of a Miracle*, Islamic Productions International, Tucson (Arizona).
- _____(1982b), *Qur'an, Hadith and Islam*, Islamic Productions International, Tucson (Arizona).
- Kauda, Manzoori-i. *Muslim Perspective* (Mars 1985). Masjid Tucson.
- Nasr, Seyyed Hossein. *Traditional Islam in the Modern World*. London: Kegan and Paul Ltd., 1987.
- *An Introduction to Islamic Cosmological Doctrines*. Bath: Thames and Hudson Ltd., 1978.
- *Islamic Science: An Illustrated Study*. London: World of Islam Festival, 1976.
- *The Encounter of Man and Nature*: The Spiritual Crisis of Modern

Man. London: Allen and Unwin, 1968.

- Negus, Yunus. *"Science Within Islam,"* in Khalid, Fazlun and Joanne O'Brien (red.). Islam and Ecology. New York: Cassell Publishers Ltd., 1992.
- Ibn Rushd, Muhammad. Tahafut al-Tahafitt (*The Incoherence of the Incoherence*). përkth. S. Van den Bergh. vol. 1, London: E. J. W Gibb, Memorial Series, 1969 bot.
- Sardar, Ziyauddin. *The Future oj Muslim Civilizations*. London: Mansell, 1987.
- Said, Hakim Mohammed. Al-Biruni *Commemorative Volume*. Karachi: Hamdard Academy, 1979.
- Swartz, Melin L. *Studies in Islam*. London: Oxford Univ. Press, 1981.
- Williams, Trevor I. (ed.). *A Biographical Dictionary of scientists,* London: Adam & Charles Black Ltd., 1969.

SHKENCA DHE FEJA

M. Fethullah Gylen & Ali Ünal

Çështja nëse Kurani i referohet apo jo në mënyrë eksplicite apo implicite fakteve shkencore, si dhe marrëdhënia e përshtatshme mes Kuranit dhe shkencës moderne, përbëjnë tema mjaft të debatueshme në mesin e intelektualëve myslimanë. Prandaj, ne do të përpiqemi ta trajtojmë këtë temë në premisa më gjithëpërfshirëse.

Shkenca dhe feja

Shkenca e konsideron si shkencor çdo fakt të vërtetuar nëpërmjet metodave empirike. Prandaj, pohimet e nxjerra jo përmes vëzhgimit dhe eksperimentit, janë vetëm teori apo hipoteza.

Meqenëse shkenca nuk mund të jetë e sigurt për të ardhmen, ajo nuk bën parashikime të caktuara. Dyshimi është baza e kërkimit shkencor. Megjithatë Profeti Muhamed (s.a.s.), i cili mësoi nga i Gjithëdijshmi, ka bërë parashikime mjaft vendimtare. Shumica tashmë janë vërtetuar, pjesa tjetër janë duke pritur për kohën e duhur për t'u vërtetuar. Shumë vargje kuranore tregojnë për faktet e vërtetuara shkencërisht, të zbuluara kohët e fundit. Siç u theksua më lart, Kurani përmend shumë çështje të rëndësishme të krijimit dhe të fenomeneve natyrore, të tilla që edhe personi më inteligjent që ka jetuar 14 shekuj më parë, nuk mund të kishte si t'i dinte. Për më tepër, ai përdor mrekullitë e profetëve për të aluduar në arritjet afatgjata të shkencës, e cila e ka zanafillën në diturinë e të Gjithëdijshmit.

Qytetërimi që krijoi Islami

Konflikti mes shkencës dhe fesë në Perëndim daton qysh në shekullin XIII. Karakteri esencial i versionit të Kishës Katolike në

lidhje me Krishtërimin, solli për pasojë dënimin e natyrës si një vello që ndante njerëzimin nga Zoti, si dhe mallkimin e njohurivë natyrore. Si rezultat i kësaj, shkenca nuk ka përparuar gjatë Mesjetës (e njohur ndryshe si Epoka e Errët në historinë evropiane).

Megjithatë, gjatë së njëjtës periudhë, një qytetërim madhështor lulëzoi në Lindjen myslimane. Duke iu bindur urdhëresave kuranore, myslimanët studiuan Librin e Zbulesës Hyjnore (Kuranin) dhe Librin e Krijimit (gjithësinë) dhe themeluan qytetërimin më madhështor në historinë e njerëzimit. Studiuesit nga i gjithë kontinenti i vjetër, përfituan nga qendrat e arsimit të lartë në Damask, Bukhara, Bagdad, Kajro, Fez, Kairawan, Zeitona, Cordoba, Sicili, Isfahan, Delhi, dhe gjetiu, nëpër të gjithë botën myslimane. Historianët e krahasojnë botën myslimane të asaj kohe në një zgjua bletësh, sepse rrugët ishin plot me studentë, shkencëtarë dhe studiues që udhëtonin nga një qendër e të mësuarit në një tjetër. Figura të tilla të njohura botërisht si Al-Kindi, el-Khuarizmit, el-Farabi, Ibn Sina, al-Mas'udi, Ibni al-Hajtham, el-Biruni, Nasir al-Din al-Tusi, al-Zahravi dhe shumë e shumë të tjerë, shkëlqyen si yje në qillin e shkencës.

Në veprën e tij shumëvëllimëshe të titulluar *Hyrje në historinë e shkenc*ës (1927-1948), George Sarton, e ndau studimin e tij në periudha 50-vjeçare, dhe e emërtoi çdo kapitull sipas shkencëtarit më të shquar të kësaj periudhe. Që nga mesi i shekullit VIII (shekullit të dytë Hixhri) e deri në shekullin XII (shekullin e pestë Hixhri), secila prej të shtatë periudhave 50 -vjeçare, mbart emrin e një shkencëtari mysliman: "Periudha e el-Khuarizmit ", "Periudha e El-Birunit", e kështu me radhë. Brenda këtyre kapitujve, Sarton rendit 100 shkencëtarët më të rëndësishëm myslimanë si dhe veprat e tyre kryesore.

John Davenport, një shkencëtar i shquar, vëren:

> Duhet të kihet parasysh se e gjithë dija, qoftë ajo në fushën e fizikës, qoftë në astronomi, filozofi apo matematikë, e cila lulëzoi në Evropë duke filluar që nga shekulli X, e kishte origjinën nga shkollat arabe, ndaj saraçenët spanjollë duhen parë si baballarët e filozofisë evropiane.[1]

Bertrand Russell filozof i famshëm britanik, shkroi:

> Epërsia e Lindjes nuk ishte vetëm ushtarake. Shkenca, filozofia, poezia dhe artet, të gjitha këto lulëzuan në botën muhamedane, në një kohë kur Evropa ishte e zhytur në barbarizëm. Evropianët, me një egocentrizëm të pafalshëm, e quajnë këtë periudhë si "Epoka e Errët": por e vërteta është se vetëm në Evropë ajo ishte e errët - madje në të vërtetë vetëm në Evropën e krishterë, sepse Spanja, e cila ishte muhamedane në atë periudhë, ka pasur një kulturë të shkëlqyer.[2]

Robert Briffault, një historian i njohur, pranon në librin e tij *Krijimi i njerëzimit*:

> Ka shumë mundësi që pa arabët, qytetërimi modern evropian kurrë nuk do të kishte mundur të fitonte atë lloj karakteri, i cili i ka mundësuar atij të kapërcejë të gjitha fazat e mëparshme të zhvillimit. Sepse, nuk ekziston as edhe një aspekt i vetëm i progresit njerëzor, në të cilin ndikimi vendimtar i kulturës islame të mos ketë lënë gjurmë; kjo askund nuk është kaq e qartë dhe e dukshme sa në gjenezën e asaj fuqie, e cila përbën fuqinë madhore të botës moderne - fitoren e shkencave të saj natyrore dhe shpirtit shkencor ... Ajo që ne e quajmë shkencë, lindi në Evropë si pasojë e një fryme të re të studimit; të metodave të reja të studimit, të metodës së eksperimentit, vëzhgimit, matjeve, zhvillimit të matematikës në një formë të panjohur për grekët. Ky shpirt dhe këto metoda u futën në botën evropiane nga arabët.[3]

L. Stoddard pranon se gjatë pesë shekujve të parë të saj, perandoria e Islamit ishte pjesa më e qytetëruar dhe progresiste e botës. E stolisur me qytete të mrekullueshme, xhami përrallore dhe universitete të qeta, Lindja myslimane ofronte një dallim thelbësor nga Perëndimi, i cili ishte i zhytur në terrin e Mesjetës.[4]

Ky qytetërim i ndritur, përparoi derisa pësoi fatkeqësi të tmerrshme që erdhën njëra pas tjetrës si dallgë të mëdha: Kryqëzatat evropiane (1097-1270) dhe pushtimi mongol (1216-1258). Këto fatkeqësi vazhduan për shekuj me radhë, derisa qeveria myslimane në Bagdad u shemb (1258) dhe historia e Islamit hyri në një fazë të re në shekullin XIII me Turqit Osmanë.

Qytetërimi islam ishte ende i fuqishëm dhe ndodhej shumë përpara Perëndimit në fushën ekonomike dhe ushtarake deri

në shekullin XVIII, pavarësisht se (që nga shekulli i XVI e tutje) humbi terren në shkencë.

Në shekullin X, Kordoba myslimane ishte qyteti më i qytetëruar i Evropës, çudia që ngjallte admirimin e mbarë botës. Udhëtarët nga Veriu dëgjonin të mahnitur histori rreth qytetit që përmbante 70 biblioteka me qindra e mijëra vëllime, si dhe 900 banjo publike. Kurdo që sundimtarëve të Leonit, Navarrës, ose Barcelonës u nevojitej një kirurg, arkitekt, rrobaqepës, apo muzikant, ata kontaktonin me Kordobën. Prestigji letrar mysliman ishte aq i madh në Spanjë, sa Bibla dhe liturgjia duhej të ishte patjetër e përkthyer në gjuhën arabe për komunitetin indigjen të krishterë. Fjalët e shprehura nga Alvaro, një shkrimtar i zellshëm i krishterë, janë një shembull mjaft i qartë se si edhe spanjollët jomuslimanë ishin magjepsur nga letërsia arabike/myslimane:

> Vëllezërit e mi të krishterë ndiejnë kënaqësi nga poezitë dhe romancat e arabëve. Ata studiojnë veprat e teologëve dhe filozofëve muhamedanë, jo për t'i hedhur poshtë ato, por për të fituar një stil korrekt dhe elegant të gjuhës arabe. Ku mund të gjesh sot një dijetar i cili lexon komente Shkrimesh të Shenjta në gjuhën latine? E kush i lexon më në origjinal Ungjijtë, Profetët, Apostujt? Mjerisht, të krishterët e rinj, të cilët janë më të spikatur për talentin e tyre, nuk kanë njohuri në lidhje me ndonjë literaturë ose gjuhë tjetër përveç asaj arabe; ata lexojnë dhe studiojnë me etje libra arabë; ata grumbullojnë biblioteka të tëra prej tyre me një kosto mjaft të lartë, dhe ata kurdoherë i këndojnë lutjet e tyre në arabisht.[6]

Nëse qëllimi i edukimit dhe qytetërimit është për të rritur krenarinë, dinjitetin dhe nderin e njerëzve, në mënyrë që ata të mund të përmirësojnë gjendjen e tyre dhe rrjedhimisht edhe gjendjen e shoqërisë, qytetërimi islam e ka provuar vlerën e tij. Shumë shkrimtarë kanë trajtuar aftësinë e Islamit për të transformuar shoqëritë me të cilat ai hyn në kontakt. Për shembull, në fjalën e tij në Kongresin e Kishës së Anglisë në lidhje me efektet e Islamit dhe ndikimin e tij mbi njerëzit, Isaac Taylor tha:

> Kur përqafohet Muhamedanizmi, koncepte si paganizmi, fetishizmi, vrasja e fëmijëve dhe magjia, zhduken. Ndotja zëvendësohet nga pastërtia dhe të konvertuarit e rinj fitojnë dinjitetin personal dhe respektin

për vetveten. Vallëzimet e pacipa dhe marrëdhëniet e paligjshme seksuale ndalojnë; dëlirësia e femrës çmohet si virtyt, industria zëvendëson plogështinë; licensat jepen në përputhje me ligjin; rregulli dhe seriozioziteti mbizotërojnë; gjakmarrjet, egërsia ndaj kafshëve dhe skllevërve çrrënjosen. Islami shkundi korrupsionin dhe besëtytnitë. Islami ishte një revoltë ndaj polemikave boshe. Ai dha shpresë për skllevërit, vëllazëri për njerëzimin dhe njohje të fakteve fundamentale të natyrës njerëzore. Virtytet që Islami ngulit janë vetëkontrolli, pastërtia, dëlirësia, drejtësia, guximi, trimëria, dashamirësia, mikpritja, vërtetësia dhe përulтësia ... Islami predikon një vëllazëri praktike dhe barazi sociale për të gjithë myslimanët. Skllavëria nuk është pjesë e besimit islam. Poligamia është një çështje pak më e ndërlikuar. Moisiu nuk e ka ndaluar atë. Ajo u pat praktikuar nga Davidi dhe nuk është e ndaluar në mënyrë të drejtpërdrejtë në Dhjatën e Re. Muhamedi e kufizoi lejen e pakufishme për poligami. Ajo përbën një përjashtim më tepër sesa një rregull të përgjithshëm...Me bindje të plotë ndaj Vullnetit të Zotit, me pastërti, dëlirësi, vetëpërmbajtje dhe në vëllazëri me njëri-tjetrin, ata (myslimanët), kanë themeluar një traditë të cilën ne do të bënim shumë mirë sikur ta ndiqnim. Islami ka ndaluar dehjen, bixhozin dhe prostitucionin, tri mallkimet e vendeve të krishtera. Islami ka bërë shumë më tepër për qytetërimin sesa Krishtërimi. Shtrirja e fesë së tij (Muhamedit, në një të tretën e sipërfaqes së rruzullit, përbën një mrekulli.[7]

Shkenca dhe qasja moderne shkencore

Bëmë një hyrje paksa të gjatë në këtë temë për të sqaruar një aspekt: qëndrimet kundërshtuese të botës myslimane përsa i takon marrëdhënieve mes Islamit dhe shkencës.

Për shumë vite me rradhë, të ndikuar nga dominimi perëndimor mbi vendet e tyre për shkak të superioritetit në shkencë dhe teknologji, disa intelektualë myslimanë hedhin akuza mbi vetë Islamin si shkaktarin e prapambetjes së popujve myslimanë. Duke harruar njëmbëdhjetë shekujt e supremacisë Islame, ata mendojnë dhe shkruajnë sikur historia e Islamit të kishte filluar në shekullin e tetëmbëdhjetë. Për më tepër, ata bëjnë gabimin e pafalshëm që identifikojnë marrëdhëniet midis shkencës dhe fesë në përgjithësi, nën termat specifike të marrëdhënieve

mes shkencës dhe Krishtërimit. Ata nuk marrin mundimin as të bëjnë qoftë edhe një studim sipërfaqësor në lidhje me Islamin dhe historinë e tij të gjatë.

Në kontrast me këtë, të tjerë intelektualë bashkëkohorë myslimanë ndjekin shembullin e disa nga homologëve të tyre perëndimorë, ku dënojnë plotësisht shkencën dhe teknologjinë dhe mbajnë një qëndrim pothuajse krejtësisht idealist. Ata e bëjnë këtë duke parë efektet e fatkeqësive, bombave atomike, vrasjeve masive, ndotjes së mjedisit, humbjes së të gjitha vlerave morale dhe shpirtërore, "delirin" nga i cili vuajnë njerëzit modernë, e të tjera dukuri negative që shkenca dhe teknologjia i kanë sjellë njerëzimit; të metat dhe gabimet që qasja e njëanshme shkencore ka sjellë në kërkimin e së vërtetës, si dhe dështimin e shkencës dhe teknologjisë për t'i sjellë lumturinë e synuar njerëzimit. Megjithatë, Islami është rruga e mesme. Ai nuk e refuzon, dënon, apo "adhuron" qasjen moderne shkencore.

Shkenca ka qenë idhulli më i adhuruar apo fetishizuar i njerëzve modernë prej gati 200 vjetësh. Shkencëtarët dikur besonin se ata mund të shpjegonin çdo fenomen nëpërmjet shkencës dhe ligjit të rastësisë. Megjithatë, fizika moderne i shkatërroi themelet teorike të fizikës mekanike dhe zbuloi se universi nuk është një funksionim mekanik i pjesëve të tij, sipas ligjeve strikte dhe të pandryshueshme të rastësisë dhe determinizmit absolut. Përkundrazi, megjithë harmoninë e tij mahnitëse dhe rregullin madhështor, ai është aq i ndërlikuar dhe i papërcaktuar, sa me t'u zbuluar një mister, dalin në pah edhe shumë të tjerë. Kështu, sa më tepër ne mësojmë në lidhje me universin, aq më shumë rritet niveli i padijes sonë për të.

Ekspertë të fizikës atomike, thonë se askush nuk mund ta dijë me siguri nëse universi do të jetë në të njëjtën gjendje si tani, qoftë edhe pas një çasti. Megjithëse gjithësia funksionon sipas ligjeve të caktuara, këto ligje nuk janë absolute dhe ajo çfarë është më interesante, nuk kanë ndonjë ekzistencë reale apo materiale. Përkundrazi, ekzistenca e tyre është e karakterit nominal, për arsye se

ne i nxjerrim ato nëpërmjet vëzhgimit të ngjarjeve dhe dukurive natyrore.

Gjithashtu, është mjaft e paqartë shkalla në të cilën ato marrin pjesë në krijimin dhe funksionimin e gjërave. Për shembull, shkencëtarët shprehen se fara, dheu, ajri dhe uji janë ato që e bëjnë një bimë të ekzistojë, e megjithëse ato janë vetëm shkaqe në këtë rezultat. Ekzistenca e një peme kërkon llogaritje të sakta, si dhe raporte e relacione të paracaktuara të farës, dheut, ajrit dhe ujit. Shkenca ka për detyrë të shpjegojë se si nis ky proces dhe se si rriten dhe shumëfishohen farat. Por gjithçka që ajo arrin të bëjë tani për tani, është të shpjegojë etapat e rritjes, duke u munduar t'i japë shpjegim origjinës së ekzistencës nëpërmjet atribuimit të saj natyrës, vetëorigjinës, nevojës apo shansit rastësor:

> Natyra është një kopje apo model i përbërë nga ligje të padukshme, por jo një makineri kopjimi apo ndërtuese. Ajo është një dizenjim, por jo dizenjues; pasoja, por jo shkaku; rregulli, por jo ai që e ka vendosur këtë rregull. Ajo përbën një koleksion ligjesh të vendosura nga Vullneti Hyjnor [të cilat mendja jonë arrin t'i perceptojë, por], që në vetevete nuk kanë fuqi apo realitet material.[8]

Atribuimi i ekzistencës vetëorigjinës, nevojës apo shansit rastësor, përbën një zhgënjim, sepse ne arrijmë të vërejmë se kjo ekzistencë pasqyron një dije absolute, mençuri absolute, vullnet absolut dhe fuqi absolute. Vetëorigjina, nevoja apo shansi rastësor janë vetëm koncepte pa domethënie materiale, prandaj ato nuk mund të zotërojnë ndonjë dije, mençuri, vullnet apo fuqi.

Qëndrimi i shkencëtarëve modernë është mjaft larg gjetjes dhe shpjegimit të së vërtetës që qëndron prapa ekzistencës. E vërteta është e pandryshueshme dhe shkon përtej së dukshmes. Marrëdhënia e saj me botën e dukshme dhe të ndryshueshme, është si ajo mes shpirtit dhe trupit të Ligjeve Hyjnore të natyrës dhe ngjarjeve dhe objekteve natyrore. Për shembull, forca e rritjes (një ligj hyjnor universal), është një karakteristikë e lindur e të gjitha qenieve të gjalla. Ajo mbetet e pandryshueshme, ndërsa një pemë, apo një njeri, ndryshon vazhdimisht. Po kështu, pavarë-

sisht mënyrës se si ndryshojnë veshjet, shtëpia, apo mjetet tona të transportit me kalimin e kohës, ne mbetemi të pandryshuar përsa i takon qëllimeve dhe nevojave tona themelore, e po ashtu edhe në lidhje me ndikimin e tyre në jetën dhe mjedisin tonë. Të gjithë njerëzit ndajnë vlera dhe kushte të caktuara jetese, si: lindja, pjekuria, martesa, lindja e fëmijëve, rritja e tyre dhe vdekja. Të gjithë ne zotërojmë një nivel të caktuar vullneti dhe dëshirash të përbashkëta dhe për më tepër, ndajmë me njëri-tjetrin vlera të caktuara si ndershmëria, butësia, drejtësia, guximi, e kështu me radhë.

Pavarësisht këtyre fakteve, kërkimet shkencore moderne tentojnë ta gjejnë të vërtetën në ndryshimin e natyrës dhe bazohen vetëm mbi ndijesitë e shqisave tona. Mirëpo këto ndijesi janë relative dhe joreale, sepse ato ndryshojnë nga personi në person. Gjithashtu, jo të gjithë njerëzit e kanë aftësinë për të arsyetuar njëlloj. Kështu, është e pamundur që të arrihet në një përfundim të caktuar, duke aplikuar arsyetimin deduktiv, induktiv, apo analitik për të dhënat e bazuara në ndjesitë. Kjo është arsyeja përse qasja moderne shkencore mundohet t'i arrijë të vërtetat përmes eksperimentimit. Megjithatë, pa aksiomat apo premisat e paracaktuara, eksperimentet nuk mund të krijojnë një fakt.

Që nga koha e Hume,[9] ka qenë pranuar në përgjithësi se vetëm për shkak se një ngjarje ka ndodhur dy herë, ose një milion herë në dy apo në një milion vende të ndryshme, ajo duhet të ndodhë përsëri. Për këtë arsye, që prej kohës së kapitullimit të fizikës klasike, epistemologët perëndimore nuk kanë folur më në lidhje me kërkimin e së vërtetës në vetvete, por janë munduar të nxjerrin në dukje variante të përafërta të saj. Popper[10] thotë se ne i konsiderojmë si teorinë e Njutonit ashtu edhe atë të Ajnshtajnit si shkencë ... të dyja nuk ka se si të jenë të vërteta në të njëjtën kohë dhe në të njëjtin vend, por që të dyja mund të jenë të rreme.

Shkenca nuk mund ta gjejë të vërtetën e thelbit të ekzistencës përmes metodave empirike. Prandaj, siç thekson Guenon, shkenca apo shkencëtarët ose duhet të pranojnë konstatimet se shkenca është jo më shumë sesa supozime rreth së vërtetës dhe kështu të

mos njohin asnjë garanci më të lartë sesa saktësia e ndjesive, ose të besojnë verbërisht si të vërtetë çdo gjë që rrëfehet në emër të shkencës."[11] Dyshues në gjetjet e shkencës, shkencëtarët modernë përpiqen për të gjetur një rrugëdalje nëpërmjet agnosticizmit apo pragmatizmit, duke shfaqur kështu paaftësinë e shkencës për të gjetur të vërtetën.

Shkenca duhet të njohë kufijtë e saj dhe të pranojnë se e vërteta është e pandryshueshme dhe shtrihet në sfera përtej botës së dukshme. Veprimi kësisoj, do ta lejojë atë të gjejë vlerën e saj të vërtetë. Relativja nuk mund të ekzistojë pa absoluten. Ndryshimi është i mundur vetëm nëse ekziston e pandryshueshmja, dhe shumëllojshmëria është e mundur vetëm në qoftë se ekziston unikja. Dituria fiton qëndrueshmëri dhe stabilitet vetëm kur arrin pikën e pandryshueshmërisë. Ajo çfarë është e pandryshueshme dhe e përhershme, ndodhet përtej sferës njerëzore. E vërteta nuk është diçka e prodhuar nga mendjet njerëzore; ajo ekziston pavarësisht nesh; detyra jonë është vetëm ta kërkojmë atë.

Konflikti mes fesë dhe shkencës

Të parët e fesë dhe shkencës apo studimeve shkencore si dy disiplina konfliktuale, është një produkt i qëndrimit perëndimor ndaj fesë dhe shkencës. Për të kuptuar këtë konflikt, së pari ne do të diskutojmë mënyrën se si është zhvilluar shkenca në Perëndim.

Ndërsa bëjmë këtë, megjithatë ne duhet të kujtojmë se arsyeja kryesore për këtë progres shkencor ka qenë ndikimi i qytetërimit islam. Meqenëse ky fakt është përmendur më lart, ne do të përqëndrohemi mbi tre faktorë të tjerë: Ndryshimet në të menduarin perëndimor, Protestanizmi, si dhe zbulimet gjeografike, thënë ndryshe kolonializmi.

KRISHTËRIMI DHE NDRYSHIMI I MËNYRËS PERËNDI-MORE TË TË MENDUARIT: Kur Krishtërimi u bë feja zyrtare e Perandorisë Romake, pas 12 vitesh luftë dhe mijëra jetë dëshmorësh, ai e pa veten në një klimë të përhapur epikuriane dhe

qëndrimesh natyraliste apo dijeje njerëzore të shenjtëruar.

Fryma e mësimeve të Jezusit, e njohur më pas si Krishtërimi, e mundi Perandorinë Romake në kurriz të kompromiseve të caktuara doktrinore. Ajo e kufizoi veten nga dashuria dhe e dënoi natyrën si një vel që ndante njerëzimin nga Perëndia. Kështu Krishtërimi hyri në rrugën e shndërrimit në një fe krejtësisht mistike. Megjithatë, Islami dhe të gjitha fetë e shpallura nga Zoti, e shihnin tokën apo natyrën si një fushë në të cilën janë manifestuar emrat më të bukur të Tij, mbi të cilën mendja duhet të reflektojë, në mënyrë që të arrijë tek Zoti i Plotfuqishëm dhe në të cilat është pasqyruar Parajsa.

Kisha, duke shpallur veten si trupin e Krishtit, e në këtë mënyrë duke shijuar autoritetin e tij, i dha Krishterimit formën e përshkruar më lart dhe më vonë kërkoi të fitonte fuqinë e kësaj bote. Ndërsa Evropa ishte e sunduar nga Kisha, një qytetërim madhështor lulëzoi në Lindjen myslimane. Si rezultat i kontaktit të Europës me këtë qytetërim nëpërmjet Kryqëzatave dhe Andaluzisë (Spanjës myslimane), Evropa u njoh me Antikitetin. Filozofia greke (sidomos ajo aristoteliane), epikurianizmi dhe hedonizmi. ashtu si edhe natyralizmi roman, e gjetën rrugën e tyre në mendimin evropian. Kur ky ndërgjegjësim në lidhje me Antikitetin nëpërmjet përkthimeve nga arabishtja dhe nëpërmjet qendrave myslimane të arsimit në Andaluzi dhe Siçili u bashkua me zilinë e Evropës për prosperitetin myslimano-lindor, u përgatit terreni për një Rilindje Evropiane.

Mënyra evropiane e të menduarit ndryshoi mjaft. Muri i hekurt shekullor i Kishës ndërmjet qëndrimeve evropiane dhe Islamit, si edhe pikëpamjet e saj sipas të cilave kjo mënyrë të menduari kërcënonte pushtetin e saj material, sollën një reagim të ashpër ndaj klerit. Klasa intelektuale e sapolindur nuk mund të gjente dot përgjigje në Bibël për pyetjet e parashtruara për shkak të zhvillimeve të reja shkencore dhe ndryshimit të këndvështrimit. Përveç kësaj, ata mendonin se disa pjesë të këtij libri binin kryekëput në kundërshtim me këto zhvillime.

Për shembull, Dhjata e Vjetër, përmend shtatë ditë si ditët e kësaj bote kur përshkruan krijimin: *Dhe ishte mbrëmje, dhe ishte mëngjes - dita e parë* (Gjeneza 1:5). Por koncepti i një dite të përbërë nga një mëngjes dhe një mbrëmje, është koncept këndvështrimi njerëzor. Kurani gjithashtu i përmend ditët dhe thotë se Allahu e krijoi gjithësinë në gjashtë ditë, por pa specifikuar mbrëmje apo mëngjes. Për më tepër, ai e paraqet ditën si një periudhë kohore relative, pa kohëzgjatje të përcaktuar:

> Ëngjëjt dhe shpirti ngjitën tek Ai në një ditë që zgjat pesëdhjetë mijë vjet. (70:4)

> Ata kërkojnë prej teje t'u ngutësh dënimin, por Allahu nuk e thyen premtimin e vet, sepse një ditë tek Zoti yt, është sa njëmijë vjet siç e llogarisni ju. (22:47)

> Ai është që udhëheq çështjen prej qiellit në tokë, pastaj ajo ngjitet tek Ai në një ditë që sipas llogarisë suaj është sa njëmijë vjet. (32:5)

Ka edhe shumë faktorë të tjerë të cilët kanë bërë që shkenca të ecë në drejtim të kundërt me fenë. Megjithatë, shkencëtarë të tillë të mëdhenj si Galileu dhe Bacon, nuk ishin antifetarë; ata të gjithë dëshironin një interpretim të ri të Biblës. Disa shkencëtarë dhe teologë, u përpoqën ta bënin një gjë të tillë. Për shembull, Bacon ishte në favor të metodave eksperimentale në kërkimin shkencor dhe mbronte idenë se një person mund të arrijë nëpërmjet dijes, në çështje hyjnore të tilla si përvoja shpirtërore. Thoma Akuini[13], të cilin disa e paraqesin si kundërpeshën kristiane të Imam Gazaliut, u përpoq të pajtonte Krishtërimin me aristotelizmin. Një tjetër teolog, Nicola de Cusa,[14] iu kundërvu astronomisë së Ptolemeut, duke i mëshuar fort idesë së universit të pafund, qendra e të cilit gjendet kudo dhe askund, duke bërë që të mos ekzistojë periferia e tij. Megjithë përpjekjet e këtyre teologëve dhe shkencëtarëve për të pajtuar Krishtërimin dhe shkencën, nuk qe e mundur që hendeku midis tyre të mbyllej dhe ndarja të evitohej. Kundërshtimi i ashpër i Kishës ndaj zhvillimeve shkencore dhe rizgjimi gradual i Evropës dhe ecja e saj drejt materializmit, ishin për Krishtërimin,

të vështira për t'u përtypur.

Siç shprehet profesor Tawney, njerëzit në Mesjetë ëndërronin lumturinë e përjetshme nëpërmjet veprimtarive dhe sipërmarrjeve ekonomike dhe i trembeshin makutërisë ekonomike e cila shfaqej në formën e dëshirave të fuqishme. Një njeri kishte të drejtë të fitonte aq para sa për të kaluar një jetë sipas statusit të tij social, por sikur të përpiqej të fitonte më tepër, kjo konsiderohej grykësi dhe futej në kategorinë e mëkateve të rënda. Pasuria dhe prona duhet të fitoheshin nëpërmjet rrugëve të ligjshme dhe të qarkullonin në sa më shumë duar që të ishte e mundur.[15]

Por Rilindja i ndryshoi standardet shoqërore e madje edhe ato morale. Mund të themi gjithashtu se të tilla ndryshime ishin shkaku i fillimit të Rilindjes. Po t'i hedhim një vështrim të shpejtë artit të asaj periudhe, do të arrijmë t'a vërejmë këtë ndryshim thelbësor nga moralja dhe shpirtërorja drejt materiales. Për shembull, skulpturat, të cilat Sorokin[16] mendon se krijoheshin nga dëshira për t'i ikur vdekjes dhe nga një lloj simptome sëmundjeje "nervore" ku bëhej paraqitja e qenieve të vdekshme në trajta hyjnish të pavdekshme të seksit femër, e përdornin trupin femëror për të formësuar dëshirat dhe kënaqësitë pasionante, mashtrimin, seksualitetin, si dhe bukurinë fizike. Në artin e Rilindjes, Virgjëresha Mari, nuk ishte më imazhi i modestisë dhe dëlirësisë, i cili të impononte respekt dhe dhembshuri, por gradualisht u shndërrua në imazhin e një femre me hire fizike. Davidi i Mikelanxhelos, është një i ri i fuqishëm, muskuloz dhe i zhveshur, pra një simbol i përsosmërisë fizike.

Njeriu i Rilindjes dëshironte t'i ngjante Odisesë: truplidhur, i hijshëm, inteligjent, i fuqishëm, dhe i aftë në oratori. Ai ishte i bindur se kjo ishte e mundur përmes dijes. Megjithatë, "Zoti" i Biblës ishte xheloz dhe ia ndaloi njerëzimit të hante nga fruti i dijeve:

> Zoti i Plotfuqishëm e mori njeriun dhe e vendosi në Kopshtin e Edenit për ta përpunuar dhe për t'u kujdesur për të. Dhe Zoti i Plotfuqishëm e urdhëroi njeriun: "Ti je i lirë të hash nga të gjitha pemët e kopshtit, por nuk duhet të hash nga pema e dijes së të mirës dhe të keqes, sepse po

> hëngre nga ajo, patjetër do të vdesësh." (Gjeneza 2:15-17)
>
> Dhe Zoti i Plotfuqishëm tha:"[Duke ngrënë nga pema e dijes së të mirës dhe të keqes], njeriu është bërë si ne, duke e njohur të mirën dhe të keqen. Ai nuk duhet të lejohet të zgjasë dorën dhe të marrë gjithashtu nga pema e jetës dhe të hajë, e kështu të jetojë përgjithmonë." Kështu, Zoti i Plotfuqishëm e dëboi atë nga Kopshti i Edenit për të punuar tokën nga e cila kishte dalë. (Gjeneza 3:22-23)

Këto vargje biblike do të ishin burime antipatie për një njeri tipik të Rilindjes dhe i sillnin atij ndër mend hyjnitë greke që ruanin zjarrin e shenjtë nga njerëzimi. Kështu Prometeu, i cili u rebelua kundër perëndive dhe vodhi zjarrin e tyre të shenjtë, rindezi imagjinatën e tyre. Ky ndryshim i qëndrimit ndaj fesë dhe jetës, përbën një pikë kryesore në kuptimin e konfliktit mes shkencës dhe fesë në Perëndim.

PROTESTANIZMI: Sipas Weber-it, shkenca dhe teknologjia në Perëndim nuk është zhvilluar në mënyrë të pavarur; një nga forcat lëvizëse të saj ishte protestanizmi. Ky sekt i krishterë, ishte fillimisht një rebelim kundër autoritetit të Kishës Katolike dhe nuk synonte të largohej rrënjësisht prej dogmës së krishterë.

Weber shkroi se protestanizmi është fatalist në drejtim të historisë dhe fatit njerëzor. Gjithkush është i lindur me mëkatin origjinal, dhe askush nuk mund të shpëtojë nga dënimi i përjetshëm nga veprat e tij apo të saj. Si Luteri, ashtu edhe Kalvini thoshin që Zoti ka destinuar vetëm disa njerëz të caktuar të përzgjedhur për t'i shpëtuar nga ndëshkimi i përjetshëm. Ky status shfaqet me punën e palodhshme të atij personi dhe aktivitetit të vazhdueshëm për të kapërcyer ndjenjat e dobësisë dhe pafuqisë. Me fjalë të tjera, pasuria dhe suksesi i dikujt, tregojnë se sa e do atë Perëndia. Weber pohon se mëria e klasës së mesme kundër të pasurve dhe aristokracisë, i zgjoi ata duke i nxitur për fitime më të mëdha dhe për akumulimin e pasurisë. Fitimi nxit konsumin, konsumi prodhon nevojë të pafundme, dhe nevoja stimulon punën e mëtejshme. Sipas Weber-it, kjo spirale nuk mbaron kurrë, duke luajtur një rol të rëndësishëm në progresin shkencor dhe teknologjik.

Megjithatë, ajo qëndron edhe prapa egoizmit, individualizmit dhe egocentrizmit të njerëzve modernë.

ZBULIMET GJEOGRAFIKE DHE KOLONIALIZMI: Despotizmi mbretëror dhe feudalizmi, kur u bashkuan edhe me autoritetin e Kishës, ua zunë frymën njerëzve. Për shkak të pamundësisë për të përmbushur nevojat e tyre në rritje dhe aksesit të lehtë nëpër oqeane, evropianët filluan të ndërmerrnin ekspedita detare. Nevoja i shtyn njerëzit për të kërkuar dhe mësuar gjëra të reja, dhe metodat natyrore të transportit (lumenjtë dhe detet), u mundësuan njerëzve që jetonin nëpër sipërfaqe të vogla të hynin në kontakte të shpeshta me tokat përreth dhe ato përtej detit.

Evropianët e periudhës së Rilindjes e përqafuan këtë mundësi për të shtuar njohuritë e tyre dhe për të arritur në tokat e largëta. Ata ndoqën gjurmët e arit, dhe u bënë lakmitarë dhe mizorë kudo që e gjetën atë. Këta ishin njerëzit që i hapën rrugën një kolonializmi të pamëshirshëm. Tregtia e skllevërve dhe shfarosja pothuajse totale e popujve autoktonë të Amerikës, Australisë dhe gjetkë, u bë simboli i kapitalizmit dhe kolonializmit në rritje. Vetëm pasi u bë transportimi i thesareve të tokave të reja të pushtuara për në Evropë, filloi të ndodhte Revolucioni Industrial. Të gjithë historianët pajtohen me mendimin se James Watt e shpiku vaporin e tij vetëm pasi qymyri u dërgua në Angli nga Bengali (Indi), pas Betejës së Plassey (1757). Shpikja e vaporit (1809) shënoi fillimin e Revolucionit Industrial. Sot, Shtetet e Bashkuara, popullsia e të cilave përbën vetëm 6% të popullsisë botërore, konsumon 40% të brumit të letrës, 36% të qymyrit, 25% të çelikut dhe 20% të pambukut në shkallë botërore. Të gjitha vendet e zhvilluara së bashku, formojnë vetëm 16% e popullsisë së botës, por konsumojnë 80% të burimeve të saj.

Në përfundim, kujtojmë se kjo lëvizje e pamëshirshme kolonialiste dhe zbulimet gjeografike, janë dy nga faktorët kryesorë të progresit shkencor dhe teknologjik të Evropës.

A përmban kuranı gjıthçka?

> Çelësat e fshehtësisë janë vetëm tek Ai; atë nuk e di kush përveç Tij. Ai e di çfarë ka në tokë dhe në det, Ai e di për çdo gjeth që bie dhe s'ka kokrrizë në thellësi të tokës, s'ka të njomë dhe s'ka të thatë që nuk është në Librin e Qartë (6:59).

Ibn Mes'udi thotë se Kur'ani jep informacion për gjithçka, por ne mund të mos jemi në gjendje ta pikasim çdo gjë të fshehtë që fshihet në Të. Ibn Abasi, ndryshe "Interpretuesi i Kuranit" dhe "Dijetari i Umetit," shprehet se edhe nëse ai do të humbiste frerin e devesë, do të mund ta gjente atë nëpërmjet Kuranit. Xhalal-al-din-al-Sujuti, një dijetar i madh i cili ka jetuar në Egjipt në shkullin XV, shpjegon se të gjitha shkencat apo degët e dijes, mund të gjenden në Kuran.

Po si është e mundur që një libër i përmasave mesatare, për më tepër me një nivel të madh përsëritjesh, të përmbajë gjithçka që ne na duhet të njohim për jetën, shkencën, sjelljen, krijimin, të shkuarën dhe të ardhmen, e kështu me radhë?

Përpara se t'i japim shpjegim kësaj pike të rëndësishme, ne duhet të theksojmë se për të përfituar nga Kurani, i cili kapërcen koncepet e vendit dhe kohës dhe i cili nuk ka varet nga niveli intelektual i lexuesve të tij, ne më parë duhet ta përgatisim vetveten për një gjë të tillë. Ne duhet të kemi besim të plotë në Të dhe të bëjmë më të mirën për të zbatuar parimet e Tij në jetën tonë të përditshme. Ne duhet të shmangemi nga mëkatet sa më shumë që të jetë e mundur. Siç thuhet edhe në Kuran, ne shpërblehemi në bazë të përpjekjeve tona (53/39), prandaj ashtu si një eksplorues detar i kujdesshëm, duhet të kridhemi në "oqeanin" e Tij dhe pa u lodhur apo mërzitur, ta studiojmë atë deri në vdekje.

Për më tepër, neve na nevojitet një nivel i mirë i njohjes së gjuhës arabe për këtë qëllim, e madje edhe njohuri të mjaftueshme në të gjitha degët e shkencavee natyrore dhe fetare. Një interpretim i mirë, kërkon bashkëpunim ndërmjet shkencëtarëve nga të gjitha shkencat natyrore dhe shoqërore, si dhe të dijetarëve fetarë që

janë ekspertë në interpretimin e Kuranit, Hadithit (traditës profetike), fikh-ut (jurisprudencës islame), teologjisë dhe shkencave shpirtërore. Ndërsa lexojmë dhe studiojmë Kuranin, ne duhet ta konsiderojmë atë sikur të na adresohet në vetë të parë, të vetëdijshëm se çdo ajet na drejtohet drejtpërsëdrejti neve. Nëse i mendojmë për shembull, rrëfimet e Tij historike rreth profetëve dhe popujve të tyre si diçka që nuk ka lidhje me ne, nuk do të arrijmë të nxjerrim ndofarë përfitimi prej leximit.

Çdo gjë ka vendin e vet në Kur*an sipas natyrës, rëndësisë dhe vlerës, si dhe vendit të saj në ekzistencë.* Kurani përmban gjithçka, por jo në të njëjtën shkallë. Ai ndjek katër objektiva: për të provuar ekzistencën dhe unicitetin e Zotit, profetësinë, ringjalljen trupore, si dhe adhurimin e Allahut dhe drejtësinë.

Për të realizuar qëllimet e tij, Kurani na tërheq vëmendjen për veprat e Zotit në gjithësi, ku arti i Tij i pakrahasueshëm shfaqet nëpërmjet krijimit, manifestimit të Emrave dhe cilësive të Tij, në mënyrë të përsosur dhe sipas harmonisë që vërehet në ekzistencë. Ai përmend ngjarje të caktuara historike dhe përcakton rregullat e sjelljes së mirë dhe moralit në nivel personal dhe shoqëror, ashtu si edhe parimet e një jetë sociale të lumtur dhe të harmonishme. Përveç kësaj, ai shpjegon se si duhet ta adhurojmë dhe t'i lutemi Krijuesit tonë, na jep disa informacione në lidhje me jetën tjetër, dhe na tregon se si duhet vepruar për të fituar lumturinë e përjetshme dhe për të shpëtuar nga dënimi i përjetshëm.

Çdo gjë është e përfshirë në Kuran, por në nivele të ndryshme. Prandaj, jo çdo gjë është lehtësisht e dukshme. Detyra kryesore e Kuranit është për të na njohur në lidhje me përsosmërinë e Allahut, cilësitë thelbësore dhe veprat e Tij, si dhe me detyrat tona, statusin dhe mënyrën se si t'i shërbejmë Atij. Kështu, ai përmban sikurse farat apo bërthamat, çdo përmbledhje, parim, apo shenjë që janë eksplicite apo implicite, aluduese ose të paqarta, apo sugjeruese. Secili rast ka formën e vet dhe është paraqitur në mënyrën më të mirë për ta bërë të njohur çdo objektiv kuranor, sipas kërkesave dhe kontekstit ekzistues.

Për shembull: përparimi njerëzor në shkencë dhe industri, ka sjellë mrekullitë shkencore dhe teknologjike të tilla si aeroplanë, energji elektrike, transporti i motorizuar, si dhe radio e telekomunikacioni, të cilat janë shndërruar në përbërës themelorë dhe thelbësorë për qytetërimin tonë modern, materialist. Kurani nuk i ka injoruar ato dhe u referohet atyre në dy mënyra:

- E para është, siç do të shpjegohet më poshtë, nëpërmjet mrekullive të profetëve.
- Mënyra e dytë është përmes ngjarjeve të caktuara historike. Me fjalë të tjera, mrekullitë e qytetërimeve njerëzore vetëm meritojnë një referencë kalimtare, një të nënkuptuar, një aluzion, në Kuran.

Për shembull, në qoftë se një avion do t'i thoshte Kuranit: "Më jep të drejtë të zë edhe unë një vend në vargjet tuaja ", atëherë sferat fluturake të Sundimit Hyjnor (planetet, toka, hëna) do të përgjigjeshin në emër të Kuranit :"Ti mund të zësh një vend këtu në proporcion me madhësinë tënde." Nëse një nëndetëse do të kërkonte një vend në Kuran, atëherë nëndetëset e tjera që i përkasin asaj fushe, trupat qiellorë që "notojnë" në "oqeanin" e gjerë të gjithësisë, do t'i përgjigjeshin: "Në krahasim me ne, ti je fare e padukshme." Nëse dritat elektrike të shndritshme si yje do të reklamonin të drejtën për t'u përmendur në Kuran, dritat e tjera shumë më të fuqishme si rrufetë, meteorët dhe yjet që zbukurojnë kurbën qiellore, do të përgjigjeshin: "E drejta juaj për t'u përmendur këtu është në përpjesëtim me shkëlqimin tuaj."

Nëse të gjitha mrekullitë e civilizimit njerëzor do të kërkonin një vend në Kuran me argumentin e finesës së artit të tyre, një mizë e vetme do t'u thoshte: "Ej, heshtni tani! Edhe një krah i imi ka më shumë të drejtë se ju. Nëse të gjitha artet e bukura njerëzore dhe mjetet më delikate do të mblidheshin së bashku, prapseprapë gjymtyrët delikate të trupit tim të vogël, do të ishin shumë më të bukura dhe fine. Ajeti: "*Vërtet ata që ju po adhuroni në vend të Allahut, nuk mund të krijojnë as edhe një mizë, edhe nëse tubohen*

të gjithë për t'ia arritur." (22:73), do t'ju bënte të heshtnit."

Pikëpamjet e Kuranit në lidhje me jetën dhe botën, janë krejtësisht të ndryshme nga ato të shoqërisë moderne. Ai e konsideron këtë botë si një shtëpi pritjeje dhe njerëzit si mysafirë të përkohshëm të kësaj shtëpie, të cilët përgatisin vetveten për jetën e amshuar duke kryer detyrimet e tyre më urgjente dhe më të rëndësishme. Meqë ajo çka është projektuar dhe përdorur kryesisht për qëllime të kësaj bote ka vetëm një pjesë të vogël në shërbimin dhe adhurimit ndaj Allahut, karakteristika këto të themeluara mbi bazën e dashurinë për të vërtetën dhe për botën tjetër, ajo zë një vend në Kuran në bazë të meritave të saj.

Kurani nuk përmend në mënyrë eksplicite çdo gjë të nevojshme për lumturinë tonë në këtë botë dhe në ahiret edhe për një arsye tjetër: Feja është një sprovë hyjnore për të dalluar shpirtrat e lartësuara dhe ato të ulëta nga njëri-tjetri. Ashtu siç rafinohen dhe ndahen matrialet për të veçuar diamantin nga qymyri dhe arin nga dheu, edhe feja i teston qeniet e vetëdijshme për të ndarë pjesën e çmuar të potencialit njerëzor nga fundërrinat.

Meqenëse Kurani është dërguar për të na përsosur, ai aludon vetëm për ato ngjarje të ardhshme që i përkasin kësaj bote, të cilat të gjithë ne do t'i shohim në kohën e duhur, dhe vetëm sa hap derën për arsyetim deri në shkallën e nevojshme, për të provuar argumentin e tij. Nëse çdo gjë do të ishte e qartë, testi për ne do të ishte i pakuptimtë, sepse të vërtetat e obligimeve hyjnore do të ishin lehtësisht të dukshme. Duke pasur parasysh se ne atëherë nuk do të ishim në gjendje t'i mohojmë apo injorojmë ato, konkurrenca pas testimit dhe sprovave tona do të ishte e panevojshme, sepse ne vetëm sa do të duhej të konfirmonim të vërtetën e tyre. Shpirtrat e "qymyrta" do të mbeteshin bashkë dhe nuk do të kishin dallim nga shpirtrat e "diamanta."

Meqë shumica dërrmuese e njerëzve janë të nivelit "mesatar", Kurani përdor një stil dhe gjuhë që mund ta kuptojnë të gjithë. Si një njeri i zakonshëm, ashtu edhe një shkencëtar i madh arrijnë

të përfitojnë nga Kurani, pavarësisht specializimit të tij apo të saj. Një mënyrë shumë e përshtatshme për ta bërë këtë është nëpërmjet simboleve, metaforave dhe alegorive, krahasimeve dhe parabolave. Ata që janë të pajisur me dije (3/7), e gjejnë mënyrën se si t'i qasen dhe të përfitojnë nga Kurani, dhe të dalin në përfundimin se ajo është Fjala e Allahut.

Qytetërimet e mëhershme nuk do të kishin përfituar asgjë nga përmendja në Kuran e zbulimeve bashkëkohore shkencore dhe teknologjike, kështu që pse duhen përmendur ato? Gjithashtu, "të vërtetat" shkencore ndryshojnë vazhdimisht dhe për këtë arsye, ato nuk janë të përjetshme.

Zoti i Plotfuqishëm na dha inteligjencën dhe Kurani na nxit ta përdorim atë për të studiuar veten, natyrën dhe ngjarjet që na rrethojnë. Nëse në të do të përmendeshin zbulimet moderne shkencore dhe teknologjike, apo çdo gjë që lidhet me natyrën, jetën, historinë dhe njerëzimin, atëherë të krijuarit tonë në formën aktuale, do të kishte qenë i pakuptimtë. Allahu na ka krijuar si modelin më të mirë të krijimit, dhe na ka dhënë mjaft aftësi intelektuale. Por në qoftë se çdo gjë do të ishte e qartë, ne nuk do të kishim nevojë për këto, sepse tashmë do të dinim çdo gjë.

Së fundi, në qoftë se Kurani do të përmbante referenca të qarta për çdo gjë që do dëshironim të dinim, ai do të ishte aq i madh dhe i vëllimshëm, sa recitimi i tij i plotë do të ishte i pamundur. Ne nuk do të ishim në gjendje të përfitonim nga drita e tij, dhe me të vërtetë do mërziteshim duke e recituar atë. Kjo do të binte në kundërshtim me arsyet e shpalljes së Kuranit dhe qëllimet e Tij.

Koncepti i shkencës dhe teknologjisë

Pavarësisht nga fatkeqësitë e shkaktuara nga shkenca dhe teknologjia, qasja e tyre e gabuar ndaj së vërtetës, si dhe dështimi i tyre për t'i sjellë lumturinë njerëzimit, ne nuk mund ta dënojmë atë *a priori* dhe të bëhemi idealistë të pastër. Shkenca dhe teknologjia nuk mund të mbajnë mbi supe të gjithë përgjegjësinë e zhvlerë-

simit të njerëzimit, tkurrjen e ndjenjave, zemërngushtësinë, dhe humbjen e virtyteve të veçanta njerëzore, së bashku me dobësimin serioz të shëndetit mendor dhe aftësisë për të gjykuar. Përkundrazi, faji qëndron tek shkencëtarët, të cilët shmangin përgjegjësitë e tyre, të cilët e shtyjnë shkencën për t'u zhvilluar në një atmosferë materialiste dhe pothuajse krejtësisht shkencore, dhe pastaj e lejojnë atë të shfrytëzohet nga një pakicë e papërgjegjshme. Këto kushte mjaft shqetësuese ndoshta nuk do të ekzistonin, nëse shkencëtarët do të kishin qenë të vetëdijshëm për përgjegjësinë e tyre sociale, dhe nëse kisha nuk do ta kishte detyruar shkencën të zhvillohej në krah të kundërt me fenë.

Duke rrjedhur drejt së ardhmes si një lumë i furishëm dhe i shpejtë, plot me energji dhe vitalitetit, dhe ndonjëherë duke i ngjarë një kopshti vezullues, bota natyrore, është për ne si një libër për t'u studiuar, një ekspozitë për t'u soditur, nga e cila ne mund të përfitojmë. Ne kemi përgjegjësinë të studiojmë kuptimin dhe përmbajtjen e këtij thesari, në mënyrë që brezat e ardhshëm të mund të përfitojnë nga kjo. Nëse dëshirojmë, këtë lloj relacioni mund t'a quajmë "shkencë."

Shkenca gjithashtu mund të përshkruhet si të kuptuarit e asaj se çfarë na tregojnë gjërat dhe ngjarjet, se çfarë ligjesh hyjnore zbulohen për ne, dhe të përpjekjeve për të kuptuar qëllimin e Krijuesit. Të krijuar për të sunduar krijimin, ne kemi nevojë për të vëzhguar dhe lexuar, për të bërë dallimin dhe për të mësuar më tej në lidhje me botën që na rrethon, kështu që ne të mund të gjejmë mënyrën më të mirë për të ushtruar ndikimin dhe kontrollin tonë. Kur të arrijmë në këtë nivel, me dekret të Krijuesit të Lartësuar, çdo gjë do të shfaqet për ne dhe ne do t'i paraqitemi Allahut.

Nuk ka asnjë arsye për t'u frikësuar prej shkencës. Rreziku nuk vjen nga shkenca dhe ajo do të jetë bashkëudhëtare në themelimin e botës së re. Rreziku vjen nga injoranca dhe shkencëtarë të papërgjegjshëm dhe nga të tjerë që e shfrytëzojnë atë për interesat e tyre egoiste.

Nëse shkenca e vërtetë e orienton inteligjencën njerëzore në drejtim të amshimit, pa pritur ndonjë përfitim material, ndërmerr një studim të palodhshëm dhe të detajuar të ekzistencës për të zbuluar të vërtetën absolute, dhe ndjek metodat e nevojshme për të arritur këtë qëllim, çfarë mund të themi tjetër për shkencën moderne përveçse fjalë të mira? Ajo në këtë mënyrë do të mund të përmbushë plotësisht pritshmëritë tona. Edhe pse zakonisht paraqiten si konflikte midis Krishtërimit dhe shkencës, konfliktet gjatë periudhës së Rilindjes ishin kryesisht në mes të shkencëtarëve (jo shkencës në vetvete) dhe Kishës. Koperniku, Galileu, dhe Bacon nuk ishin antifetarë; në fakt, mund të themi se angazhimi i tyre fetar i çoi ata drejt të vërtetës shkencore.

Përpara Krishtërimit ishte Islami, mendimi i tij fetar që buron nga përjetësia, si dhe dashuria e zelli që burojnë prej tij, i shoqëruar nga ndjenjat e thjeshtësisë dhe përulësisë përpara Krijuesit të Përjetshëm, të Plotfuqishmit dhe Pronarit të kozmosit, që i mundësoi botës myslimane të përjetonte pesë shekujt madhështorë të shkencës, deri në përfundim të shekullit të dymbëdhjetë. Koncepti i tij themelor rreth shkencës si bazë e Revelacionit Hyjnor, u përfaqësua pothuajse krejtësisht nga figura të shquara, të cilat të mbrujtura me përjetësi, e studiuan pa pushim ekzistencën, për të arritur përjetësinë. Përpjekjet e tyre në drejtim të Revelacionit Hyjnor bënë që të përhapej një dritë, e cila ngjalli një koncept të ri të shkencës tek shpirtrat njerëzore.

Nëse qytetërimi islam nuk do të ishte dëmtuar aq keqaz nga mongolët e tmerrshëm (1216-58) dhe nga pushtime të panumërta kryqtarësh (1097-1270), bota e sotme me siguri do të ishte mjaft e ndryshme nga kjo që është. Në qoftë se koncepti islam i shkencës ashtu siç u miratua dhe u përcoll nga bashkësia, si pjesë e Mesazhit Hyjnor dhe i ndjekur me rigorozitet si një akt adhurimi, do të kishte vazhduar të lulëzonte, bota jonë do të ishte më shumë e arsimuar, jeta e saj intelektuale shumë më e pasur, teknologjia e saj më e shëndetshme, dhe shkenca e saj më premtuese. E gjithë shkenca islame e mbështetur dhe e bazuar tek përjetësia, ishte në

të mirë të njerëzimit, duke na ndihmuar të aspirojmë për botën tjetër dhe për t'i trajtuar gjërat me përgjegjësi, për hir dhe kënaqësi të Allahut të Plotfuqishëm.

Vetëm dashuria për të vërtetën, e përkufizuar si qasëse ndaj ekzistencës jo për përfitim material ose përfitime të kësaj bote, por për ta vëzhguar dhe njohur atë siç ajo është realisht, i jep drejtimin e duhur studimeve shkencore. Ata që janë të mbushur me një dashuri të tillë, do t'ja arrijnë qëllimit të tyre, ndërsa ata të cilët nuk e zotërojnë një dashuri të tillë, të cilët udhëhiqen nga pasionet e kësaj bote, aspiratat materiale, paragjykimet dhe fanatizmi ideologjik, ose do të dështojnë, ose do ta kthejnë shkencën në një armë vdekjeprurëse për ta përdorur kundër asaj që është e mirë për njerëzimin.

Intelektualët, institucionet arsimore, dhe masmedia duhet të përpiqen për ta çliruar shkencën moderne nga atmosfera e tanishme vdekjeprurëse e materializmit dhe fanatizmit ideologjik. Për t'i përcjellë shkencëtarët drejt vlerave njerëzore, mendjet e tyre duhet të çlirohen nga supersticioni dhe fanatizmi ideologjik dhe shpirtrat e tyre të pastrohen nga dëshira për avantazhe dhe përfitime të kësaj bote. Kjo do t'u mundësojë atyre që të sigurojnë lirinë e vërtetë e mendimit dhe të angazhohen në shkencën e dobishme. Betejat e gjata shekullore të tyre kundër klerit dhe koncepteve të shtrembëra, të formuara në emër të fesë, dhe denoncimi i tyre i mëvonshëm ndaj njerëzve fetarë si të prapambetur, mendjengushtë, dhe fanatikë, duhet të shërbejë si një paralajmërim ndaj shkencëtarëve që të mos bien përsëri në të njëjtën grackë.

Despotizmi intelektual dhe shkencor lindin nga prirja drejt interesit dhe pushtetit personal, ose drejt ideologjisë dhe fanatizmit të një grupimi të caktuar. Grupime të tilla mund të gjenden si në mesin e shkencëtarëve, poende të klerikëve. Despotizmi është despotizëm, qoftë kur lind nga mendjengushtësia fetare e koncepteve të prishura dhe të shtrembëruara, si dhe dominimi klerikal, qoftë nga homologët e tyre në fushën e shkencës. Islami vazhdimisht i bën thirrje njerëzimit për të studiuar natyrën (ekspozitën e ve-

prave hyjnore), për të reflektuar mbi krijimin dhe atë çfarë është krijuar, dhe ta trajtojë atë me përgjegjësi, në mënyrë që njerëzimi të përfitojë.

Kur studiohet pa paragjykime dhe pa keqdashje, Kurani tregon se ai promovon dashurinë për shkencën dhe humanizmin, drejtësinë dhe rregullin. Kurani është plot me ajete që kërkojnë nga ne të studiojmë natyrën. Ai gjithashtu na nxit që të reflektojmë mbi krijimin dhe krijesat, për t'iu qasur atij me përgjegjësi, dhe për ta përdorur në të mirën e përgjithshme. Sipas Islamit, e tërë çështja e kërkimit të diturisë qëndron në zbulimin e kuptimit të ekzistencës, në mënyrë që ne të mund të arrijmë tek Krijuesi dhe nga kjo të përfitojë njerëzimi dhe të gjitha krijesat. Dhe pastaj, ne jemi këtu për të ndërthurur me atë dituri, besimin, dashurinë dhe altruizmin. Njerëzimi ka qenë dëshmitar i një jete të tillë ideale në praktikë: jetën shembullore të Profetit Muhamed dhe sjelljen e shumë prej përfaqësuesve të kësaj fryme, e cila i përsosi mendimet dhe veprat e tyre.

Pra, çfarë ka për të pasur frikë nga shkenca? Aktet e planifikuara në bazë të diturisë, sjellin ndonjëherë rezultate të këqija, por sigurisht injoranca dhe çorganizimi, sjellin gjithmonë rezultate të këqija. Në vend që të kundërshtojmë produktet e shkencës dhe teknologjisë, ne duhet t'i përdorim ato për t'i sjellë lumturinë njerëzimit. Këtu qëndron thelbi i problemit tonë më të madh, sepse ne nuk mund të marrim masa kundër Epokës së Hapësirës ose fshijmë nga faqja e dheut dijet që kanë të bëjnë me mënyrën e krijimit të bombës atomike apo asaj me hidrogjen.

Edhe pse shkenca mund të jetë një armë vdekjeprurëse në duart e një pakice të papërgjegjshme, ne nuk duhet të hezitojmë ta pranojmë si shkencën ashtu edhe produktet e saj dhe pastaj t'i përdorim ato për të krijuar një civilizim në të cilin ne të mund të sigurojmë lumturinë tonë në këtë botë dhe në tjetrën. Është e kotë të mallkojmë makinat dhe fabrikat, për shkak se makinat do të vazhdojnë të ekzistojnë dhe fabrikat do të vazhdojnë të funksionojnë. Shkenca dhe prodhimet e saj do të fillojnë të na japin

përfitime, vetëm kur njerëzit e së vërtetës dhe të besimit të fillojë të drejtojë punët tona.

Ne nuk kemi pësuar ndonjëherë dëme nga armët që ndodhen në duart e ëngjëjve. Të gjitha vuajtjet tona të deritanishme, kanë ardhur për shkak të atyre që besojnë ende se përdorimi i forcës është drejtësi. Kjo situatë do të vazhdojë të jetë e tillë derisa ne të ndërtojmë një botë të bazuar mbi thmelet e fesë dhe shkencës.

Dy fusha të ndryshme për shkencën dhe fenë?

Krishtërimi nuk është zhvilluar si një fe gjithëpërfshirëse që përmbledh të gjitha fushat e jetës, por si një bashkësi vlerash shpirtërore dhe morale me një ndikim të drejtpërdrejtë mbi aspektet e jetës së kësaj bote. Kjo ka pasur pasoja të rënda për historinë e mëvonshme perëndimore. Për shembull, Krishterimi e ka dënuar luftën, por refuzoi ta njihte realitetin e saj në historinë njerëzore, ndaj këtë arsye nuk ka parashikuar rregulla të qëndrimit ndaj saj. Meqenëse asnjëherë nuk i është dhënë fund ndonjë lufte nga një qëndrim i tillë, mungesa e fesë në hartimin e rregullave të luftës, ka rezultuar në një shkallë të madhe brutaliteti dhe në masakra të pamëshirshme nga kombe të ndryshme perëndimore në të gjithë pjesën tjetër të botës.

Në mënyrë të ngjashme, Krishtërimi e dënon botën dhe natyrën si një vel, i cili e ndan njerëzimin nga Perëndia, një këndvështrim që ka inkurajuar shkencën moderne ta konsiderojë autoritetin fetar si të parëndësishëm. Gjithashtu, dualizmi aparent që ndan këtë botë dhe ahiretin, fenë dhe shkencën, metafiziken dhe fiziken, ka udhëhequr idetë e filozofëve dhe mendimtarëve perëndimorë, të cilët u përpoqën për të gjetur një hapësirë pranë shkencës për fenë, me qëllim për t'i dhënë kuptim fushave të ndryshme të fesë dhe shkencës, arsyes dhe shpalljes, kësaj bote dhe Ahiretit.

Dualizmi kartezian

Dekarti[20] është personi më i lidhur me këtë dualizëm perëndimor, për shkak se idetë e tij kanë kontribuar në ndarjen pothuajse të plotë të aktiviteteve intelektuale dhe shkencore nga feja, dhe në shekujt e mëvonshëm, të Iluminizmit, pikëpamjeve mekanikiste të jetës, pozitivizmit dhe materializmit. Kartezianizmi siguroi një strehë për ata që e ndanin kërkimin e tyre për fenë në jetën e tyre të përditshme nga kërkimin e tyre për shkencën. Ai gjithashtu i dha shkas rritjes edhe më tepër të keqkuptimeve rreth marrëdhënieve mes fesë, jetës dhe shkencës. Këta intelektualë apo filozofë, të cilët nuk dëshironin të braktisnin fenë ose arsyetimin shkencor, u mbështetën tek dualizmi kartezian për të justifikuar pozicionin e tyre.

Kjo mënyrë e mbrojtjes së fesë kundër materializmit shkencor mbizotëron ende në gjirin e disa intelektualëve myslimanë. Sipas tyre, ekziston një botë e Cilësisë e ndarë plotësisht nga një botë e Sasisë. Shkenca ka autoritet në botën e Sasisë dhe përdor matjen, vëzhgimin dhe eksperimentin. Por në botën e cilësisë, meqë nuk kryhen matje, feja ka të drejtën e fjalës. Prandaj, të qenët fetar nuk mund të bjerë në kundërshtim me të qenët shkencor, sepse feja dhe shkenca nuk paskan të bëjnë fare me njëra-tjetrën.

Edhe pse ka për qëllim mbrojtjen e fesë kundër shkencës, dualizmi kartezian e konsideron shkencën superiore ndaj fesë. Duke e kufizuar fenë në një grumbull bestytnish të ndjekura verbërisht, ai i jep asaj në një rol dytësor në mendim dhe në jetën praktike. Këto bestytni nuk mund t'i nënshtrohen hulumtimit, verifikimit, dhe arsyetimit, dhe kështu janë praktikisht të parëndësishme për botën dhe jetën tokësore. Ky qëndrim e paraqet fenë vetëm si një çështje të besimit apo mosbesimit, gjë që është krejtësisht e pasaktë, dhe "dëshmon" se ka pak dallim ndërmjet pranimit të një feje "të vërtetë" dhe besimit në çdo fe tjetër apo edhe në mitet dhe bestytnitë. Një dualizëm i tillë, qëndron prapa tendencave moderne që e konsiderojnë fenë, qoftë atë të shpallur nga Zoti, qoftë edhe atë të shpikur nga njeriu, si një grup dogmash të papranueshme

për arsyen dhe të cilat do të eleminohen gradualisht nga shkenca dhe bota e përkapshme.

Por feja, e veçanërisht Islami, kërkon bindje racionale dhe shpirtërore, të bazuar tek të menduarit, arsyetimi, kërkimi, dhe verifikimi, në kundërshtim me besimin e verbër. Edhe pse është e mundur të hyhet në fe nëpërmjet portës së imitimit, kurrë nuk është e kështillueshme që të mjaftohemi dhe kënaqemi me një besim të bazuar në imitim. Ajetet kuranore në lidhje me çështjet ligjore nuk i kapërcejnë 300, ndërsa më shumë se 700 ajete i nxisim njerëzit për të studiuar fenomenet natyrore dhe për të menduar, arsyetuar, vëzhguar, nxjerrë mësime, pasqyruar, dhe verifikuar. Ajete të cilat përfundojnë me fraza si: *A nuk po arsyetoni? A nuk po mendoni? A nuk po reflektoni? A nuk po nxirrni mësime? Nxirrni mësime o njerëz me logjikë,* si dhe dënimi i Kuranit ndaj mosbesimtarëve si njerëz pa intelekt, e për rrjedhojë të paaftë për të menduar dhe reflektuar, pa sy për të parë dhe pa veshë për të dëgjuar, përbëjnë paralajmërime serioze ndaj atyre të cilët e shohin fenë si një besim i verbër dhe të cilët nuk janë në gjendje të dallojnë lidhjen esenciale dhe të pashkëputshme midis fesë dhe jetës, natyrës, arsyes dhe shkencës.

Shkenca moderne studion botën natyrore. Duke e kufizuar shkencën vetëm në fushën materiale dhe të dukshme të ekzistencës, dualizmi kartezian nuk lejon që ajo të pranojë mundësinë e sferave të tjera të ekzistencës dhe të fushave të tjera të studimit. Kjo mund të konsiderohet si një mënyrë për ta mbajtur kërkimin shkencor në sferat faktike dhe objektive. Megjithatë, ky qëndrim shpesh çon në pikëpamjen se të tilla studime jomateriale dhe përfundimet e tyre, janë joshkencore dhe prandaj lypset të besohen vetëm pas një site të imët hulumtimi apo verifikimi.

Modeli kartezian gjithashtu futet shumë edhe në agnosticizëm, duke mohuar ose të paktën duke mos pranuar dimensione më të thella dhe më të gjera të ekzistencës përtej botës materiale. Nëse shkenca moderne do të ishte vërtet objektive, ajo ose do të pranonte mundësinë e shumë të vërtetave dhe dimensioneve të tjera

përveç botës materiale, ekzistenca e të cilave nuk mund të zbulohet me metodat e saj të tanishme, ose do të duhej të ndryshonte taktikat dhe teknikat e saj dhe ta pajisë veten me metodat e nevojshme për t'i zbuluar ato dimensione. Shkenca kurrë nuk do ta kuptojë realitetin e plotë të ekzistencës, për aq kohë sa ajo të këmbëngulë fort në metodat empirike. Është për të ardhur keq për shkencën pse ajo e redukton njerëzimin dhe universin vetëm në ekzistencën e tyre fizike dhe përpiqet të shpjegojë të gjitha aktivitetet tona intelektuale dhe shpirtërore me terma fizikë.

Shkenca moderne e trajton natyrën si një bashkëveprim të strukturuar, por të paqëllimtë apo të paplanifikuar të objekteve materiale. Ky qëndrim nuk është shumë i ndryshëm nga dënimi që i pati bërë Krishtërimi natyrës, si një vello që ndante njerëzimin nga Perëndia. Islami, nga ana tjetër, i paraqet fenomenet natyrore, si ana tjetër e medaljes e fenomeneve të mbinatyrshme dhe ekzistencën e atyre realiteve, të cilat shkenca ose i refuzon, ose i konsideron si të pakuptueshme për metodikën shkencore, si provë të vërtetësisë apo realitetit fetar. Ajo bën thirrje njerëzve për t'i studiuar dhe për të reflektuar mbi to, e në këtë mënyrë, të mbledhin nektarin e besimit.

Islami e sheh natyrën si dimensionin në të cilin të gjithë emrat e mrekullueshëm të Allahut manifestohen në një bashkësi "nivelesh drite" me anë të të cilëve mund të arrihet tek Ai. Duke e pasur origjinën në cilësitë e Vullnetit dhe Fuqisë së Allahut, natyra përbën kundërpeshën e krijuar të Kuranit, i Cili rrjedh nga cilësia Hyjnore e të Folurit. Pra, natyra është një libër, njësoj Kurani, një qytet apo pallat, kuptimi i të cilit shpjegohet nga një pamflet i shenjtë, që është Kurani. Përveç kësaj, ky pamflet i shenjtë, i tregon njerëzimit si të banojë në të duke nxjerrë përfitim nga natyra.

Njerëzimi është homologu i tretë i këtyre dy librave, i cili është e pajisur me vetëdije dhe vullnet. Kjo është arsyeja përse shkencëtarë të tillë myslimanë si Ibn Sina (Avicena), Zahraviu, Ibrahim Hakkë, Nasir al-Din al-Tusi, dhe Ak Shemsed'din, praktikonin sufizmin dhe ishin të mirëpërgatitur në shkencat fetare.

Natyra shfaq Unicitetin Hyjnor

Natyra, e cila është rezultati i manifestimit të emrave të mrekullueshëm hyjnorë dhe një përmbledhje pasqyrash ku reflektohen emrat dhe cilësitë hyjnore, përmban një lloj shenjtërie. Në fakt, rregulli dhe qëndrueshmëria e saj, janë dy prova domethënëse të Unicitetit Hyjnor, sikurse edhe rrënjët e çdo shkence. Rregullsia e përsosur e universit, vjen falë të qenit të tij një vepër e një Krijuesi të Vetëm, sepse vetëm nëpërmjet këtij fakti, mund t'i jepet shpjegim ndërveprimit, bashkëpunimit dhe solidaritetit ndërmjet të gjitha pjesëve dhe krijesave të tij. Për shembull, një mollë mund të vijë në ekzistencë vetëm nëse dheu, ajri, uji dhe dielli, ashtu si dhe vetitë e farës dhe pemës së mollës (p.sh., mbirja, rritja, fotosinteza dhe lulëzimi), përmbushin detyrat e tyre specifike. Kjo do të thotë se një mollë mund të ekzistojë vetëm nëse bashkëvepron i gjithë universi.

Shkencëtarët e klasifikojnë rregullin dhe qëndrueshmërinë e cilitdo element që zë një pjesë në univers, si ligje të natyrës, megjithëse elementet dhe karakteristikat e kësaj rregullsie dhe qëndrueshmërie mbi të cilat është bazuar shkenca, kanë vetëm ekzistencë nominale. Ato të cilat shkencëtarët i quajnë ligje, mund të jenë mjaft mirë punët apo aktivitetet e Allahut të kryera nëpërmjet veprimtarisë së ëngjëjve. [21]

Për shkak të refuzimit për ta përfshirë fenë në veprimtarinë e saj, shkenca ia atribuon dy faktorëve krijimin dhe ekzistencën e mrekullueshme dhe të qëllimshme, e po kështu edhe rregullin, harmoninë dhe qëndrueshmërinë e universit: ligjeve të verbra, të pandërgjegjshme, injorante dhe jo të gjalla, që ekzistojnë vetëm në trajtë nominale, apo natyrës, e cila është një marrëse pasive dhe jo një agjent aktiv, një objekt dhe jo një subjekt, dhe pa ndjenjën e vetëdijes, diturisë, dhe vullnetit. Por një rregullsi, harmoni dhe qëndrueshmëri e tillë, padyshim kërkon ekzistencën e një dijeje, fuqie, vullneti të përjetshëm dhe absolut.

Përveç kësaj, shkenca përpiqet të shpjegojë ekzistencën dhe

jetën përmes rastësisë dhe domosdoshmërisë. Arsyeja për një injorancë të tillë është se shkenca e konsideron fenë si një grup dogmash që kërkojnë besimin e verbër dhe për këtë arsye, feja është antishkencore apo e papajtueshme me të. Ky qëndrim i pafalshëm dhe mohimi i dimensionit të mbinatyrshëm të krijimit apo agnosticizmi i saj, janë rezultat i ndarjes mes shkencës dhe fesë.

Kur ndahet nga feja, shkenca e humbet identitetin dhe qëllimin e saj të vërtetë. Sipas Kuranit, këto shërbejnë për të studiuar ekzistencën nën dritën e udhëzimit hyjnor, në mënyrë që ta kuptojmë atë, për ta përdorur universin si një koleksion nivelesh për të arritur në "qiellin" e besimit, dhe për të përmirësuar botën, dhe në këtë mënyrë, për të ndihmuar çdo person të përmbushë funksionin e tij ose të saj të mëkëmbësisë hyjnore në Tokë, duke jetuar në përputhje me atë besim.

Siç lexojmë në ajetet 30-31 të sures Bakara, kur Allahu u tha engjëjve se Ai do të caktonte një mëkëmbës në Tokë, ata u përgjigjën, se atëherë atje do të mbizotëronin korrupsioni, trazirat dhe gjakderdhjet. Pse? Sepse mëkëmbësia kërkon njohuri, vullnet dhe fuqi. Pastaj ata u përgjigjën: *"Ne të adhurojmë Ty me lavdërimin Tënd dhe të adhurojmë plotësisht." Ai tha: Unë di atë që ju nuk e dini!"* Ai ia mësoi Ademit" emrat " - emrat dhe realitetin e gjërave, e në këtë mënyrë i dha çelësat e dijes dhe aftësinë për t'i zotëruar gjërat.

Meqë Ai na bëri superior ndaj engjëjve me anë të kësaj diturie, Ai i konsideron kërkimet "shkencore" si mjet për të kuptuar krijimin dhe për të përmbushur rolin tonë si mëkëmbës, si të barabartë së bashku me glorifikimin dhe lavdërimin e engjëjve. Kjo do të thotë se studimet shkencore të ndërmarra me objektivin për të kuptuar krijimin, e në këtë mënyrë për të njohur Krijuesin dhe për të përmirësuar botën përmes vendosjes së paqes dhe drejtësisë, përbëjnë akte të adhurimit. Nisur nga kjo, Islami qartazi i jep një kuptim të shenjtë dhe dimension fetar shkencës dhe studimeve shkencore.

Meqenëse ajeti i parë kuranor i shpallur fillon me urdhrin "Lexo!" në një kohë kur literatura e shkruar, si dhe shkrim e këndimi në atë zonë ishin të rralla, kjo komandë fiton një domethënie të rëndësishme. Ky urdhër vijon me fjalët "*Në emër të Zotit, i cili krijoi gjithçka*" (96:1), që do të thotë se ne duhet të studiojmë krijimin dhe krijesat në emër të Zotit. Fjala që përdoret për të përmendur Zotin këtu është fjala "Rabb," që ka kuptimin Ai i Cili na sjell në jetë, na edukon, përgatit, mbështet dhe rrit. Kjo nënkupton se krijimi është nën sundimin e Zotit dhe se ne duhet ta studiojmë atë tërësisht për sa i takon ardhjes në ekzistencë, rritjes dhe funksionimit. Kjo është pikërisht ajo çfarë bën shkenca.

Domethënia e dytë e rëndësishme është se ne duhet ta studiojmë krijimin në emër të Zotit për kënaqësinë e Tij dhe në përputhje me rregullat e përcaktuara nga Ai. Kështu, studimi shkencor nuk duhet të kundërshtojë urdhrat fetarë dhe moralë, as të dëmtojë njerëzit, ose të ndryshojë rregullat e paracaktuara në krijim dhe në univers. Kur shkenca të përdoret për të zbuluar ligjet hyjnore në natyrë dhe kur të zhvillohet brenda kufijve të lejes Hyjnore, ajo nuk do të shkaktojnë ndotje mjedisore, vdekje masive dhe shkatërrim, pra me një fjalë, dëme në Tokë. Islami nuk i ndalon studimet shkencore, përkundrazi, ai përcakton qëllimet morale të shkencës dhe vendos kufizime morale mbi të. Ai i nxit shkencëtarët të punojnë në dobi të njerëzimit si dhe krijesave të tjera, dhe duke i urdhëruar ata që të punojnë në emër të Zotit, lartëson dhe lavdëron gjithçka që ata bëjnë duke i konsideruar si akte adhurimi.

Ndarja e shkencës nga feja ka sjellë pasurim dhe mirëqenie materiale vetëm për një pakicë shumë të vogël. Por siç kanë treguar dy shekujt e fundit, një gjë e tillë, ka rezultuar në disa pasoja të tilla si pasiguria globale, hidhërimi dhe shqetësimi për shkak të materializmit shkencor, shtypja brutale dhe kolonializmi, hendeku i madh midis njerëzve të pasur dhe të varfër, luftërat e panumërta globale apo rajonale gjatë të cilave miliona njerëz vdesin ose mbeten të pastrehë, jetimë apo gra të veja, rivaliteti i pamëshirshëm klasor dhe nivelet e rrezikshme të ndotjes mjedisore. Ndarja mes fesë

dhe shkencës ka rezultuar në fatkeqësi të shumta.

Një tjetër dëshmi e pandashmërisë mes shkencës dhe fesë, edhe pse kjo mohohet nga shkenca laike, është fakti se profetët qenë pararendësit e zbulimeve shkencore dhe progresit material. Për shembull, disa interpretues të Kuranit, nga ajeti: *E kur erdhi urdhëri ynë (i caktuar për ndëshkim) dhe gufoi (uji) prej furrës* ... (11: 40), arrijnë në përfundimin, se Arka e Noes, e ndërtuar përmes udhëzimit të Zotit, ishte një vapor. Detarët e konsiderojnë Nuhun (Noen) si mësuesin apo padronin e tyre të parë. Në mënyrë të ngjashme, Jozefi ishte personi i parë që pati ndërtuar një sahat dhe kështu është konsideruar si mësuesi i parë i orëndreqësve, dhe Enokut i është dhënë e njëjta konsideratë nga rrobaqepësit.

Megjithatë, shkenca materialiste laike, ose nuk e konsideron Shpalljen Hyjnore si një burim i dijes, ose nuk e konsideron atë si njohuri shkencore. Për shembull, ajo e konsideron *Përmbytjen* e përmendur në të gjitha shkrimet e shenjta dhe gojëdhënat (e pashkruara) historike të të gjithë popujve, si një mit. Nëse kjo (apo ndonjë ngjarje tjetër) nuk mund të përcaktohet nëse ka ndodhur vërtet përmes metodave shkencore, ajo nuk duhet të konsiderohet shkencore, dhe ata që thonë se vetëm me metoda shkencore mund të arrijmë të vërtetën, do të vazhdojnë të dyshojnë në Shkrimet e Shenjta. Kjo shpie në drejtim të mohimit të shpalljes hyjnore dhe të të gjitha feve të shpallura nga Zoti.

Gjithashtu, kjo do të bënte që shumë fakte dhe ngjarje historike të mbeten të fshehura, dhe historia e Lindjes së Mesme të mësohet në mënyrë të pasaktë, sepse për cilëndo histori të saktë të popujve të asaj zone, duhet të merren në konsideratë edhe historitë jetësore të profetëve të përmendur në Kuran. Pavarësisht nga kjo, shkenca materialiste apo laike, bën që shumë të vërteta të mësohen si gënjeshtra dhe të pavërtetat e shumta të paraqiten si të vërteta, duke mos pranuar se Zbulesa Hyjnore posedon besueshmëri shkencore. Për shembull, asirianët e Irakut, paraqiten si paganë. Përsëri lexojmë në 37/147: *Dhe Ne e dërguam atë edhe njëherë tek (njerëzit e tij, që numëronin) 100.000 apo më shumë,*

sepse më shumë se 100.000 njerëz besonin tek Jonas, i cili, sipas Biblës, jetonte në Nineveh, kryeqendra e Asirias.

Ndarja mes shkencës dhe fesë, dhe përcaktimi për secilën nga një fushë e ndryshme e kompetencës ose rëndësisë, ka sjellë për pasojë që feja të shihet si një sërë mitesh dhe dogmash të besuara verbërisht, ndërsa shkenca të mbetet në errësirën e materializmit. Ashtu siç është absolutisht e nevojshme që mendja dhe zemra të ndërthuren dhe harmonizohen, apo intelekti dhe shpirti, është gjithashtu e një rëndësi ejetike që të harmonizojmë edhe shkencën me fenë.

Çfarë domethënieje ka urdhri "Lexo?"

Pjesa e parë e shpalljes kuranore qe:

> Lexo, me emrin e Zotit tënd; i Cili krijoi, krijoi njeriun prej një droçke gjaku të ngjizur; Lexo! Se Zoti yt është më Bujari!; Ai që e mësoi të shkruajë me pendë; i mësoi njeriut atë që ai nuk e dinte. (96/1-3)

Është diçka tejet domethënës fakti që Profetit arab iu urdhërua për të lexuar në një kohë kur libri nuk ekzistonte ende. Kjo do të thotë se ekziston një libër tjetër, ose më saktë, dy libra, të cilët janë homologët e Librit që do të shpallej: gjithësia dhe njerëzimi. Besimtarët duhet të studiojnë gjithësinë dhe njerëzimin pa paragjykime. Përveç kësaj, fenomenet materiale dhe psikologjike të gjetura në univers dhe në gjirin e njerëzimit, quhen gjithashtu shenja. Imperativi **Lexo!** është pasuar nga **me** dhe pastaj me **emrin e Zotit tënd**, **i Cili krijoi**. Kjo nënkupton tri gjëra:

- Leximi (studimi) i universit përmban parimet e veta, të tilla si vëzhgimi dhe eksperimenti.
- *Rabb*, e përkthyer si "Zoti", ka shumë kuptime të tjera, mes të cilëve mësues, ngritës, mbajtës, dhënës i një forme të caktuar, dhe dhënës i një natyre të veçantë për çdo subjekt. Natyra jonë përfshin vullnetin e lirë, ndërsa çdo subjekt tjetër i caktuar, vepron sipas natyrës së tij

primitive, të cilën shkenca e quan "natyrë" dhe "ligjet e natyrës". Neve na është kërkuar që t'i zbulojmë këto ligje.

- Çdo veprim njerëzor, duke përfshirë edhe studimet shkencore, duhet të kryhet në emër të Zotit dhe të jetë kështu një akt adhurimi. Ky është kufiri i vetëm që vendos Kurani dhe Islami mbi shkencën. Çdo veprim i kryer sipas këti parimi, nuk mund të jetë kundër urdhëresave të Allahut. Për shembull, në qoftë se dija shkencore përftohet si adhurim, askush nuk mund ta dëmtojë njerëzimin apo të lejojë një pakicë të papërgjegjshme që ta përdorë atë si një armë vdekjeprurëse. Nëse zhvillohet vetëm në emër të Tij dhe nga njerëz të vetëdijshëm për mbikqyrjen e Tij të vazhdueshme, duke e ditur se ata do të thirren për të dhënë llogari përpara një Gjykate Supreme, shkenca do ta shndërronte këtë botë në Kopsht të Edenit.

Kështu, siç thekson Nasr:

> ... Shpallja për njeriun është e pandashme nga shpallja kozmike, e cila është edhe ajo një libër i Allahut. Islami, duke refuzuar që ta ndajë njeriun nga natyra dhe studimin e natyrës nga gnostika apo dimensioni metafizik i saj, ka ruajtur nje pamje integrale të universit dhe vëren në arteriet e rregullsisë kozmike dhe natyrore, rrjedhën e Hijeshisë Hyjnore.[22]

Që nga gjiri i natyrës, njerëzimi kërkon ta kapërcejë atë. Nëse njerëzit mësojnë se si ta mendojnë natyrën si një pasqyrë që reflekton një realitet më të epërm, natyra në vetvete mund të jetë një ndihmë në këtë proces. Kjo është arsyeja përse dijetarët islamë dhe evlijatë myslimanë, kanë zhvilluar një hierarki të përpunuar të dijes (p.sh., fizike, juridike, sociale, teologjike, shpirtërore dhe metafizike), të integruar sipas parimit të Unicitetit Hyjnor, dhe pse kaq shumë shkencëtarë myslimanë, në mesin e të cilëve Ibn Sina (Avicena), Nasir al-Tusi, Ak Shemsed'din, dhe Ibrahim Hakkë i Erzurumit, ishin të mirëpërgatitur në shkencat fetare dhe ose praktikonin sufizmin, ose ishin të lidhur intelektualisht me shkollat sufiste të Islamit.

Ibn Sina ishte një mjek dhe filozof peripatik, i cili shpjegoi duke u mbështetur mbi filozofinë e tij orientale, se dituria mund të kërkohet nëpërmjet iluminizmit. Nasir al-Din al-Tusi, matematikan dhe astronom i shquar i kohës së tij, shkroi një traktat të famshëm në lidhje me dimensionin metafizik të Islamit. Njëmbëdhjetë shekuj më parë, Ibn Xherir el-Tabari, një nga figurat më të shquara të jurisprudencës islame, historisë dhe interpretimit kuranor, shkroi se si erërat fekondojnë retë në mënyrë që të bjerë shiu.

Shembuj të tillë mund të jepen me qindra, por këto mjaftojnë për të treguar se respekti për natyrën dhe mendjen njerëzore ka qenë gjithmonë një nga aspektet kryesore të udhëtimit shpirtëror të një myslimani, dhe se shkenca apo të tjera fusha të studimeve islame, kanë qenë gjithmonë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën. Një lidhje e tillë e ka bazën në Kuran, i Cili si Libri Hyjnor i Islamit, korrespondon me shpalljen makrokozmike - universin.

A aludon Kurani në lidhje me zhvillimet shkencore?

Përpara se t'i japim përgjigje kësaj pyetjeje, duhet të theksojmë një fakt mjaft të rëndësishëm: të konsideruarit e shkencës si antagoniste me fenë dhe studimet shkencore si të ndara e të pavarura nga Kurani, është po aq gabuar sa të përpiqesh ta reduktosh Kuranin thjesht në një libër shkencor, duke u përpjekur për të treguar se çdo teori apo fakt i ri shkencor, mund të gjendet në të.

Për shembull, disa persona, sidomos në Turqi, kanë pretenduar se *dabbat-al-ard* (krijesë e vogël që lëviz), e përmendur në Kuran në 27/82, nuk është asgjë tjetër veçse virusi që shkakton SIDA-n. Megjithatë, ky është një konkluzion i nxituar për disa arsye: Kurani hesht në lidhje me natyrën e kësaj forme jete; nëse ne pranojmë këtë version, na duhet të pranojmë edhe sëmundje të tjera seksualisht të transmetueshme të shkaktuara nga bakteret apo viruset dhe nuk mund të jemi aq të sigurtë se në të ardhmen nuk do të shfaqen sëmundje të tjera virale më të rrezikshme dhe më vdekjeprurëse se SIDA.

Konteksti në të cilin paraqitet termi *dabbat-al-ard,* sugjeron se ai do të shfaqet diku afër fundit të botës, kur askush të mos besojë më në Zot. Kështu, ne nuk duhet të nxitohemi në përpjekjet tona për të gjetur një lloj korrespondence ndërmjet një ajeti kuranor dhe çfarëdolloj zhvillimi të ri shkencor apo teknologjik.

Teoritë shkencore, zakonisht janë si rrobat; të dyja flaken tutje pasi përdoren për ca kohë. Përpjekjet për të treguar se çdo fakt i ri shkencor apo teori, mund të gjendet në Kuran, tregon kompleksin e inferioritetit të botës myslimane dhe e shndërron shkencën në më të rëndësishme se Kurani. Secili prej ajeteve apo shprehjeve kuranore ka një kontekst universal. Prandaj çdo intrpretim i bërë në kontekstin specifik të një epoke të caktuar, mund t'i adresohet vetëm një aspekti të kontekstit universal.

Secili interpretues, shkencëtar apo njeri i lartësuar, preferon një aspekt të veçantë që vjen si rezultat i zbulimit apo intuitës së tij shpirtërore, evidencës personale apo predispozitës natyrale. Veç kësaj, ne e konsiderojmë si fizikën e Njutonit, e po ashtu edhe atë të Ajnshtajnit si shkencë, e për rrjedhojë si të vërtetë. Megjithëse në terma absolutë të dyja mund të jenë jo të sakta, sigurisht që mund të gjendet një shkallë e caktuar vërtetësie tek të dyja teoritë e sipërpërmendura.

Rastësia është një vello e përhapur nga Zoti i Plotfuqishëm mbi fluksin e shpejtë të ekzistencës, në mënyrë që ne të mund ta planifikojmë jetën tonë deri në njëfarë mase. Kjo do të thotë se fizika e Njutonit dhe fizika e Ajnshtajnit janë vetëm relativisht të vërteta. Me pak fjalë, ndërsa meditojmë për vargjet kuranore, ne duhet të marrim në konsideratë të vërtetat relative që gjenden në ekzistencën dhe jetën tonë, të cilat janë shumë më të mëdha në numër sesa të vërtetat absolute të pandryshueshme.

Ajetet kuranore kanë kuptime të shumëfishta. Për shembull, kini parasysh ajetet: *Ai i lejoi dy detet të puqen ndërmjet tyre; Ndërmjet atyre të dyve është një pengesë të cilën ata të dy nuk e kapërcejnë.* (55/19-20). Këto vargje paraqesin të gjitha palët e "deteve" apo

hapësirave shpirtërore dhe materiale, figurative dhe aktuale, dimensionet e të Plotfuqishmit dhe shërbëtorët e sferave nevojtare dhe të varura, nga kjo botë në Ahiret (duke përfshirë këtë botë, të dukshme trupore dhe të gjitha botët e së fshehtës), oqeani Paqësor dhe Atlantik, deti i Mesdheut dhe deti i Kuq, ujërat e kripur dhe ujërat e ëmbla, detare dhe nëntokësore, dhe lumenj të tillë të mëdhenj si Tigri dhe Eufrati, që bartin ujë të ëmbël, si dhe detet e kripura, nëpër të cilët ata rrjedhin. Të gjitha këto, së bashku me shumë të tjera, janë të përfshira në këto vargje, qoftë shprehimisht, qoftë në mënyrë figurative.

Pra, edhe në qoftë se një ajet apo shprehje kuranore duket se i referohet saktësisht një fakti të caktuar shkencor, ne nuk duhet ta kufizojmë kuptimin e tij vetëm për këtë fakt. Përkundrazi, ne duhet të marrim në konsideratë të gjitha kuptimet dhe interpretimet e tjera të mundshme.

Nga ana tjetër, nganjëherë Kurani e vë theksin apo aludon në zhvillime dhe fakte specifike shkencore. Duke qenë Shpallja Hyjnore që përfshin çdo gjë të gjelbër apo të thatë (6:59), ajo nuk mund t'i përjashtojë ato. Në të vërtetë, ajo u referohet atyre drejtpërdrejt ose tërthorazi, por jo sipas mënyrës së shkencës dhe filozofisë materialiste apo natyraliste.

Kurani nuk është një libër shkence, të cilit i duhet të japë shpjegim mbi çështjet kozmologjike ose shkencore; përkundrazi, ai është një interpretim i përjetshëm i librit të gjithësisë dhe interpretues i shkencave natyrore dhe i të gjitha të tjerave. Ai bën komente mbi botën e dukshme dhe të padukshme, dhe zbulon thesaret shpirtërore të emrave të bukur hyjnorë, në qiej dhe tokë. Kurani është një udhërrëfyes madhor në të kuptuarin e realiteteve të fshehta, të cilat qëndrojnë pas ngjarjeve të dukshme që ndodhin në natyrë dhe në jetën e njeriut, dhe gjithashtu është gjuha e botëve të fshehta në botën e dukshme.

Kurani është si dielli që ndriçon në qiellin shpirtëror dhe intelektual të Islamit. Ai është harta e shenjtë e botës tjetër; shpjeg-

uesi i atributeve, emrave dhe akteve hyjnore, si dhe edukatori i njerëzimit, i cili na udhëzon për të vërtetën dhe virtytin. Ai është një libër i ligjit dhe urtësisë, adhurimit dhe lutjes, urdhëresave dhe ndalesave hyjnore. Duke i kënaqur plotësisht nevojat tona shpirtërore dhe intelektuale, ai nuk lë asnjë çështje teologjike, sociale, ekonomike, politike, apo edhe shkencore të patrajtuar, qoftë shkurtimisht, qoftë në detaje, drejtpërdrejt ose nëpërmjet aludimit apo simbolikave.

Kurani e konsideron Krijimin si një akt që ka për qëllim vetëm të njohë Krijuesin, ndërsa shkenca e konsideron krijimin vetëm për interes të saj. Kurani i drejtohet njerëzimit; shkenca u drejtohet vetëm atyre që merren me të. Meqë Kurani e përdor krijimin si dëshmi dhe provë për të na udhëzuar, gjuha e tij duhet të jenë lehtësisht e kuptueshme për të gjithë ne jospecialistët. Udhëzimi kërkon që gjërat, të cilat janë relativisht të parëndësishme, të ceken shkurtimisht, ndërsa pikat delikate duhet të diskutohen sa më gjerësisht që të jetë e mundur, me anë të shembëlltyrave dhe krahasimeve. Kështu që njerëzit të mos hutohen, udhëzimi nuk duhet ta ndryshojë atë që është e qartë. Në të kundërt, si mund të arrijmë të nxjerrin ndonjë përfitim nga kjo?

Ashtu si çdo gjë tjetër, edhe shkenca e ka burimin e saj në njërin prej emrave të bukur të Allahut të Plotfuqishëm. Emri Shërues shkëlqen në mjekësi; gjeometria dhe inxhinieria varen nga emrat i Drejti, Formësuesi, dhe Harmonizuesi dhe filozofia reflekton emrin i Urti. Siç vumë në dukje më sipër, Krijuesi i referohet në Kuran çdo gjëje që Ai na e ka lejuar ta mësojnë dhe ta përdorim për progresin tonë material dhe shpirtëror.

Qëllimet primare të Kuranit janë për të bërë të njohur Allahun e Plotfuqishëm, për të hapur rrugën drejt besimit dhe adhurimit, dhe për të organizuar jetën tonë individuale dhe shoqërore, në mënyrë që ne të mund të arrijmë lumturinë e përsosur, në të dyja botët. Për të arritur këtë qëllim, ai i referohet gjërave dhe ngjarjeve, si dhe fakteve shkencore, në përpjesëtim me rëndësinë e tyre. Kështu, Kurani jep shpjegime të hollësishme nga shtyllat e

besimit, bazat e fesë, themelet e jetës njerëzore, dhe bazat e adhurimit, por bën vetëm aludime në gjëra të tjera relativisht më pak të rëndësishme. Kuptimi i një ajeti mund të krahasohet me një gonxhe trëndafili: ajo është e fshehur nga shtresa të njëpasnjëshme të petaleve. Një kuptim i ri perceptohet sapo çdo petal shpaloset, ndaj njerëzit zbulojnë ndonjë prej atyre kuptimeve, sipas kapacitetit të tyre dhe janë të kënaqur me të.

Shembuj

Më poshtë paraqiten disa shembuj që ilustrojnë aluzionet e Kuranit rreth fakteve dhe zhvillimeve shkencore.

EPOKA E DIJES: Krijuesi, i Cili nuk është i varur nga koncepti njerëzor i kohës, na informon se në një kuptim të përgjithshëm, tymi do të jetë epoka e dijes dhe informacionit, si dhe një epokë e fesë dhe besimit:

Ne do t'u bëjmë atyre të mundur që të shohin argumentet Tona në horizonte dhe në veten e tyre derisa t'u bëhet e qartë se ai (Kur'ani) është i vërtetë. A nuk mjafton që Zoti yt është dëshmitar për çdo gjë? (41:53)

Qysh nga ditët e hershme të Islamit, sufitë e kanë interpretuar këtë ajet si një shenjë për sigurimin e diturisë shpirtërore për të cilën ata përpiqen. Por nëse vargu lexohet në kontekstin e progresit, përparimt dhe të avancimit të ndjeshëm shkencor të nismuar nga myslimanët, ekzistenca e këtij ajeti duhet parë si një mrekulli.

Çdo gjë brenda rrethit të të menduarit dhe të hulumtuarit të njeriut, pohon Unicitetin e Krijuesit, si natyra e vërtetë dhe ndërlidhjen e mikrokozmosit dhe makrokozmosit, të cilat sa vijnë e zbulohen dhe kuptohen më mirë. Kur ne studiojmë qindra libra në këtë pikë, e kuptojmë, se atë çështë shpallur nga Allahu e kemi mjaft pranë, si në pëllëmbë të dorës. Edhe tani ne e ndiejmë se së shpejti do të dëgjojmë dhe kuptojmë madje edhe dëshmitë dhe lavdet për Allahun nëpërmjet mijëra gjuhëve të natyrës:

> Lartmadhëri të merituar i shprehin Atij shtatë qiejt e toka dhe gjithçka ka në to, e nuk ka asnjë send që nuk e madhëron, duke i shprehur falënderim Atij, por ju nuk e kuptoni atë madhërim të tyre. Ai është i butë dhe fal shumë. (17:44)

Ne tashmë arrijmë të kuptojmë diçka në lidhje me domethënien e këtij vargu. Atomet më të vogla, ashtu si edhe mjegullnajat e mëdha yjore, të gjitha na flasin me gjuhën e tyre, të përulësisë së tyre ndaj Zotit të Vetëm dhe kështu e madhërojnë Atë. Megjithatë, ata të cilët mund t'i dëgjojnë dhe t'i kuptojnë këto lëvdata universale, janë shumë të paktë.

FORMIMI I EMBRIONIT: Ajo çfarë zbulon Kurani në lidhje me formimin e embrionit dhe fazat zhvillimore në mitër, është e habitshme. Vini re ajetin e mëposhtëm:

> O ju njerëz, nëse dyshoni për ringjalljen, atëherë Ne ju krijuam ju prej dheu, pastaj prej uji, pastaj prej një droçke gjaku të ngjizur, pastaj prej një cope sa një kafshatë mishi, që është krijesë e formuar ose e paformuar, në mënyrë që t'ju sqarojmë. (22/5)

Në një ajet tjetër, ky zhvillim është shpjeguar në hollësi më të madhe, dhe fazat e dallueshme janë theksuar më qartë:

> Për Allahun, Ne e krijuam njeriun prej një ajke, e një balte; Pastaj atë e bëmë pikë uji në një vend të sigurtë; Më pas atë pikë uji e bëmë copë gjaku, e atë gjak të ngurtë e bëmë copë mishi, e shndërruam në eshtra dhe eshtrave ua veshëm mishin, pastaj atë e bëmë krijesë tjetër. I lartë është Allahu, më i miri Krijues. (23/12-14)

PRODHIMI I MREKULLUESHËM I QUMËSHTIT: Ajo çfarë Kurani thotë në lidhje me qumështin dhe prodhimin e tij, është po aq e mrekullueshme sa vetë ky lëng, dhe aftësia jonë të kuptuarit tonë në këtë pikë, na ka sjellë mjaft përfitime:

> Ju edhe në kafshët keni mësim. Ne nga një pjesë e asaj që kanë në barqet e tyre mes ushqimit të tyre dhe gjakut, ju japim të pini qumësht të pastër, të shijshëm për ata që e pinë. (16/66)

Kurani e rrëfen në detaje të hollësishme procesin: tretjen e pjesshme dhe përthithjen e asaj që është gëlltitur si ushqim, dhe

pastaj një proces të dytë edhe përpunimin nëpër gjëndra. Qumështi është një burim i plotë dhe i këndshëm ushqimi për njeriun, dhe për më tepër, pronari i tij e refuzon atë si të padobishëm.

KRIJIMI NË ÇIFT: Kurani zbulon se të gjitha gjërat janë krijuar në çift: *Lavdi i qoftë Allahut, i Cili krijoi çdo gjë në çift; prej asaj që prodhon toka, nga vetë ata dhe nga çka ata nuk dinë. (36/36)*

Çdo gjë që ekziston ka homologun e vet, të kundërt ose komplementar. Çiftësia e qenieve njerëzore, kafshëve, bimëve dhe gjinive të caktuara ka qenë prej kohësh e njohur. Por ç'mund të thuhet për ato çifte gjërash, për të cilat ne nuk kemi dituri? Kjo mund të ketë të bëjë me një gamë të gjerë subjektesh, qofshin të pajeta, apo të gjalla. Në forcat e dobëta dhe parimet e natyrës, në brendësi (dhe në mes) të entiteteve të gjalla apo të vdekura, ekzistojnë shumë lloje çiftesh. Të gjitha gjërat, siç konfirmojnë edhe instrumentet tona moderne, ndodhin në trajtë binome.

Përkufizimi shkencor i krijimit në çifte, nënkupton "të kundërta të ngjashme". Kurani jep tre shembuj:

- Çiftet e prodhuara nga Toka (pozitron-elektron, proton-antiproton, antineutron-neutron), ato me karakteristika të ndryshme fizike dhe kimike (metalet dhe jometalet); çifte të kundërta biologjikisht (bimë dhe kafshë meshkuj dhe femra), dhe çifte të kundërta fizikisht.
- Çifte të vetvetes (burrë dhe grua, tipare të personalitetit të tilla si mizor - i mëshirshëm, bujar - dorështrënguar, dhe tipare që janë të ngjashme, por subjekt i gjykimeve me vlerë të kundërt, të tilla si hipokrizi - sinqeritet).
- Çiftet për të cilët ne nuk dimë ende asgjë.

  Zbulimi i pozitronit dhe "barazia" (krijimi në çifte), i përmendur nga Kurani 14 shekuj më parë, mund të konsiderohen si një pikë kthese në fizikën bashkëkohore.

  KRIJIMI I BOTËS: Kurani e rrëfen, me gjuhën e tij unike, krijimin fillestar të botës dhe të banorëve të saj të gjallë:

> A nuk e dinë ata të cilët nuk besuan se qiejt e toka ishin të ngjitura, e Ne i ndamë ato të dyja dhe ujin e bëmë bazë të jetës së çdo sendi; a nuk besojnë? (21/30)

Këtu nuk duhet ngatërruar baza e jetës me bazën e gjithësisë. Domethënia e këtij ajeti është e qartë, dhe nuk duhet të errësohet nga hipoteza të tilla si ajo që thotë, se materiali kryesor në krijim ka qenë një eter ose një re e madhe, një mjegullnajë gjigande ose një masë e gazit të nxehtë, apo diçka tjetër. Kurani thekson se çdo gjallesë u krijua nga uji. Nëse uji në vetvete ishte shkaktuar nga ngritja e gazeve dhe avujve nga toka, kondensimit, dhe pastaj kthimit në tokë në formë reshjesh për të formuar detet dhe për të përgatitur një ambient të përshtatshëm për jetën, ose nëpërmjet ndonjë procesi tjetër, kjo është relativisht e parëndësishme.

Ajeti në mënyrë eksplicite e paraqet universin si një mrekulli unike të krijimit. Çdo gjë në të është një pjesë integrale e asaj mrekullie dhe përmban shenja që provojnë pretendimin e Tij. Çdo gjë është e ndërlidhur, ashtu si gjethet e një peme masive. Ato janë të gjitha të ndryshme, por i ngjajnë njëra-tjetrës dhe janë të lidhura me një rrënjë të përbashkët. Ajeti gjithashtu thekson vitalitetin dhe rëndësinë e ujit, sepse ai përbën tri të katërtat e masës se trupit të shumicës së krijesave të gjalla.

ORBITA E DIELLIT: Dielli zë një vend të veçantë dhe të rëndësishëm. Kurani zbulon aspektet më të rëndësishme të tij me katër fjalë, kuptimi i plotë i të cilave nuk mund të jepet aq lehtë: *Edhe dielli udhëton për në kufirin e vet. Ai është përcaktim i Ngadhënjyesit, të Gjithëdijshmit. (36:38)*

Duke pasur parasysh kontekstin, fjala *mustakarr* mund të nënkuptojë një orbitë të caktuar, një vend fiks pushimi apo vendbanimi, një rrugë të përcaktuar në kohë. Ne na është thënë se dielli ndjek një trajektore të paracaktuar drejt një pike të veçantë. Sistemi ynë diellor po shkon drejt yjësisë *Lyra* me një shpejtësi pothuajse të pakonceptueshme: Çdo sekondë ne i afrohemi asaj dhjetë milje (gati një milion milje në ditë). Vëmendja jonë është tërhequr edhe

në faktin se kur dielli përfundon detyrën e tij të caktuar, do të respektojë komandën për të pushuar.

E tillë është pasuria e Kuranit, e cila shpjegon shumë të vërteta në kaq pak fjalë. Këtu, vetëm në katër fjalë, shumë gjëra të paqarta u qartësuan, në një kohë kur njerëzit në përgjithësi besonin se dielli bënte një rrotullim të përditshëm rreth Tokës.

ZGJERIMI I UNIVERSIT: Një tjetër ajet kuranor frymëzues, dhe aq i thukët, ka të bëjë me shrtirjen apo zgjerimin e universit në hapësirë. Ky koncept është përmendur në vetëm katër fjalë: *Ne me forcën Tonë e ngritëm qiellin dhe Ne e zgjerojmë atë; Edhe tokën e kemi shtruar, sa Shtrues të mirë jemi. (51:47-48)*

Ajeti tregon se distanca në mes të trupave qiellorë është në rritje, që do të thotë se universi po zgjerohet. Në vitin 1922, astronomi Hubble pohoi se të gjitha galaktikat, me përjashtim të pesë prej tyre të afërta me Tokën, janë duke lëvizur larg në hapësirë me një shpejtësi në proporcion me distancën e tyre nga Toka. Sipas tij, një galaktikë një milion vjet dritë larg nesh është duke u larguar më tej me një shpejtësi prej 168 km/vit, një galaktikë dy milionë vjet dritë larg me dyfishin e kësaj shpejtësie, e kështu me radhë. Le Maitre, një matematikan dhe prift belg, propozoi dhe zhvilloi më vonë teorinë sipas së cilës gjithësia është në zgjerim. Pa marrë parasysh se si përpiqemi ta shprehim këtë realitet, qoftë përmes koeficientit Hubble apo një teorie tjetër në të ardhmen, Zbulesa është qartësisht e pagabueshme mbi vetë realitetin.

LIGJET NË NATYRË: Kurani ofron disa tregues të veprimtarisë së padukshme të ligjeve të ndryshme si tërheqjes dhe shtytjes, rrotullimin rreth vetes apo rreth një trupi tjetër: *Allahu është Ai i Cili i ngriti qiejt pa ndonjë shtyllë që ju* të *mund t'i shihni ato. (13/2)*

Të gjithë trupat qiellorë lëvizin në të, me rregull, harmoni dhe ekuilibër. Ata janë mbajtur dhe mbështetur nga "shtylla" të padukshme, disa prej të cilave janë forcat shtytëse apo centrifugale: *Ai mban qiellin që të mos bjerë në tokë, përveç nëse dëshiron Ai. (22/65)*

Në çdo moment, qiejt mund të bien mbi Tokë. Fakti që Ngadhën-

jyesi nuk lejon që kjo të ndodhë, përbën një tjetër shembull të bindjes ndaj Fjalës së Tij universale. Shkenca moderne e shpjegon këtë si një ekuilibër të forcave centripetale dhe centrifugale. Çfarë është e një rëndësie më të madhe megjithatë, është fakti se i kemi kthyer mendjet tona drejt asaj bindjeje dhe drejt Mëshirës Hyjnore, që e mban universin në lëvizje qëndrueshme, në vend që të vendosim për të pasuar teoritë e Njutonit apo të Ajnshtajnit rreth termave mekanikë të një bindjeje të tillë.

UDHËTIMI PËR NË HËNË: Shumë kohë më parë, disa interpretues të Kuranit patën menduar se udhëtimi për në hënë, dikur i konsideruar si një mundësi shumë e largët, mund të gjendet në ajetin: *Dhe në hënën që është e plotë; Ju patjetër do të përjetoni gjendje pas gjendjeje. (84/18-19)*

Interpretues të hershëm e patën marrë këtë si një referencë figurative në jetën tonë shpirtërore, një kthim prapa nga një fazë në tjetrën dhe nga një qiell në një tjetër. Të tjerët e interpretuan atë duke iu referuar ndryshimeve në përgjithësi, nga një gjendje në tjetrën. Përkthyesit më vonë i dhanë kuptime të paqarta, për shkak se kuptimi i vërtetë nuk pajtohej me besimin e tyre për udhëtime në distanca të tilla. Por në fakt, ndjesia më e përshtatshme e fjalëve pas betimit: "Për hënën!", duke pasur parasysh kontekstin e menjëhershëm të ajetit, është ajo e një udhëtimi real për në hënë, qoftë fjalë për fjalë, apo në mënyrë figurative.

FORMA E TOKËS: Përshkrimet kuranore të formës gjeografike të Tokës dhe ndryshimit të asaj forme, janë veçanërisht interesante: *A nuk e vërejnë ata se Ne ua pakësojmë tokën nga anët e saj, atëherë ata a mos do të jenë fitues? (21:44)*

Referenca për këtë pakësim mund të lidhet më tepër me faktin tashmë të njohur se Toka është e shtypur në polet, apo edhe me erozionin e maleve nga era dhe shiu, të zonave bregdetare pranë detit, apo të shkretimit gradual të tokës bujqësore.

Në një kohë kur njerëzit në përgjithësi besonin se toka ishte e sheshtë dhe e palëvizshme, Kurani në mënyrë eksplicite dhe

implicite, zbuloi se ajo është e rrumbullakët. Më i papritur ende, është fakti se Kurani gjithashtu thotë se forma e saj e saktë i ngjan më shumë një veze struci sesa një sfere: *E pastaj tokën e sheshoi si vezë; Dhe prej saj nxorri ujin dhe kullosat e saj; Kurse kodrat ia përforcoi. (79:30-32)*

Folja *daha*' ka kuptimin "t'i japësh formën e vezës" dhe emri i rrjedhur prej saj është *da'hia*, që ende sot përdoret për të përshkruar "një vezë." Meqenëse ky fakt shkencor mund t'u jetë dukur i pasaktë shkencëtarëve që kanë jetuar përpara epokës së shkencës moderne, disa interpretues e patën keqkuptuar domethënien e termit. Ata e kuptuan atë si "e shtrirë", ndoshta nga frika se kuptimi i saktë i saj mund të ishte i vështirë për t'u kuptuar dhe në këtë mënyrë njerëzit mund të kequdhëzoheshin. Instrumentet moderne shkencore kohët e fundit kanë nxjerrë, gjatë matjeve, se Toka më shumë ka formën e një veze sesa të një sfere të përsosur dhe se ekziston një shtypje e lehtë rreth poleve, si dhe një harkore e vogël përreth ekuatorit.

TËRHEQJA E PËRGJITHSHME GRAVITACIONALE: Në ajetin: *Mandej e mësyu qiellin e ai ishte tym, dhe atij edhe tokës u tha: "Qasjuni urdhrit Tim me dëshirë ose me dhunë!" Ato* të dyja thanë: "Po qasemi me dëshirë!" (41:11), Kurani tregon se një bashkëpunim i tillë është i vështirë. Ne e dimë se molekulat e atomeve të atmosferës përpiqen për të ikur nëpër hapësirë, ndërsa Toka përpiqet për t'i tërhequr dhe kapur ato. Por për të ekzistuar një atmosferë, forcat lëvizëse që çojnë në largimin e molekulave, duhet të balancohen nga tërheqja gravitacionale e Tokës. Ky kusht është pothuajse i pamundur për t'u përmbushur. Nga pikëpamja e gjeofizikës, këto kushte kërkojnë që të ruhen tri balanca të rëndësishme: temperatura atmosferike, tërheqja e përgjithshme gravitacionale e Tokës, dhe mosprishja e kësaj balance nga rrezatimet e ndryshme energjitike që vijnë nga hapësira. Kurani i shpreh këto fakte në ajetin e lartpërmendur. Meqë kushtet e tilla janë pothuajse të pamundura për t'u përmbushur vetvetiu, atëherë fuqia e Allahut tregohet në fjalët: "*Ato* të dyja thanë: "*Po qasemi me dëshirë!*"

FORMA SFERIKE E PLANETEVE DHE RROTULLIMET: Këto shfaqen në: *Ai është Zoti i qiejve dhe i tokës dhe i gjithçka ka ndërmjet tyre; Ai është Zoti i lindjeve* (37/15), sepse koncepti i "lindjeve" ngërthen dimensione të panumërta dhe ndryshon sipas pozicionit të Tokës. Një pikë në Tokë është në lindje në lidhje me rajonet e saj perëndimore. Prandaj koncepti i Lindjes ndryshon në çdo moment në Tokë, ndaj këto formojnë një ansambël Lindjesh. Përveç kësaj, ekzistojnë 180 pika të lindjes së diellit, që do të thotë se dielli lind në një vend të vetëm për 2 ditë në vit dhe në këtë mënyrë, ekzistojnë gjithsej 180 lindje. Gjithashtu ky ajet paraqet meridianet, dimensionet e panumërta, relativitetin e hapësirës, formën sferike të planeteve dhe rrotullimin e tokës.

NJË BARRIERË MIDIS DY DETEVE: Shkencëtari francez Jacques Cousteau,[23] zbuloi se Deti Mesdhe dhe Oqeani Atlantik kanë përmbajtje të ndryshme kimike dhe biologjike. Pasi kreu studime nënujore në Ngushticën e Gjibraltarit për të shpjeguar këtë dukuri, ai doli në përfundimin se "ujëra të freskëta, të papritura, rrjedhin nga burime që ndodhen në brigjet jugore dhe ato veriore të Gjibraltarit. Këta përrenj nënujorë derdhen në drejtim të njëri-tjetrit në një kënd prej 45°, duke formuar një digë reciproke si dhëmbët e një krehëri. Për shkak të këtij fakti, Deti Mesdhe dhe Oqeani Atlantik nuk mund të përzihen." Kur ia treguan ajetet: *Ai i lejoi detet të puqen mes vete; Ndërmjet atyre të dyve është një pengesë që ata nuk e kapërcejnë dot (55/19-20)*, Cousteau u mahnit.

Ky ajet, më tej, na tërheq vëmendjen për përbërjen planktonike të deteve, si dhe rreth florës apo shpërndarjeve të peshkut, që variojnë me ndryshimin e temperaturës. Shumë ajete të tjera kuranore, hedhin dritë mbi fakte shkencore, dhe çdo person është i ftuar për t'i studiuar ato: *Ne Kuranin e bëmë të lehtë për reflektim dhe studim. Po a ka ndonjë që merr mësim?* (54/17)

Do të vijë një ditë kur: *Ne do t'u bëjmë atyre të mundshme të shohin argumentet Tona në horizonte dhe në veten e tyre derisa t'u bëhet e qartë se ai (Kur'ani) është i vërtetë. A nuk mjafton që Zoti yt është D*ëshmitar për çdo gjë? (41/*53).* Në të ardhmen njerëzimi

do të përqendrohet më tepër në shkencë, dhe Kurani (homologu i gjithësisë i hedhur në letër dhe fusha në të cilën janë manifestuar Emrat e Allahut), do ta provojë veten se është vërtet Shpallja e Allahut.

ZHVILLIMET SHKENCORE TË LIDHURA ME NGJARJE TË CAKTUARA HISTORIKE: Shikoni pak shembujt e mëposhtëm në të cilët aludohet për trenat dhe elektricitetin:

> Mallkuar qofshin ata të zotët e hendeqeve; Të zjarrit plot me lëndë djegëse; Kur ata rrinin ulur rreth tij; Dhe dëshmonin atë që bënin me besimtarët; E nuk patën përse t'i urrejnë përveç që besuan Allahun, Ngadhënjyesin, të Lavdëruarin. (85:4-8)

> Po kështu...Argument për ta është edhe ajo që Ne, pasardhësit e tyre (të Ademit) i bartëm në anije të mbushur përplot; Dhe ngjashëm me të u krijuam atyre diçka që t'i hipin. (36:41-42)

Ajete të tilla aludojnë për trenat, kurse njëri prej shumë nënkuptimeve dhe aludimeve, i cili mund të gjendet në ajetin në vijim, ka të bëjë me elektricitetin:

> Allahu është dritë e qiejve dhe tokës. Shembulli i dritës së Tij, i ngjason kandilit të vendosur në një zgavër të errët. Kandili gjendet brenda një qelqi si të ishte yll flakërues e që ndizet prej një druri të bekuar, prej ullirit që nuk mund të quhet as i Lindjes e as i Perëndimit, e vaji i tij ndriçon thuajse edhe pa e prekur zjarri. Dritë mbi dritë. Allahu udhëzon nga drita e Vet atë që do Ai. Allahu sjell shembuj për njerëzit. Allahu çdo gjë e di shumë mirë. (24/35)

Kurani gjithashtu aludon rreth përparimeve teknologjike dhe shënon zhvillimin e tyre përfundimtar, duke përmendur mrekullitë e profetëve.

Zoti i Plotfuqishëm i dërgoi Profetët tek komunitetet njerëzore si udhëheqësit dhe pararoja e përparimit shpirtëror dhe moral. Ai gjithashtu i pajisi ata me mrekulli dhe çudi të caktuara, duke i bërë ata mjeshtrat dhe pararendësit e përparimit material të njerëzimit, dhe i urdhëroi njerëzit që t'i pasonin ata pa mëdyshje.

Kurani i inkurajon njerëzit që të përfitojnë nga përsosmëria

shpirtërore dhe morale e profetëve nëpërmjet përmendjes së tyre, dhe i nxit njerëzit për të arritur nëpërmjet shkencës ato çfarë Profetët i patën shfaqur njerëzimit nëpër mrekullitë e tyre. Siç ishte rasti me arritjet shpirtërore dhe morale, edhe arritjet materiale të cilat janë paraqitur si mrekulli për njerëzimin, kanë qenë dhurata të sjella me anë të mrekullive profetike. Për shembull, Noe ndërtoi anijen e parë dhe Jozefi bëri orën e parë. Kështu, të dyja këto janë mrekulli profetike dhuruar njerëzimit. Kjo është arsyeja pse aq shumë zejtarë kanë miratuar një profet, si një padron apo gjenerues të zejeve të tyre: marinarët kanë Noen, orëndreqësit kanë Jozefin, dhe rrobaqepesit kanë Enokun.

Meqenëse dijetarët kërkues të së vërtetës dhe shkencëtarët e elokuencës kanë rënë dakort në idenë se secili ajet kuranor përmban udhëzim dhe shpjegim, këto ajete (të cilat janë ndër më brilantet), të cilat kanë të bëjnë me këto mrekulli, nuk duhet të merren vetëm si evente historike, por si ajete që përmbajnë kuptime të shumta me qëllim udhëzimin. Duke përmendur këto mrekulli, Kurani tregon se qëllimi përfundimtar i zhvillimeve shkencore dhe teknologjike, specifikon qëllimet e tyre përfundimtare, dhe nxit njerëzimin për t'i ndjekur këto qëllime. Ashtu siç e kaluara është fushë për farat e ardhshme dhe një pasqyrë për potencialin e tyre, edhe e ardhmja është koha për të korrur të mbjellat e jetës së kaluar dhe një pasqyrë e situatës aktuale. Nga shembujt e shumtë, po japim vetëm disa:

UDHËTIMI NË AJËR: Ajeti: *Edhe Sulejmanit ia nënshtruam erën, që paraditja ishte sa një muaj dhe pasditja sa një muaj (34/12*), ka të bëjë me njërën prej mrekullive të Sulejmanit. Ai na tregon se: "Sulejmani e përshkoi distancën prej 2 muajsh në këmbë, në dy vakte duke fluturuar nëpër ajër." Duke sugjeruar se udhëtimi nga ajri është i mundur, ai e fton njerëzimin për të mësuar se si ta bëjë këtë dhe pastaj ta realizojë në praktikë. Zoti i Plotfuqishëm gjithashtu ka thënë se: "Njëri nga shërbëtorët e mi nuk iu nënshtrua dëshirave të tij trupore, kështu që Unë e ngrita atë në ajër. Nëse ju largoni dembelizmin dhe përfitoni nga ligjet e mia në

natyrë, edhe ju do të jeni në gjendje ta bëni një gjë të tillë."

CENTRIFUGA DHE PUSET ARTEZIANE: "*Dhe kur Musai kërkoi ujë për popullin e tij, e Ne i thamë: "Bjeri gurit me shkopin tënd," atëherë nga ai gufuan dymbëdhjetë kroje që secili grup e dinte vendin ku do të pinte." (2/60)*

Ky ajet tregon se duke përdorur mjete të thjeshta na mundësohet për të përfituar nga thesaret nëntokësore të ujit të bekuar, i cili mund të nxirret edhe në vende që janë të forta si shkëmbi, me pak mund. Me fjalë të tjera: "Meqë ju mund ta gjeni bekimin më të mirë të Mëshirës Hyjnore - ujin - me një mjet apo pajisje të thjeshtë, përpiquni ta gjeni atë." Nëpërmjet këtij ajeti, Zoti i Plotfuqishëm sugjeron: "I dhashë një mjet njërit prej shërbëtorëve të Mi, të cilët mbështeteshin tek Unë, dhe me atë, ai e nxorri me radhë ujin ngado që ai dëshironte. Nëse ju mbështeteni në ligjet e mia të Mëshirës, ju mund ta përfitoni një pajisje të ngjashme. Pra, mos ngurroni, por veproni kështu."

Një rezultat i rëndësishëm i progresit shkencor është shpikja e pajisjeve që nxjerrin ujë nga pusi në shumicën e vendeve ku ato vendosen. Ajeti ka si pikësynim objektivat e mëtejshme dhe kufizimet, përkundrejt këtij fakti, ashtu siç vërejtëm edhe tek ajetet e mëparshme, tek të cilat prezupozohen edhe arritje të tjera shumë më të përparuara sesa aeroplani.

NJË KURË PËR ÇDO SËMUNDJE: Ajeti: *Unë i shëroj të verbrit, të sëmurët në lëkurë dhe unë me lejen e Allahut ngjall të vdekurit (3/49)*, ka lidhje me njërën prej mrekullive të Jezusit. Ai aludon dhe nxit për shkallën më të lartë të shërimit, me të cilin Allahu e kishte pajisur atë dhe ndërkohë sugjeron: "Edhe për sëmundjet më të vështira ekziston një kurë. Pra, mos e humbni shpresën, o bijtë e Ademit. Përkundrazi, kërkoni për atë dhe do të arrini ta gjeni. Ajo mund edhe t'i japë një nuancë të përkohshme jetës deri në vdekje."

Me anë të këtij ajeti, Zoti i Plotfuqishëm thotë: "Një nga robërit e Mi hoqi dorë nga bota për shkakun tim, kështu që Unë i dhashë atij dy dhurata: ilaçin për sëmundjet shpirtërore dhe shërimin për

sëmundjet fizike. Zemrat e të vdekurit u gjallëruan përmes dritës së udhëzimit, dhe ata njerëz që ishin në prag të vdekjes për shkak të sëmundjes së tyre, u shëruan nëpërmjet frymës së tij dhe kurimit. Ju mund të gjeni kurë për të gjitha sëmundjet në farmacinë Time në natyrë, ku kam bashkangjitur shumë objektiva të rëndësishme për çdo gjë. Nëse ju do të kërkoni me humanizëm, me siguri do ta gjeni atë!" Ky ajet shënon pikën përfundimtare të përparimit mjekësor, një pikë mjaft e largët në krahasim me nivelin e tanishëm, dhe u bën thirrje njerëzve të ecin drejt saj.

Shumë ajete të tjera kuranore aludojnë në lidhje me synimet përfundimtare të progresit shkencor, siç bëjnë edhe disa nga traditat profetike. Për shembull, burime të besueshme të të dhënave të transmetuara nga Tradita e Profetit, thonë që një ditë, një shegë e vetme do të jetë e mjaftueshme për të ushqyer më shumë të njëzet veta dhe se lëkura e saj do të shërbejë si hije për ta. Ai gjithashtu ka profetizuar se gruri i prodhuar në një sipërfaqe sa madhësia e ballkonit të një shtëpie, do të jetë i mjaftueshëm për të ushqyer një familje për një vit të tërë.[24]

- Ajeti: *E ai, i cili kishte dituri nga libri tha: "Unë ta sjell atë (fronin e mbretëreshës së Sebe-s) ty (Sulejmanit në Jeruzalem) sa hap e mbyll sytë" (27/40),* parashikoi se një ditë imazhet apo edhe objektet fizike, do të përcilleshin në çast, nëpërmjet njohurive të Librit të Shenjtë të Universit, pikërisht si ato të cilët zotërojnë njohuri rreth Librit të Shpalljes Hyjnore, arrijnë t'i sjellin objektet nga një distancë e madhe sa hap e mbyll sytë.
- Kurani simbolikisht na informon se mund të bëhet realitet identifikimi i një vrasësi nëpërmjet disa qelizave të marra nga trupi i të vrarit në çastet pas vdekjes: Një vrasës u zbulua në kohën e Moisiut nëpërmjet prekjes së trupit të të vrarit me një copë mishi të marrë nga një lopë, të cilën Allahu i Plotfuqishëm i pat urdhëruar Bijtë e Izraelit për ta therur. (2:67-73)

- Si shembull të fundit, le të shohim se çfarë thotë Kurani rreth diellit dhe hënës: "*Ne i bëmë natën dhe ditën dy fakte, e shenjën e natës e shlyem (e errësuam), e shenjën e ditës e bëmë të ndritshme që të mund të angazhoheni për shfrytëzimin e begative të dhuruara nga Zoti juaj, dhe që të mësoni njehsimin e viteve dhe llogaritjen (e kohës). Ne kemi sqaruar çdo send në mënyrë të hollësishme." (17/12).*

Sipas Ibn Abbasit, *shenja e natës* ka të bëjë me hënën, ndërsa *shenja e ditës* me diellin. Prandaj, nga fragmenti *shenjën e natës e shlyem,* ne kuptojmë se hëna dikur ka lëshuar dritë sikurse dielli, dhe se për arsye të caktuara, Zoti ia ka marrë dritën asaj, duke bërë që ajo të errësohej apo bëhej jo ndriçuese. Ndërkohë që ky ajet bën fjalë për të shkuarën e hënës, ai nënvizon gjithashtu të ardhmen e trupave të tjerë qiellorë.

Shumë vargje të tjera janë të lidhura me ato që ne tani i quajmë fakte shkencore. Ekzistenca e tyre tregon se kërkesa jonë për dije, është një pjesë e Mëshirës Hyjnore, e dhuruar me zemërgjerësi nga Krijuesi ynë. Në të vërtetë, Mëshira Hyjnore është një nga emrat e vetë Kuranit. Të gjitha të vërtetat dhe njohuritë që ai përmban, shkojnë përtej aftësive tona për t'i rinumëruar apo edhe për t'i mbajtur ato në mendjen tonë.

Megjithatë, ne duhet të mbajmë parasysh faktin se ndërsa Kurani aludon për shumë të vërteta shkencore, ai nuk është një libër i shkencës apo shpjegimeve shkencore. Përkundrazi ai është, dhe gjithmonë është kuptuar nga besimtarët si libri i udhëzimit, që na mëson rrugën për besimin e duhur dhe veprimet e duhura, në mënyrë që ne të mund ta meritojmë Mëshirën dhe Faljen Hyjnore. Është në përgjegjësinë tonë pastaj për t'u siguruar që ndjekja e rrugëve të tjera shkencore të dijes të kryhet nën dritën e Kuranit, i cili në këtë mënyrë e inkurajon dhe mbështet atë.

Një qëndrim i tillë, rezulton në një dije e cila nuk nxit arro-gancën dhe mendjemadhësinë, për arsye se të tilla ndjenja shpien në rrënim mendor dhe degradim njerëzor, për të mos

folur pastaj për degradimin e Tokës, shtëpisë sonë të përkohshme, të cilën e kemi amanet hyjnor.

Përse i referohemi shkencës dhe fakteve shkencore?

Ne i referohemi shkencës dhe fakteve shkencore kur shpjegojmë Islamin, për arsye se disa njerëz pranojnë të dëgjojnë vetëm faktet shkencore. Si materialistët, ashtu edhe njerëzit fetarë dhe jofetarë, kanë synuar që ta shfrytëzojnë shkencën për të shpërfillur fenë, dhe nëpërmjet shkencës t'u japin ideve të tyre më shumë rëndësi sesa ato meritojnë. Nëpërmjet një qëndrimi të tillë, ata kanë arritur të mashtrojnë dhe të prishin botëkuptimet e shumë njerëzve. Prandaj, ne duhet të mësojnë se si të flasim me ta me gjuhën e tyre, për të provuar se shkenca dhe teknologjia nuk e kundërshtojnë Islamin. Ne duhet t'ua kthehejmë argumentet e veta kundër tyre, duke i vlerësuar ato dhe pastaj duke i përdorur për të udhëzuar njerëzit në rrugën e drejtë.

Një qasje e tillë është plotësisht e lejueshme; pastaj si mund t'i kundërshtojmë ato gjëra që thonë të tillë njerëz, në qoftë se nuk jemi të përgatitur mirë në lidhje me faktet dhe idetë e tyre? Kurani na nxit që të reflektojmë dhe të studiojmë, duke vëzhguar yjet dhe galaktikat. Ato na impresionojnë për madhështinë e Krijuesit, na këshillojnë të bredhim në mesin e njerëzve, dhe të drejtojmë vëmendjen tonë drejt natyrës së mrekullueshme të organeve tona dhe krijimit fizik.

Që nga atomet e qenieve të mëdha, nga pamja njeriut të parë në tokë e deri në largimin tonë përfundimtar, Kurani e vendos të gjithë krijimin përpara syve tanë. Nëpërmjet trajtimit të një shumëllojshmërie faktesh, ai na tregon se *Allahut ia kanë frikën nga robërit e Tij vetëm dijetarët (35/28)*, duke na nxitur kështu ta kërkojmë dijen, të reflektojmë dhe të hulumtojmë. Megjithatë, ne nuk duhet të harrojmë se të gjitha aktivitetet e tilla duhet të jenë në përputhje me frymën e Kuranit. Përndryshe, edhe pse ne mund të pretendojmë se jemi duke ndjekur këshillat dhe urdhrat

e tij, në të vërtetë jemi duke u larguar nga ai.

Shkenca dhe faktet e saj mund dhe duhet të përdoren për të shpjeguar të vërtetat islame. Por në qoftë se ne i përdorim ato për të nxjerrë në pah vetëm dijen tonë, çfarëdo që të themi nuk mund të ndikojë në audiencën tonë në mënyrë të drejtë në mënyrën e duhur, e madje asfare. Fjalët e bukura dhe argumentet bindëse e humbasin efektshmërinë e tyre në qoftë se ne kemi ndonjë pikësynim të gabuar: ato përthithen vetëm aq sa dëgjojnë daullet e veshëve dhe nuk shkojnë më tej. Në mënyrë të ngjashme, nëse argumentet tona synojnë për t'i bërë të tjerët të heshtin në vend që të synojnë bindjen e tyre, ne në fakt do të bllokojmë rrugën e tyre për një kuptim të saktë. Përpjekja jonë do të dështojë, dhe qëllimet tona do të mbeten të parealizuara.

Megjithatë, nëse ne përpiqemi t'i bindim të tjerët me një sinqeritet të plotë dhe të përshtatshëm, edhe ata, të cilët nuk kanë nevojë për të tilla argumente që të besojnë, do të arrijnë të marrin pjesën e tyre dhe të përfitojnë. Ndonjëherë një argument i sinqertë mund të jetë shumë më i dobishëm sesa një tjetër për të cilin ju arrini të shpreheni më lirshëm dhe në mënyrë elokuente. Qëllimi ynë kryesor, kur në biseda fusim shkencën dhe faktet shkencore, në përputhje me nivelin e audiencës sonë dhe të nivelit mirëkuptimit nga të tjerët, duhet të jetë fitimi i kënaqësisë së Zotit.

Shkenca nuk mund të konsiderohet si superiore ndaj fesë, dhe çështjet thelbësore islame nuk mund të përdorin shkencën apo faktet shkencore moderne, për të justifikuar ose forcuar kredibilitetin e fesë. Nëse ne biem dakord me teknika të tilla, atëherë heshturazi kemi shpallur se kemi dyshime në lidhje me të vërtetat e Islamit dhe se kemi nevojë për shkencën për t'i mbështetur ato. Përveç kësaj, ne nuk mund ta pranojmë shkencën apo faktet shkencore si absolute. Të kthyerit e shkencës si kriter vendimtar për të vërtetuar autenticitetin e Kuranit apo origjinën e tij hyjnore, duke e vendosur kështu shkencën mbi Kuranin, është diçka absurde, e pështirë dhe tërësisht e palejueshme. Përdorimi i argumenteve dhe aluzioneve të tilla ndaj shkencës, ka në rastin më të

mirë një rol mbështetës të dorës së dytë. Vlera e vetme e tyre është se ato mund të hapin një derë, të cilën disa njerëz thjesht nuk e dinë se ekziston.

Shkenca duhet përdorur vetëm për të zgjuar apo trazuar disa mendje, të cilat përndryshe mund të qëndronin në gjumë apo të pandikuara. Ajo është si një pendë që përdoret për të fshirë pluhurin që mbulon të vërtetën dhe dëshirën për të vërtetën, e cila qëndron e fshehur në ndërgjegjet e pashqetësuara. Në qoftë se ne fillojmë të themi se shkenca është absolute, do të katandisemi duke u përpjekur për t'ia përshtatur Kuranin dhe Hadithin asaj. Rezultati i një ndërmarrjeje të tillë mund të jetë vetëm dyshimi dhe konfuzioni, sidomos kur ne nuk arrijmë ta pajtojmë Kuranin dhe Hadithin me disa pohime aktuale të shkencës, të cilat, në të ardhmen, mund të rezultojnë të gabuara.

Qëndrimi ynë duhet të jetë i qartë: Kurani dhe Hadithi janë të vërteta absolute. Shkenca dhe faktet shkencore janë të vërteta (ose të rreme) vetëm në atë shkallë që ato pajtohen (ose nuk pajtohen) me këto burime. Edhe faktet shkencore të përcaktuara në mënyrë definitive, nuk mund të jetë shtylla, të cilat mbështesin të vërtetat e besimit, por ato mund të pranohen vetëm si instrumente të cilat përdoren për të na dhënë ide ose për të nxitur reflektimin tonë në Allahun, i Cili është Ai që përcakton të vërtetat e besimit në ndërgjegjen tonë. Nëse presim që kjo të bëhet me anë të shkencës, kemi bërë një gabim të rëndë, sepse besimi vjen vetëm përmes udhëzimit hyjnor.

Kushdo që dështon ta kuptojë këtë, bën një gabim nga i cili është e vështirë të shërohet. Njerëz të tillë kërkojnë dhe mbledhin prova nga i gjithë universi dhe duke u përpjekur për ta stërvitur veten për të folur më me elokuencë në emër të Allahut, mbeten shërbëtorë të pavetëdijshëm dhe adhurues të natyrës. Ata studiojnë dhe flasin për lulet, gjelbërimin dhe pranverën e natyrës, por as gjelberimi më i vogël i besimit nuk zë vend në ndërgjegjen e tyre. Ata kurrë nuk mund ta ndiejnë ekzistencën e Allahut brenda ndërgjegjes së tyre. Në pamje të parë ata duket sikur nuk e adhu-

rojnë natyrën, por në realitet është pikërisht ajo që ata bëjnë.

Një burrë apo një grua është një besimtar (mu'min), për shkak të besimit në zemrën e tij ose të saj, e jo prej sasisë së madhe të dijes që bart në kokë. Pasi kemi kuptuar aq sa mundemi në lidhje me provat objektive dhe subjektive që kemi mbledhur, ne duhet të thyejmë varësinë tonë nga rrethanat e jashtme, cilësitë dhe kushtet e dëshmive të tilla. Vetëm duke bërë këtë, ne do të jemi në gjendje për të bërë ndonjë përparim shpirtëror. Kur ne të braktisim këtë varësi dhe të ndjekim zemrën dhe ndërgjegjen tonë brenda dritës së Kuranit dhe udhëzimit të tij, atëherë, në dashtë Allahu, do ta gjejmë ndriçimin shpirtëror në kërkim të të cilit jemi. Siç ka thënë dikur edhe filozofi gjerman Immanuel Kant: "Unë ndjeva nevojën për të lënë pas të gjitha librat që kam lexuar, në mënyrë që të besoja në Zot."

Padyshim Libri i Madh i Universit dhe libri i natyrës së vërtetë të njerëzimit (Kurani), si edhe interpretimet e tyre, kanë vendin dhe rëndësinë e tyre të duhur. Por, pasi ne t'i përdorim, ne duhet të vëmë mënjanë ato dhe të jetojmë me besimin tonë, si të thuash, ballë për ballë. Kjo mund të tingëllojë mjaft abstrakte për ata që nuk kanë hyrë aq thellë në përvojën e besimit dhe ndërgjegjes. Por për ata netët e të cilëve janë të ndriçuara nga përkushtimi dhe që bëhen me krahë përmes përgjërimit për t'iu afruar Zotit të tyre, kuptimi është i qartë.

PYETJE: Përse myslimanët nuk e kanë zhvilluar shkencën dhe kësodore t'i kishin zbuluar vetë të tilla të vërteta kuranore? Përse Perëndimi i dominon ata?

PËRGJIGJE: Për aq sa koha dhe kushtet e favorshme i kanë lejuar, myslimanët zbuluan shumë të vërteta të Kuranit, dhe duke iu bindur urdhërave të tij, themeluan një qytetërim madhështor që zgjati për shumë shekuj.

Një shembull tipik: Ndërsa shpjegon kuptimin e ajetit: *Ne i lëshojmë erërat mbarështuese, nga qielli l*ëshojmë shi dhe atë jua japim ta pini, e ju nuk mund t*a ruani atë (15:22),* Ibn Xharir al-

Tabari (839-923), rrëfen për mënyrën se si era i fertilizon retë duke formuar në këtë mënyrë shiun. Ajeti përmend në mënyrë të qartë erërat mbarështuese të reve, për shkak se kjo ka të bëjë direkt me formimin e shiut. Shkencëtarët, kohët e fundit zbuluan se edhe retë janë të ngarkuara me energji elektrike dhe se shiu formohet vetëm kur polet pozitive dhe negative të reve formojnë një qark elektrik.

Në veprën e tij *Al-Bahr al-Muhit*, Ebu Haj'janan al-Andalusi, i referohet Ebu Xhalar ibn al-Zubajr-it ku shprehet, se bazuar në ajetet:

> Elif, Lam, Mim; Bizantinët u mundën; Në tokën më të afërt, por pas disfatës së tyre ata do të ngadhënjejnë; brenda pak viteve. Çështja është vendim i Allahut fillim e mbarim. E atë ditë besimtarët do të gëzohen; për ndihmën e Allahut. Ai ndihmon atë që do dhe Ai është i Gjithfuqishëm, Mëshirues (30/1-5)

Ebu al Hakim ibn Barrajan, arriti të zbulonte ditën, muajin dhe vitin e saktë në të cilin myslimanët do të rimerrnin Jeruzalemin nga duart e kryqtarëve (1187) shumë kohë përpara se kjo të ndodhte.

Islami sundoi mbi dy të tretat e qytetërimit të botës së vjetër, për të paktën njëmbëdhjetë shekuj. Gjatë afro 1400 viteve të ekzistencës së tij, ai ka përjetuar sulme të vazhdueshme nga Lindja dhe nga Perëndimi, e prapseprapë e ruajti superioritetin tij deri në shekullin e tetëmbëdhjetë! Megjithatë, vetëm kur prishja morale dhe shpirtërore e vetë myslimanëve, dembelizmi, dhe neglizhenca në lidhje me atë që po ndodhte përreth tyre, duke ua shtuar këtyre sulmeve që theksuam më lart, bënë që madhështia dhe epërsia e qytetërimit islam të fillojë të bjerë, derisa më në fund ai u shemb menjëherë pas Luftës së Parë Botërore. Fitoret ushtarake dhe një ndjenjë superioriteti, i kishte bërë myslimanët të flinin mbi dafina dhe të linin pas dore hulumtimet e mëtejshme shkencore. Ata braktisën veten e tyre për të jetuar jetën dhe e recitonin Kuranin pa e studiuar kuptimin e tij më në thellësi.

Ndërkohë, Perëndimi bëri përparime të mëdha shkencore dhe teknologjike. Këto ishin të huazuara nga qytetërimi islam.

Meqenëse shkenca është, në të vërtetë asgjë më shumë sesa njëra nga gjuhët e Librit Hyjnor të Krijimit dhe një nga aspektet e fesë, kushdo që nuk e studion këtë libër dhe nuk përfiton nga ai, është i humbur në këtë jetë. Një shpërfillje e tillë ka qenë një nga arsyet kryesore pse Evropa e pushtoi botën myslimane.

Qytetërimi modern materialist nuk mund të durojë edhe për shumë kohë, sepse ai është tejet materialist dhe i paaftë për të kënaqur nevojat tona shekullare. Sociologë perëndimorë të tillë si Oswald Spengler, kanë parashikuar rënien e tij, pasi ai është kundër natyrës themelore dhe vlerave të njeriut. Ose ai do ta lerë veten në rënien e tij të pashmangshme, ose do ta pajisë veten me besimin, vlerat morale dhe shpirtërore, si dhe parimet socio-ekonomike të Islamit. Me fjalë të tjera, myslimanët do të rizbulojnë se shkenca dhe feja, janë në thelb dy aspektet e të njëjtit realitet. Përsëri ata do të mësojnë se të qenët mysliman do të thotë, para së gjithash, përfaqësim i bukurive të Islamit në jetën praktike. Bota e ndritur e së ardhmes do të jetë e themeluar mbi themelet e forta të moralit islam, botës shpirtërore, si dhe parimeve të tjera të tij.

RASTËSIA DHE BOTËKUPTIMI KURANOR

Yamine Mermer

Gjithësia është ndërtuar ne formën e nje libri të kuptueshëm, në mënyrë që Autori i saj të mund të bëhet i njohur. Libri i drejtohet njerëzimit dhe u bën thirrje të gjithë njerëzve për ta lexuar atë dhe për t'iu përgjigjur me adhurim dhe falënderim Vullnetit të autorit të tij. Njerëzimi e arrin këtë nivel nëpërmjet zbulimit, studimit shkencor, rregullit të shfaqur në Librin e Gjithësisë, si dhe përmes mbarëvajtjes së punëve të banorëve të tij.

Gjithësia nuk është as pasive e as neutrale. Ne nuk mund ta interpretojmë atë sipas dëshirës, sepse nuk ekziston vetëm një mënyrë korrekte për ta parë atë, dhe një botëkuptim i përbashkët universal për gjithë njerëzimin. Krijuesi na e mëson këtë përmes Kuranit dhe librit të gjithësisë. Kjo nuk do të thotë se botëkuptimin kuranor bie në kundërshtim me idenë se perceptimi i botës ndryshon nga një person tek tjetri. Përkundrazi, ai lejon një shumëllojshmëri brenda unitetit, në mënyrë që të mundësohet një dialog universal. Ky botëkuptim nuk përmban në vetvete asnjë fragmentim ose konflikt, por vetëm harmoni, ndihmë, paqe dhe mëshirë.

Botëkuptimi shkencor materialist është i bazuar në fragmentimin radikal, për arsye se ithtarët e tij, e konsiderojnë natyrën një mekanizëm pa ndonjë vlerë dhe domethënie të qenësishme. Ai bën izolimin e një objekti duke vështirësuar lidhjet e tij me pjesën tjetër të botës, në mënyrë që ai të mund të studiohet brenda mjedisit të tij të aktual. Ai e bën këtë përkundër faktit se perceptimi ynë për veten, na tregon se ne jemi qenie kuptimplote dhe një pjesë e tërë universit, dhe se çdo gjë tjetër duhet të ketë një kuptim dhe të jetë pjesë e universit. Shkenca materialiste e ka lënë

mënjanë nga gjithësia subjektin njeri dhe, për sa kohë që mbizotëron kjo shkencë, njerëzit mendojnë se ata nuk kanë vend në këtë botë. Një pikëpamje e tillë i izolon njerëzit nga njëri-tjetri dhe ia privon kuptimin jetës së tyre, përveçse në një sens shumë të kufizuar egoist. Kështu njerëzit janë bërë të huaj për mjedisin përreth tyre dhe për vetveten.

Fizika moderne e ka shfaqur këtë pikëpamje mekaniciste të jetës nëpërmjet një përshkrimi inkoherent të natyrës. Zhvillimet në fizikën moderne, të cilat kanë shkatërruar të gjitha konceptet kryesore të fizikës klasike, bëjnë thirrje për një rishikim radikal të konceptit tonë të realitetit. Shumë koncepte të tilla, si natyra rastësore e fenomeneve fizike dhe idetë e një përshkrimi të natyrës objektive, ndryshuan me futjen e teorive të reja në shkencën moderne si, kuantika, relativiteti, dhe së fundmi, teoria e kaosit.

Megjithatë, këto ndryshime ndodhën vetëm në nivel matematikor dhe nuk janë verifikuar nëpërmjet ndryshimeve paralele në botëkuptimin e shkencës, për arsye se shkencëtarët janë të interesuar vetëm për zhvillimin e formulimeve matematikore për të shpjeguar dukuritë fizike. Një qëndrim i tillë nuk konsiderohet thjesht për avantazhet teknike që ofron, por përkundrazi, shumica e shkencëtarëve besojnë se parashikimet e këtij lloji janë objektivi përfundimtar i dijes dhe se koncepti ynë i realitetit është pak ose aspak i rëndësishëm. Megjithatë, është e qartë se koncepti ynë i realitetit ka një efekt të jashtëzakonshëm në mënyrën se si ne sillemi me natyrën dhe me njerëzit e tjerë, dhe gjithashtu mbi domethënien që ka jeta për ne si individë. Prandaj, ne nuk mund të na heqim qafe me një botëkuptim të stisur.

Ky qëndrim bashkëkohor shkencor në fakt bie në kundërshtim me shkencën moderne. Nga pikëpamja klasike, u pat menduar se shkenca mund të përshkruajë dhe shpjegojë çdo gjë në botë në mënyrë objektive (siç është në realitet) dhe se vëzhguesi (shkencëtari) mund ta përshkruajë botën i çliruar nga ndikimi i modeleve matematikore. Megjithatë, zbulimet në fizikën moderne e vënë theksin tek uniteti i të gjitha gjërave, një tërësi e papri-

shur që mohon fragmentimin klasik të botës në pjesë të ndara dhe të pavarura. Në teorinë kuantike, çdo grimcë është e lidhur, dhe nuk mund të izolohet nga pjesa tjetër e universit. Kjo njëqenësi e universit, i përfshin gjithashtu edhe qeniet njerëzore. Teoria kuantike, së bashku me zhvlerësimin e nocionit të objekteve krejtësisht të ndara, e ka zëvendësuar vëzhguesin neutral me pjesëmarrësin. Prandaj shkenca moderne ia rikthen njerëzimit vendin e tij qendror. Ajo i ka dhënë fund nocionit të një përshkrimi neutral dhe objektiv të natyrës, e për rrjedhojë edhe nocionin e shkencës së paanshme dhe objektive.

Deri më sot, shkenca materialiste ka qenë e bazuar mbi një pikëpamje deterministe rastësore të botës. Megjithëse teoritë më të fundit (p.sh., ajo kuantike dhe e kaosit) kanë shkuar drejt një botëkuptimi në të cilin nuk ka vend për fragmentim dhe determinizëm, shkencëtarët materialistë ende këmbëngulin në qasjet e fragmentuara dhe rastësore. Ata bëjnë kështu sepse, si besimtarë në rastësisë dhe si reduksionistë, janë të vetëdijshëm se botëkuptimi i tyre materialist po falimenton. Ata teorikisht e kuptojnë se për të shpjeguar se një gjë, duhet të dihen lidhjet e saj me të gjitha gjërat e tjera. Kjo është padyshim e pamundur, për shkak se këto lidhje zgjaten në kohë dhe në hapësirë përtej kapaciteteve njerëzore. Për më tepër, ato janë të pafundme dhe nuk mund të përqafohen nga të gjitha qeniet njerëzore, meqenëse qeniet njerëzore janë pjesë e këtyre lidhjeve.

Shkencëtarët materialistë e kuptojnë se e gjithë njëqenësia synon drejt një Krijuesi absolut, sepse gjërat që ne studiojmë nuk mbartin kuptime të kufizuara vetëm për veten e tyre, por për të dëshmuar absolutizmin e Krijuesit. Por ata këmbëngulin në mohimin e Krijuesit absolut në mënyrë që të pohojnë se studimet e tyre prodhojnë dituri. Dhe për shkak se metoda e tyre shkencore është e bazuar në shkakësinë dhe rastësinë, të cilat nuk mund të përputhen me një unicitet të tillë, ata e injorojnë atë dhe fragmentarizojnë universin në mënyrë që ata të mund të studiojnë çdo ndarje si produkt të një numri të kufizuar shkaqesh. Kjo u lejon

atyre të pretendojnë, se universi nuk ka Krijues dhe se kuptimi i tij është i kufizuar vetëm në atë që ata na tregonin rreth tij. Kështu, ata pretendojnë se shkenca e tyre është burim i diturisë.

Themelet konceptuale të fizikës moderne kanë qenë mjaft të diskutueshme. Modeli mekanik i realitetit nuk është i përshtatshëm për shkencën moderne. Shkencëtarët e kanë shmangur këtë çështje duke adoptuar qëndrimin se paradokset dhe kontradiktat e gjetura në shkencën e tyre janë diçka normale në natyrë, duke nënkuptuar se ato paradokse dhe kontradikta nuk kanë fare të bëjnë me botëkuptimin e tyre të pamjaftueshëm.

Por si mund të zbatohet një arsyetim reduksionist shkencor në lidhje me universin e pandashëm? Shkencëtarët dhe filozofët e kanë diskutuar këtë çështje në detaje, por nuk duket se e kanë kuptuar ende natyrën e kësaj qasjeje materialiste sipas të cilës arsyetimi shkencor është i papajtueshëm me unitetin e gjithësisë. Prandaj, ose qasja e arsyetimit shkencor ose koncepti i unitetit të universit, njëri prej tyre duhet të rikonsiderohet.

Askush nuk e kundërshton faktin se gjithësia është një tërësi e pandashme. Në të vërtetë, pamja e unitetit brenda saj dhe brenda njerëzimit është aq e qartë sa kjo nuk mund të mohohet. Prandaj qasja materialiste e kërkimit shkencor duhet të rikonsiderohet. Kjo metodë e ndan çdo gjë në fragmente dhe pastaj ia atribuon krijimin e çdo fragmenti shkaqeve, edhe pse të gjitha gjërat janë të ndërlidhura dhe të ndërvarura. Për këtë arsye, asgjë nuk mund t'i atribuohet shkaqeve, pavarësisht nga madhësia, për arsye se shkaqet janë vetë rastësore dhe jo sistematike. Meqë çdo gjë që është përgjegjëse për diçka, duhet të jetë përgjegjëse për të gjitha gjërat, ne nuk mund të kemi një veçanti pa tërësi.

Përse mund ta përshkruash një gjë sipas paraardhësve të tij në kohë, por jo në lidhje me fqinjët e saj në hapësirë? Pse duhet që një gjë të jetë në gjendje për të prodhuar një tjetër gjë, vetëm për shkak se kjo ka ndodhur më parë? Shkencëtarët modernë e dinë se hapësira dhe koha janë plotësisht të njëjta dhe të unifikuara në një hapësirë katër-dimensionale, në të cilën këtu dhe atje, si për-

para ashtu edhe më pas, të gjitha këto koncepte janë relative. Në këtë hapësirë katër-dimensionale, sekuenca kohore mblidhet në një bashkëekzistencë të njëkohshme, krah për krah ekzistencës së të gjitha gjërave. Kështu, shkakësia duket të jetë një ide e kufizuar në një përvojë paragjykuese të botës.

Shkakësia çon në zinxhirin vicioz të shkakut dhe pasojës, sepse për çdo shkak ekziston gjithashtu një pasojë. Gjithashtu, pasoja është krejtësisht e ndryshme nga shkaku. Gjërat dhe pasojat janë zakonisht aq me sens e artistik dhe me qëllime të dobishme, saqë le shkaqet akute dhe të rëndomta, por edhe në qoftë se të gjitha shkaqet mblidhen bashkë, nuk mund të prodhojnë as edhe një gjë të vetme.

Me pak fjalë, në mënyrë që një shkak të prodhojë një pasojë, ai duhet të jetë në gjendje të prodhojë të gjithë universin në të cilin kjo pasojë ndodh, për arsye se një pasojë e tillë, nuk mund të ekzistojë pa tërë universin. Ato nuk mund të ekzistojë veçmas. Shkakësia është prandaj antiteza e pohimit "Nuk ka zot tjetër veç Allahut," thelbit të botëkuptimit kuranor. Shkencëtarët materialistë imagjinojnë pafuqinë, varësinë, dhe injorancën e shkaqeve, si përgjegjëse për ekzistencën e qenieve dhe objekteve, dhe kështu ata imagjinojnë se ato posedojnë cilësitë absolute. Në këtë mënyrë, ato nënkuptojnë (dhe heshturazi besojnë) se secili shkak posedon cilësi, të cilat mund t'i atribuohen vetëm Allahut.

Mirëpo, zbulimet më të fundit të shkencës moderne, krahas unitetit të universit dhe pandashmërisë së pjesëve të tij, e përjashtojnë mundësinë e të gjitha këtyre shpjegimeve materialiste. Ata tregojnë se të gjitha subjektet, qoftë në natyrë apo në ligjet dhe shkaqet që u atribuohen atyre, janë të çliruara prej fuqisë dhe dijes, sepse ata janë kontigjent i rastit, dhe të varur. Por vetitë e atribuara ndonjë entiteti të tillë, duhet të përfshijnë cilësitë të tilla si pushteti absolut dhe dituria e pafund.

Kjo tregon se shkakësia nuk është aspak domosdoshmërisht e lidhur me studimin objektiv ose hetimin neutral shkencor. Ajo nuk është më shumë sesa një mendim irracional dhe joshqisor

personal. Megjithatë, ende ekziston një bindje e përhapur se shkenca mund të bëjë pa një Krijues. Ndërsa duket të jetë e mundur në fizikën klasike, kjo është një ide e pabazë në mekanikën kuantike. Fizika është plot me shembuj të zgjuarsisë dhe finesës, të cilët e përjashtojnë interpretimin shkakësor dhe na bëjnë të njohur një Krijues të Plotfuqishëm, të Gjithëdijshëm. Vetëm ca ilustrime, unë shpresoj se do të mjaftojnë për të na bindur se universi dhe e gjithë përmbajtja e tij janë produktet e Allahut.

Ideja se gjithësia filloi me një "Big Bang" është mjaft paradoksale. Prej katër forcave të natyrës, vetëm graviteti vepron sistematikisht në një shkallë kozmike, dhe graviteti në përvojën tonë është i natyrës tërheqëse, pra një forcë tërheqëse. Por shpërthimi shënon krijimin e gjithësisë dhe kërkohet një forcë të fuqishme shtytëse për ta vendosur atë në rrugën e saj të zgjerimit. Është e çuditshme ideja se universi në zgjerim është i dominuar nga forca e gravitetit, e cila është forcë përmbledhëse dhe jo zgjeruese. Matje të sakta kanë treguar se shkalla e zgjerimit ka qenë "llogaritur dhe graduar në mënyrë tejet të imtësishme," për të ecur në këtë rrugë të ngushtë midis dy katastrofave: sikur kjo shkallë të ishte paksa më e vogël, kozmosi do të pësonte një kolaps, nga ana tjetër, nëse kjo shkallë të ishte paksa më e madhe, lënda kozmike do të ishte shpërndarë krejtësisht, kohë më parë.

Shkencëtarët materialistë e shohin mjaft mirë se një shpërthim i tillë, po të llogaritet saktësisht, kërkon një fuqi dhe dije të pafund, dhe prapseprapë, përsëri e mohojnë aktin e krijimit. Prandaj ata janë të detyruar të thonë: "Kjo thjesht ka ndodhur, ajo duhet të pranohet si një kusht i veçantë fillestar." Kushti fillestar, megjithatë, duhej të jetë me të vërtetë shumë i veçantë. Dhe shkalla e zgjerimit është vetëm një prej mrekullive të panumërta kozmike. Por të zhytur në devijimin e tyre, ata i imagjinojnë këto mrekulli të Fuqisë Absolute si rastësi të "veçanta", duke nënkuptuar se krijimi i gjithësisë ka qenë një aksident i rastit. Me pak fjalë, teoria më themelore e shkencës moderne të kohëve të fundit është plotësisht në përputhje me konceptin e një Krijuesi Absolut, por jo me atë

të rastësisë (shkakësisë). Kështu, nevoja për Zotin, Krijuesin e shkaqeve, e fut shkencën në një rrugë të drejtë.

Nga pikëpamja klasike, besohet se një matje e kryer në një vend nuk mund të ndikojë menjëherë mbi një grimcë në një vend tjetër shumë të largët. Kjo është bazuar në supozimin se bashkëveprimet midis sistemeve tentojnë të zvogëlohen me rritjen e distancës, pasi teoria e shkakësisë, supozon se një shkak duhet të ndodhet në afërsi të pasojës së tij. Përndryshe si mundet që dy grimca disa metra - e lëre pastaj vite-dritë larg – të ndikojnë në pozicionin dhe lëvizjen e njëri-tjetrit?

Në të kundërt, mekanika kuantike parashikon një shkallë më të madhe të bashkëveprimit, sikur dy grimcat bashkëpunojnë me telepati. Kjo na detyron të pyesim: Si mundet që kjo shkallë e theksuar e bashkëpunimit mes pjesëve të ndryshme të universit që kurrë nuk kanë qenë në komunikim me njëri-tjetrin, të shpjegohet pa përmendur Krijuesin e tyre? Si mund t'ia arrijnë ato kësaj mrekullie? Uniciteti Hyjnor është padyshim shpjegimi i vetëm i arsyeshëm, konsistent dhe i pranueshëm, deri në pikën e të qenit i nevojshëm, i kësaj mrekullie dhe në të vërtetë, edhe i universit, përmbajtjes së tij dhe njerëzimit.

Materialistët bien me këmbët e tyre në një vorbull paradoksi në këtë pikë, për arsye se shkakësia nuk mund ta shpjegojë një bashkëveprim të tillë. Por për besimtarët, ky aspekt i mrekullueshëm i Unicitetit të tij, parashikon një koherencë universale dhe synon drejt të gjitha parimeve gjithpërfshirëse që shtrihen përgjatë kozmosit.

Kur ne këpusim zinxhirin vicioz të shkakut dhe pasojës, bota e pakuptimtë e materializmit, i hap rrugën një bote të ndriçuar prej kuptimit dhe qëllimit. Universi bëhet si një libër i gjerë që i drejtohet njerëzimit dhe nëpërmjet bërjes të njohur të Autorit të tij, në mënyrë që lexuesit të mund të marrin mësim, të rrisin vazhdimisht shkallën e njohjes së Krijuesit të tyre, dhe të forcojnë besimin dhe sigurinë në bazat e fesë.

Me pak fjalë, çdo gjë e krijuar është plot art dhe po rinovohet vazhdimisht, dhe të dyja si shkaku i çdo gjëje ashtu dhe pasojat e saj, janë të krijuara. Në mënyrë që të ekzistojë, çdo gjë duhet të posedojë Fuqinë dhe Diturinë e pafund. Në këtë mënyrë, patjetër duhet të ekzistojë një Posedues i Pushtetit Absolut dhe i Gjithedijshëm, i Cili të krijojë menjëherë shkakun dhe pasojën, të cilat të marra së bashku demonstrojnë atributet e Krijuesit të tyre. Ato shpallin Fuqinë dhe Përsosmërinë Hyjnore përmes pafuqisë dhe mangësisë së tyre, dhe thonë: "Nuk ka zot tjetër përveç Allahut."

Ashtu siç ekzistenca e universit synon drejt kësaj të vërtete të Unicitetit Hyjnor, edhe Pronari i universit na e mëson këtë të vërtetë nëpër librat e Tij të Shenjtë të shpallura nëpërmjet profetëve.[1] Fraza "Nuk ka zot tjetër përveç Allahut," përbën Shpalljen themelore dhe është konfirmuar nga dëshmia e qenieve. Ajo është çelësi që të çon për tek Kurani, një çelës që bën të mundur për të kuptuar enigmën e krijimit të universit, enigmë kjo e cila ka reduktuar shkencën dhe filozofinë materialiste në diçka të pafuqishme dhe të padobishme. Rruga e Unicitetit është rruga e Shpalljes. Vetëm kjo rrugë i tregon njerëzimit Mjeshtrin dhe Pronarin e tij dhe na bën të njohim objektin tonë të vërtetë të adhurimit, i Cili posedon një pushtet absolut nëpërmjet të cilit do të përmbushë të gjitha nevojat tona.

Kurani është burimi i vetëm që na mëson se gjithësia dhe banorët e tij nuk mbartin në vetvete një kuptim të kufizuar për veten e tyre, por dëshmojnë për Unicitetin e Krijuesit. Ai na mëson se çfarë është universi dhe se çfarë detyrash ai është duke kryer. Kjo është arsyeja përse myslimanët duhet ta studiojnë universin dhe të vërejnë që të gjitha krijesat, përmes rregullit, bashkëveprimit të ndërsjelltë dhe detyrave, i refuzojnë pretendimet false të materialistëve dhe ateistëve, duke pranuar se ato nuk janë asgjë tjetër përveçse prona dhe krijesa të një Zoti të Vetëm. Secila është një dëshmi se Krijuesi nuk ka partnerë. Në të vërtetë, kur Uniciteti i Krijuesit njihet dhe kuptohet saktë, bëhet e qartë se nuk ka asnjë arsye përse shkaqet duhet të posedojnë ndonjë

fuqi. Prandaj është e pamundur për ta që të jenë partnerë të Krijuesit. Kjo i shtyn shkencëtarët myslimanë të shprehn përmes studimeve dhe zbulimeve të tyre: "Nuk ka zot tjetër përveç Allahut, të Vetëm dhe pashoq."

Universi është një dokument që do të lexohet nga besimtarët. Besimi në Zot është, siç na informon Kurani, miratimi me gjithë thellësinë e zemrës së njeriut, i Krijuesit me të gjitha atributet e Tij mbështetur nga dëshmia e universit. Afirmimi i vërtetë i Unicitetit të Allahut, është një gjykim, një pohim, një miratim dhe pranimi se si mund të gjendet aktualisht Pronari i të gjitha sendeve. Ai sheh në të gjitha gjërat një shteg që çon drejt pronarit të tij, dhe nuk merr parasysh asnjë pengesë për praninë e Tij. Nëse nuk do të ishte kështu, do të bëhej e nevojshme për ta shkatërruar dhe hedhur tej, universin në mënyrë që të gjenim Atë, dhe kjo është e pamundur për ne.

Universi nuk është pronë e shkencës materialiste, e cila ka përdorur universin në një mënyrë destruktive, pikërisht për shkak se ajo nuk ka qenë në gjendje ta zbulojë kuptimin e tij. Nuk ka asnjë ndarje në mes shkencës së vërtetë dhe Zbulesës. Përkundrazi, progresi i vërtetë njerëzor dhe lumturia mund të arrihen vetëm me anë të rrugës së Kuranit. Të gjitha përparimet teknologjike dhe shkencore, janë thjesht zbulim i mënyrës se si është krijuar universi. Kur universi shihet të jetë një libër i gjerë dhe kuptimplotë i unifikuar, që përshkruan Autorin e vet dhe banorët e tij si shenja të Krijuesit të tyre, të gjitha këto zbulime dhe përparime, e përforcojnë më tej besimin në vend që të shkaktojnë dyshim dhe çoroditje.

Sëmundja më serioze që ka prekur në këto kohë njerëzimin në kërkimin tonë të lumturisë dhe të gjetjes së kuptimit të jetës, është të konsideruarit e shkencës dhe të studiuarit e botës së krijuar, si diçka të ndarë dhe të papajtueshme me Shpalljen Hyjnore, Botën e Krijuesit. Por ndërsa mësojmë ta mbajmë parasysh universin në shqisat tona, dhe jo idetë e shkencëtarëve materialistë, do të vërejmë kontradiktat e arsyetimeve të tyre shkencore. Gjitjmonë

e më tepër njerëzit po fillojnë të kuptojnë se arsyetimi materialist shkencor, nuk është më i vlefshëm. Të vëna përballë bukurisë, madhështisë dhe arsyes, përpjekjet për t'a shpjeguar krijimin me argumentin e rastësisë, po bëhen gjithnjë e më tepër të pabazuara. Pasi të kenë arritur në këtë pikë, ata do t'a ndiejnë nevojën dhe rëndësinë e shkencës dhe dijes së vërtetë, e cila ushqen dhe lulëzon besimin në Zot.

ÇFARË DOMETHENIEJE KA GURI QË BIE NGA LART?

Salih Atkin

Ligjet e fizikës janë shprehje matematike në lidhje me mënyrën se si funksionon universi. Ngjarjet që ndodhin në univers, ashtu si edhe lidhjet ndërmjet tyre dhe ligjet që "qeverisin" universin, kanë tërhequr vëmendjen e njerëzve që nga kohët e lashta.

Shkencëtarët janë përpjekur të shpjegojnë çdo gjë që ndodh në univers, të tilla si lëvizjet e objekteve qiellore, baticat dhe lundrimin e anijeve në ujë. Megjithatë, sipas mendimtarëve antikë grekë, shkencëtarët duhej të përqëndrohshin më shumë në njerëzimin sesa në botën natyrore. Ata besonin se fenomenet natyrore dhe ligjet që i qeverisin ato, mund të shpjegohen me anë të operacioneve të tilla mendore si deduksioni dhe arsyetimi analogjik.

Kurani tërheq vëmendjen e njerëzve për manifestimet hyjnore tek krijesat (p.sh., mjalti, milingonat, mushkonjat dhe merimangat) dhe i fton njerëzit për të reflektuar dhe studiuar fenomene të tilla si lëvizjen e ajrit, ndërrimin e ditës e të natës dhe stinët, si dhe lëvizjet e trupave qiellorë. Rëndësia që i është dhënë nga Kurani studimit të dukurive natyrore, i ka frymëzuar shkencëtarët myslimanë për t'u marrë me vëzhgim dhe eksperimentim, shumë kohë përpara se këto metoda të hynin në përdorim në Evropë.

Shkenca hyri në Evropë nëpërmjet kryqtarëve, universiteteve në Andaluzi (Spanja myslimane) dhe Siçilisë, e po kështu nëpërmjet përkthimeve nga tekstet arabe. Shkenca ishte faktori kryesor që nxiti Rilindjen Evropiane. E ndërtuar (por asnjëherë e pranuar haptazi) mbi punën dhe kontributin e shkencëtarëve myslimanë, shkenca evropiane përgatiti terrenin për lindjen e shkencës

moderne. Deri në momentin kur u arritën konkluzione të sakta nëpërmjet vëzhgimit dhe eksperimentimit në lidhje me dukuritë natyrore, pohimet e filozofëve grekë të lashtësisë, ishin të pranuara gjerësisht si ligje bazë të natyrës. Për shembull, që nga koha e Aristotelit njerëzit kishin besuar se shpejtësia e një objekti që bie, është në përpjesëtim të drejtë me masën e tij. Megjithatë, Galileu dhe Njutoni kryen eksperimente me anë të të cilave dëshmuan se kjo bindje ishte e rreme. Ata zbuluan se për aq kohë sa rezistenca e ajrit është e papërfillshme në krahasim me peshën e objektit dhe sipërfaqen e prerjes tërthore, lëvizja e papenguar e një objekti në Tokë nuk varet nga masa e tij. Me fjalë të tjera, objekte të lëshuara nga e njëjta lartësi dhe që kanë masë të ndryshme, arrijnë në të njëjtën kohë në Tokë.

Këto zhvillime në fizikë, i shtynë shkencëtarët t'i miratojnë metodat e vëzhgimit dhe eksperimentimit, si rregulla themelore në përcaktimin e fakteve natyrore. Shkencëtarët kishin për detyrë zbulimin e ligjeve dhe të vërtetave themelore të përhapura në univers, nëpërmjet këtyre dy metodave empirike, ndërsa filozofët duhej të reflektonin dhe të bënin komente në lidhje me to. Me fjalë të tjera, arritja në konkluzione të vërteta rreth universit dhe ngjarjeve që ndodhin në të, do të thotë shkarkim dhe flakje tutje të të gjitha paragjykimeve, duke studiuar natyrën përmes metodave empirike, dhe pastaj duke bërë komente në lidhje me dukuritë natyrore dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre.

Për të pasur një kuptim të qartë të shkencës moderne dhe asaj çfarë mund të na thotë ajo në lidhje me universin, shqyrtojmë ligjin e gravitetit të përgjithshëm, një fakt i pamohueshëm shkencor, i vërtetuar tashmë. Vëzhgimet dhe eksperimentet e ndryshme, kanë treguar se çdo dy objekte tërheqin njëri-tjetrin ose ushtrojnë forcë mbi njëri-tjetrin në përpjesëtim të drejtë me masat e tyre dhe në përpjesëtim të zhdrejtë me katrorin e distancës midis tyre.

Forca e tërheqjes (graviteti) është forca vepruese në ngjarje të tilla si në një objekt në rënie, apo tek që Toka sillet rreth diellit. Shkenca e paraqet gravitetin sikur ai të ishte shkaku i ngjarjeve

të tilla. Megjithatë, ajo që ne e quajmë forca gravitacionale është vetëm një nocion që ne përdorim për të shpjeguar të tilla ngjarje. Me këtë ne duam të themi se ekziston një tërheqje e vëzhguar në mes objekteve, dhe ne përpiqemi për t'a shpjeguar atë, duke i dhënë një emër të veçantë, të tillë si ligji apo forca e gravitetit, dhe pastaj mendojmë se e kemi shpjeguar dukurinë e tërheqjes së gjithësishme.

Shkenca nuk e njeh natyrën e kësaj force. Por, duke filluar nga pohimi se shkencëtarët kanë shpjeguar shumë ngjarje, shkaqet e të cilave ishin të panjohura në të kaluarën, shkenca pohon se ajo të cilën nuk është në gjendje ta shpjegojë tani, do të bëhet në njëfarë mënyre, e shpjegueshme në të ardhmen. Megjithatë, shkenca nuk mund të shpjegojë shkakun e vërtetë të të gjitha ngjarjeve në univers. E gjithë ajo çfarë shkenca mund të bëjë është, që duke u nisur nga ripërsëritja e një ngjarjeje në të njëjtat kushte, të bëjë një përgjithësim dhe ta quajë atë një ligj. Ajo pastaj pohon se e njëjta ngjarje do të ndodhë përsëri në të ardhmen në të njëjtat kushte. Për shembull, pasi vëren dukurinë e rënies së objekteve të hedhura në ajër, ajo bën një përgjithësim, ku shprehet se të gjitha objektet e hedhura në ajër, do të bien dhe e shpreh këtë dukuri të rënies me anë të një formule matematikore.

Le të marrim në konsideratë mënyrën se si shkenca vepron për të llogaritur dhe për të deklaruar paraprakisht intervalin e kohës që do t'i duhet një objekti të hedhur në ajër me një forcë të caktuar dhe në një kënd të caktuar me horizontin, të bjerë në tokë, dhe në çfarë distance nga pika e nisjes ai do të bjerë. Meqenëse ngjarjet ndodhin sipas një serie shkak-pasojash, duke ditur se çfarë pasoje apo ngjarjeje do të ndodhë në hapin e ardhshëm, nuk kërkohet një arsye pse kjo ngjarje ndodh në këtë mënyrë. Prandaj, edhe pse ne supozojmë se ligji i gravitetit do të kuptohet si të themi, në varësi të një shkëmbimi ndërmjet grimcave të caktuara apo përkuljes së kohës hapësinore, metodat shkencore do të jenë në gjendje të shpjegojnë se përse një shkëmbim i tillë ndodh, pse koha hapësinore bëhet e zhdrejtë, ose pse shkëmbimi apo përkulja ndodh sipas formulimeve të caktuara matematikore, që i bëjnë objektet të tërheqin njëri-tjetrin.

Përveç faktit se arsyeja për këtë tërheqje mbetet e panjohur, përbën gjithashtu një mister (dhe një çudi!) fakti që një tërheqje e tillë zhvillohet sipas një formule matematikore. Për shkak të familjaritetit tonë me ngjarjet që ndodhin në natyrë, ne e injorojmë faktin e rëndësishëm se çdo gjë dhe ngjarje që ndodh në natyrë është një mrekulli. Në mënyrë që të shohim pse dukuria e gravitetit është një mrekulli e mahnitshme, ne duhet ta shqyrtojmë atë më nga afër:

Shqyrtojmë rënien e lirë të një guri (i cili lihet i lirë të bjerë i papenguar) nga një pikë e lartë e caktuar. Supozojmë se guri do të përshkojë një trajektore të caktuar si pasojë e gravitetit që ndikon mbi të. Ai do të lëvizë gjithmonë e më shpejt deri sa më në fund të godasë tokën. Meqenëse guri do të përshpejtohet, koha që do t'i duhet atij për të mbërritur në tokë, dhe mënyra se si ai do të lëvizë në çdo sekondë në trajektoren e tij, varet nga distanca e gurit nga qendra e Tokës, nga masa e Tokës, dhe nga konstantja e gravitetit. Kështu guri nuk lëviz në mënyrë të rastësishme, përkundrazi, çdo lëvizje gjatë rënies së tij është e llogaritshme nga formulat matematikore. Kjo është një lëvizje jashtëzakonisht e rregullt.

Nga kjo, ne arrijmë në mënyrë të pashmangshme në përfundimin se në qoftë se guri e bën vetvetiu këtë lëvizje të rënies së lirë, pa një agjent drejtues ose përcaktues të trajektores së tij, guri vetë duhet të njohë saktësisht konstanten e gravitacionit, masën e Tokës, distancën e tij nga qendra e Tokës në çdo moment të trajektores së tij) dhe pastaj të lëvizë në përputhje me ato fakte të njohura. Asnjë person i arsyeshëm, nuk do të mund të shprehej se guri mund ta përcaktojë vetë trajektoren e tij, e cila është e thjeshtë në dukje, por jashtëzakonisht e ndërlikuar në realitet.

Në të vërtetë, rënia e një guri është një lëvizje mjaft komplekse, meqënëse gjatë kësaj rënieje, të gjitha objektet në gjithësi, çdo masë, ushtron një forcë të caktuar të tërheqjes mbi të. Kështu guri lëviz nën ndikimin e këtyre forcave.[1] Kjo sepse në mënyrë që të përcaktojë trajektoren e tij, guri duhet të njohë distancën e saktë në mes tij dhe secilës prej rreth 1080 grimcave në univers, të llogarisë

me saktësi në çdo moment të trajektores së tij, forcën e tërheqjes të ushtruar mbi të nga çdo grimcë sipas formulës matematikore të gravitetit, një forcë që ndryshon çdo moment, dhe t'i përqëndrojë të gjitha ato forca në një pikë të vetme, duke marrë parasysh drejtimin e secilës.

Le një gur i vetëm, por as edhe kompjuteri më i avancuar dhe më i madh i imagjinueshëm, nuk mund ta realizojë këtë, për arsye se pozicioni i çdo grimce, në lidhje me gurin, ndryshon në çdo moment gjatë rënies së tij. Kështu, edhe lëvizja më e thjeshtë e dukshme në univers, rënia e një guri, kërkon një njohuri të plotë dhe zotërim të një numri të pafund procesesh të ndërlidhura.

Meqenëse çdo ngjarje që ndodh në ndonjë pjesë të universit, është e lidhur me të gjitha grimcat e universit dhe me vetë atë, vetëm dikush që zotëron dije të përsosur dhe që arrin të shohë çdo grimcë të universit, mund ta përcaktojë dhe ta drejtojë të gjithë lëvizjen e kryer në të. Gjithashtu, meqenëse ligji i gravitetit dhe të gjitha ligjet e tjera fizike janë të njëjta dhe të njëtrajtshme në të gjithë universin, kushdo që i bën këto ligje funksionale, duhet të jetë një qenie e fuqishme, e cila dominon absolutisht çdo gjë aty. Përndryshe, çdo atom në univers duhet të ketë sy me të cilat sheh të gjithë universin në të njëjtën kohë dhe e di vendndodhjen, masën, ngarkesën elektrike, me pak fjalë, të gjitha karakteristikat fizike të çdo grimce në gjithësi, të jetë i vetëdijshëm për të gjitha ligjet fizike, dhe t'i bindet ligjeve që Ai ka krijuar.

Çdo ngjarje dhe objekt në univers është e ndërlidhur me njëratjetrën, dhe çdo gjë që ndodh aty, ndodh sipas ligjeve të caktuara. Prandaj, është e pamundur edhe për ngjarjen më të vogël dhe ngjarjen në dukje më të parëndësishme, për të zënë vendin në mungesë, të dikujt që zotëron një njohuri të përsosur absolute rreth universit dhe të gjithë grimcave të tij, duke pasur një pushtet absolut në qeverisjen e tij. Said Nursi[2] e shpreh këtë fakt si më poshtë:

> Nëse ekzistenca dhe funksionimi i universit nuk i atribuohet Zotit të Plotfuqishëm, atëherë duhet pranuar se çdo grimcë ka atributet e Qenies Detyrimisht Ekzistente, dhe se çdo grimcë duhet edhe të dominojë

> edhe të jetë e dominuar nga të gjitha grimcat e tjera. Përsëri, çdo grimcë duhet të ketë një vullnet dhe njohuri gjithpërfshirëse, për arsye se ekzistencën e një gjëje të vetme është e varur nga të gjitha gjërat e tjera dhe ai i cili nuk e sundon universin, nuk mund të sundojë as edhe një grimcë të vetme.

Pasi shpjeguam se sa i ndërlikuar është fenomenin i gravitetit, ne mund të shkojmë pak më tej për të parë shkakun e tij real. Lidhja në mes të rënies së një guri dhe rrotullimit të hënës rreth Tokës në një orbitë të caktuar, e nxiti Njutonin për të zbuluar ligjin e gravitetit. Meqë ky ligj u mirëprit gjerësisht, shkaku i rënies poshtë të një objekti të hedhur në ajër, ka qenë pranuar pa dyshim se është gravitetiti. Megjithatë, nuk është e nevojshme që shkaku i vërtetë i kësaj lëvizjeje të jetë forca tërheqëse e Tokës ose ekzistenca një tjetër shkaku material.

Mendoni pak për këtë shembull: Dy qenie të gjalla jetojnë në një tryezë dy-dimensionale. Ata janë të dijeni vetëm të kësaj tryeze dhe për rrjedhojë, plotësisht jo në dijeni të botës tre-dimensionale përreth tyre. Dikush nga bota tre-dimensionale hedh sende në tryezë, në frekuenca të barabarta dhe bën që të hapen vrima në distanca të barabarta nga njëra-tjetra. Duke vërejtur këtë dukuri, këto qenie të gjalla në mënyrë të pashmangshme do të arrijnë në përfundimin se secila vrimë është ajo që shkakton hapjen e një vrime tjetër, kur në realitet shkaktari i këtyre vrimave ndodhet përtej perceptimit të botës së tyre.

Shkencëtarët, të cilët ia atribuojnë çdo gjë dhe ngjarje në univers ligjit të shkakësisë, mendojnë se universi punon si vijon: Është e diskutueshme nëse tërheqja e një objekti drejt një tjetri pranë tij (p.sh., tërheqja e një guri që bie drejt tokës) ndodh për shkak të vetë objekteve ose për shkak të ndonjë burimi tjetër, që i detyron objektet për të kryer një lëvizjeje të tillë.[3]

Me pak fjalë, një objekt që lëviz në përputhje me ligjin e gravitetit ka secilën prej lëvizjeve të tij të përshkruar matematikisht, si dhe kërkon që edhe masa apo distanca midis grimcave në univers, por edhe masa dhe distancat midis tyre të jetë të njohura në mënyrë të ndërsjellë, në këtë marrëdhënie të ndërlikuar. Kështu,

padyshim që duhet të ekzistojë Ai i Cili është i Gjithëdijshëm. Ai gjithashtu duhet të zotërojë një vullnet absolut për të zgjedhur dhe për të përcaktuar për çdo rast një ligj nga ligjet e panumërta që ekzistojnë. Uniformiteti i ligjeve, që do të thotë të gjitha ligjet që mbizotërojnë në mbarë universin, bën thirrje për unicitetin e të Gjithëdijshmit dhe të të Gjithëvullnetshmit. Bindja e të gjitha gjërave, pavarësisht nga madhësia, ndaj këtyre ligjeve, tregon se Ai është edhe i Plotfuqishëm. Përsëri, mosndryshimi apo stabiliteti i ligjeve dhe madhështia e gjithësisë, por edhe rregulli dhe harmonia e pandryshueshme, tregojnë se Ai është Vetëekzistues dhe i Vetëmjaftueshëm.

Duke pasur parasysh këtë, themi se ky i Gjithëdijshëm, i Gjithëvullnetshëm, i Plotfuqishëm, Vetëekzistues e i Përjetshëm, dhe Unik, bën që një gur të bjerë, sepse vetëm një qenie e tillë ka njohuri absolute, vullnet, dhe fuqi të nevojshme për ta bërë një gur të bjerë. Çdo send dhe ngjarje në univers është aq ndërlikueshëm i mrekullueshëm, sa asnjë shkak material nuk mund ta bëjë të ndodhë vetvetiu. Si rezultat i kësaj të vërtete, rruga e vetme e hapur ndaj njerëzimit, është të njohë Ekzistencën dhe Unicitetin e Allahut.

UNIVERSI NËN DRITËN E FIZIKËS MODERNE

Salih Adem

Sipas Ajnshtajnit, "aspekti më pak i kuptuar i universit, është të qenët e tij i kuptueshëm." Këto fjalë, synojnë të grisin perden e zakoneve të zhvilluara në mendjen tonë nga të mosshikuarit brenda arsyes së gjërave. Përsosmëria e rregullit të universit është e një shkallë të tillë, sa ne nuk e vrasim mendjen fare për këtë, ashtu siç kujtohemi për defektet e orës sonë të dorës, vetëm kur ajo ndalon së punuari.

Në këndvështrimin e bazuar në ligjet e Njutonit, universi krahasohet me një orë që punon gjithmonë njësoj. Ngjarjet ishin të lidhura me njëra-tjetrën në një marrëdhënie shkak-pasojë, dhe dijet tona rreth ligjeve të kësaj marrëdhënieje na mundësuan t'i parashikojmë ngjarjet me saktësi të madhe. Ne mund të përcaktojmë me saktësi matematikore një gamë të gjerë fenomenesh, që nga kohët e eklipseve diellore dhe hënore, e deri në sasinë e karburantit dhe shpejtësinë e nevojshme për të nisur një objekt në orbitën rreth Tokës. Suksesi i këtyre "ligjeve natyrorore" i bëri shumë njerëz të besonin se ato manifestonin dhe drejtonin krejtësisht rregullin e të gjithë universit.

Besimi ynë se shkaqet janë përgjegjëse për (ose krijojnë) pasojat, është i bazuar në dy faktorë: Zoti i krijon dhe i mbështet të gjitha gjërat dhe ngjarjet që nga prapa perdes së ligjeve të përgjithshme universale, dhe disa ngjarje (shkaqe) të caktuara, pasohen në mënyrë të besueshme nga ngjarje të ngjashme (pasoja), sa herë që ato (shkaqet) ndodhin. Por kjo është e gabuar. Asnjë numër shkaqesh nuk mund të krijojë qoftë edhe një pasojë sado të vogël, sepse çdo ngjarje, qoftë edhe ajo më

e vogla dhe e parëndësishmja, presupozon ekzistencën e universit, duke përfshirë edhe ligjet vepruese brenda tij. Çast pas çasti, të gjitha gjërat dhe ngjarjet krijohen dhe mbështeten nga Allahu, i Cili dëshiron një aktualitet të veçantë nga një mori e pafundme mundësish alternative.

Modeli i kurdisjes së universit që rrjedhin nga fizika njutoniane (klasike), nuk arrin të bëjë një llogari të plotë të fenomeneve që vërejmë në univers. Diku aty nga fundi i shekullit të nëntëmbëdhjetë, shkencëtarët mbetën të befasuar nga rrezet që u përkulën dhe nga spektrat e dritës të emetuara nga gazet e nxehta, për arsye se shpërndarja e qëndrueshme, stabël, dhe madje edhe e parashikuar nga modeli njutonian, nuk ndodhi. Gjithashtu, ka pasur probleme në shpjegimin e sjelljes së dritës: Ndonjëherë ka më shumë kuptim që ajo të konsiderohet si një tufë grimcash, ndonjëherë si një valë.

Sot ne kemi një kuptim shumë të ndryshëm të universit. Ndryshimi i këtij kuptimi, nisi në vitin 1900 kur Planku[1] publikoi punimin e tij në lidhje me rrezatimin. Planku punoi plot 6 vjet për të arritur të kuptonte përse rrezatimi i matur në trupat e nxehtë, nuk korrespondonte me vlerat e parashikuara nga teoria klasike. Ai sugjeroi se trupat që rrezatojnë energji, e bëjnë këtë me porcione të quajtura kuante dhe jo në mënyrë të vazhdueshme, ndryshe nga teoria klasike që mbështeste idenë se ky rrezatim ndodhte në mënyrë të vazhdueshme. Kaq befasues ishte ky sugjerim, sa vetë Planku, pavarësisht konfirmimit nga eksperimenti, mendonte se ai e kishte zgjidhur këtë problem fare rastësisht, nëpërmjet një lloj truku.

Në vitin 1905, Ajnshtajni[2] botoi një artikull në të cilin përdorte konceptin e paketave me madhësi të përcaktuar të energjisë, për të shpjeguar se si devijoheshin elektronet nga metali kur goditen nga drita (rrezatimi). Fizika klasike parashikonte se tensioni (sasia e energjisë së elektroneve të devijuara) ishte në përpjesëtim të drejtë me intensitetin e dritës (rrezatimit). Megjithatë, Ajnshtajni shpjegoi se tensioni ishte në përpjesë-

tim të drejtë me frekuencën e rrezatimin, e jo me intensitetin e tij. Përputhja e këtij shpjegimi me të dhënat eksperimentale, solli si rezultat që Ajnshtajnit t'i akordohej çmimi Nobel. (Ajnshtajni nuk e ka marrë çmimin Nobel për teorinë e tij të famshme të relativitetit.) Domethënia dhe rëndësia e këtyre zbulimeve teorike, nuk u vlerësua aq sa duhet në atë kohë.

Më 1910, Rutherfordi[3] kreu një eksperiment pioner. Ai bombardoi një fletë të hollë të përbërë prej atomeve të arit, me grimca me energji të lartë, ku tregoi se atomi përmban një bërthamë me ngarkesë pozitive tejet të vogël, me elektronet me ngarkesë negative që sillen rreth saj. Sipas modelit klasik të fizikës, elektronet duhej ishin grimca të vogla që sillen në orbita rreth bërthamës, në të njëjtën mënyrë sikurse planetet sillen në orbita rreth diellit, duke humbur energji në mënyrë të vazhdueshme, derisa ato të binin në bërthamë. Me fjalë të tjera, atomi duhet të ishte i paqëndrueshëm. Përsëri e vërteta nuk përputhej me modelin klasik. Tre vjet më vonë, Bohr[4] ndihmoi për të zgjidhur problemin, duke argumentuar se elektronet duhet të lëvizin nëpër orbita fikse derisa të mos devijonë për shkak të thithjes apo emetimit të një njësie të energjisë.

Atomet lëshojnë rrezatim pas ngacmimeve të ndryshme nga jashtë dhe e bëjnë këtë vetëm në gjatësi specifike vale. Siç ka thënë Ajnshtajni, çdo ngjyrë e ndryshme e dritës është e përbërë nga paketa të energjisë që janë në përpjesëtim të zhdrejtë me gjatësinë e saj të valës. Meqë konstantja e Plankut (h) është shumë e vogël, energjia e këtyre paketave është gjithashtu shumë, shumë e vogël. Për shembull, një llambë normale dritë emeton 1.020 paketa drite (fotone) në një sekondë. Një foton krijohet kur një atom ose molekulë në gjendje të ngacmuar kalon në gjendjen e saj normale (themelore). Kështu drita, e cila na lejon për të parë dhe e cila është grimca bazë e jetës, zhvillohet si rezultat i lëvizjeve (në formë vale) të elektroneve. Fizika klasike mund të shpjegojë shumë ngjarje të jetës së përditshme, por jo ato që ndodhin në nivel subatomik.

Gjatë viteve 1910-1925, fizika ra në një gjendje konfuzioni, sepse shumë nga matjet, binin në kundërshtim me të dhe nuk mund të shpjegoheshin nga teoria e përgjithshme. Kjo gjë e shtyu Paulin[5] të shprehej se ai duhej të ishte bërë më mirë një këngëtar apo lojtar bixhozi sesa një fizikant. Në mënyrë që t'u jepej shpjegim vëzhgimeve që po kryheshin, e gjithë mënyra sipas të cilës ishin kuptuar dhe konceptuar dukuritë fizike, kërkonte një rishikim themelor me metoda krejtësisht të reja.

Kjo u arrit nga Hajzenbergu,[6] një fizikant 24-vjeçar, i përshkruar nga mësuesit e tij si një person i cili merrej më shumë me thelbin sesa me detajet, një person me nivel të lartë përqendrimi dhe ambiciesh. Ndoshta suksesi i tij mund të shpjegohet nga perspektiva kritike që ai pati zhvilluar përmes leximit të veprave të figurave të tilla të mëdha si Platoni dhe Kanti, dhe që u mbështetën më vonë me njohuritë e shëndosha të cilat ai pati përftuar nga fizikantët e mëdhenj. Haizenbergu, i cili relaksohej nga puna duke u ngjitur nëpër shkëmbinj dhe duke lexuar poezi, ka thënë:

> Ishte rreth orës tre të mëngjesit kur përfundova llogaritjet dhe zgjidhja e problemit u shfaq para meje. Fillimisht kam përjetuar një tronditje të madhe. Unë isha i tendosur kështu që nuk më shkonte mendja as për të fjetur. U largova nga shtëpia dhe, i ulur mbi një shkëmb, e kam pritur ashtu lindjen e diellit.

Ashtu si shkencëtarë të tjerë të cilët themeluan fizikën kuantike, edhe Haizenbergu ishte një fizikant filozof. Filozofia që ai pranoi dhe mbrojti, dhe që e lejoi atë për të interpretuar ngjarjet atomike, është shpjeguar me fjalët e mëposhtme:

> Edhe pse është e suksesshme me fizikën klasike, gjuha që ne përdorim për të shpjeguar eventet fizike në atom apo rreth e rrotull tij, është e pamjaftueshme. Për këtë arsye, pasi të kemi kryer një matje specifike në një sistem kuantik (për shembull në një atom), duke përdorur atë dije, ne mund të përfitojmë një teori e cila të na tregojë çfarë tip rezultatesh mund të marrim në matjen e ardhshme. Por nuk është e mundur të themi asgjë në lidhje me atë që ndodh në periudhën midis dy matjeve.

Ajo çfarë e shtyu Haizenbergun të bënte një deklaratë të tillë, ishte fakti se metodat matematikore që ai përdorte për të zhvilluar një teori, e cila mund të shpjegonte mungesën e vëzhguar të vazhdimësisë së energjisë së dritës dhe atomeve, ishin koncepte abstrakte të cilat nuk ishin përdorur më përpara. Në fizikën klasike, numrat që ne njohim, ishin përdorur për t'i dhënë vlera vendndodhjes së pikës materiale, përmasave, shpejtësisë, etj. Në mekanikën kuantike të Haizenbergut, këto përmasa paraqiteshin me anë të një matrice infinit-dimensionale *nm*, e cila u lejonte fizikantëve të llogarisnin vetitë që i atribuoheshin elektroneve (energjinë, vendndodhjen, momentin dhe momentin këndor) në një shkallë të përafërt. Meqenëse këto shprehje abstrakte matematikore nuk kishin ndonjë ekuivalent në gjuhën e folur të përditshme, ato nuk mund të trajtoheshin nga këndvështrimi klasik. Është vërejtur se një eksperimentues mund të matë pozicionin e një elektroni duke ndryshuar shpejtësinë e tij. Ky problem u formulua zyrtarisht në vitin 1927 në të famshmin Parimin e Papërcaktueshmërisë së Haizenbergut.

Në mënyrë të pavarur nga Haizenbergu, Shrëdinger bëri një zbulim të rëndësishëm në lidhje me hartimin e një përshkrimi matematikor të lëvizjes së elektroneve. I frymëzuar nga hipoteza e de Broglit, formuluar vetëm 2 vjet më parë në lidhje me vetitë valore të grimcave të lëndës, Shrodingeri zhvilloi një "mekanikë valore" me anë të të cilës mund të llogaritet lëvizja e një grimce. Por pyetja themelore që mbeti pa shpjegim ishte: Cilat ishin këto "valët të grimcave të lëndës" apo "valë që shoqëronin grimcat e lëndës," kaq të çuditshme dhe origjinale?

Formulimet matematikore të shpikura nga Haizenbergu dhe Shrëdingeri janë komplementare në sensin që fizikanët përdorin atë që i zgjidh më së miri llogaritjet e veçanta të cilat ata janë duke u përpjekur për të kryer. Nuk ka asnjë hapësirë zyrtarisht të dallueshme mes shkencëtarëve dhe fenomeneve që ata kërkojnë për të kuptuar dhe manipuluar. Me fjalë të tjera,

mjetet e tyre të vëzhgimit dhe manipulimit (matematika) në disa raste parashtrojnë kuptimin (vënia në vend) e fenomeneve të vërteta, vendin e të cilave ata janë duke u përpjekur të përcaktojnë (në mesin e shumë vetive të tjera).

Krahas konceptit të Haizenbergut të një tabele të pafund rreshtash dhe pikash, për të ndërtuar pozicionin apo lëvizjen e një grimce subatomike, fizikanët dhe filozofët e fizikës filluan t'u referoheshin tabelave të ngjarjeve apo "ndodhive" në përpjekje për të shpjeguar me diçka që i ngjan gjuhës së zakonshme, idetë që ata ishin duke trajtuar. Kjo nuk mund të përshkruhej si një botëkuptim i mirëfilltë, në mënyrën se si fizika e Njutonit konfirmonte dhe mbështeste një botëkuptim, megjithatë, ajo përbën një prirje të qartë dhe të dallueshme që e pranon paplotësinë dhe pasigurinë e dijes njerëzore si një element strukturor të realitetit, në vend që të përjashtojë Zotin si forca që kurdis orën dhe pastaj heq dorë nga krijesat e Tij. Me fjalë të tjera, pasiguria nuk është një funksion i injorancës sonë të tanishme (që do të çlirohet nga njohuritë e ardhshme), por një përbërës aktual i mënyrës se si është ndërtuar realiteti.

Fizika kuantike, të paktën nga pikëpamja figurative dhe metaforike, është shndërruar në një mjet për interpretimin e koncepteve të tilla si lënda, përtej-lënda, energjia, ekzistenca dhe mosekzistenca në një mënyrë të përafërt me Burimet Hyjnore. Ajo gjithashtu i ka bërë shumë fizikantë të pastrojnë ndërgjegjen e tyre dhe të kthehen në rrugën e Zotit, i Cili njihet dhe perceptohet njëkohësisht edhe si transhendent, edhe si i kudondodhur, ngado nëpër gjithësi.

FEJA DHE SHKENCA: PËRGJEGJËSITË PËRBASHKËTA

M. Saif Islam

Çështjet e botës njerëzore, janë të ndikuara direkt dhe indirekt në shumë mënyra. Së pari, arritjet teknologjike të shkencës, e kanë transformuar aq shumë mënyrën e jetesës së njerëzve, sa është e vështirë të imagjinohet një model tjetër i rregullimit të punëve dhe jetëve tona. Së dyti, ndikimi i shkencës në jetën e njeriut ka ndikuar shumë në mendjet e njerëzve. Për shembull, ne nuk besojmë më në bestytnitë e ndryshme, të cilat kanë errësuar botën në të shkuarën.

Qëllimi i shkencës

Qëllimi i shkencës është të zbulojë rregulla që shpjegojnë marrëdhëniet ndërmjet ngjarjeve të veçanta, dhe aspekteve të tyre në botën natyrore. Ne zakonisht u referohemi të tilla rregullave, si fakte. Më konkretisht qëllimi është për të gjetur rregullat më të thjeshta dhe në këtë mënyrë të kuptojmë se kush është organizatori që qëndron pas formatit mrekullisht delikat të universit tonë. Meqë të kuptuarit e këtyre rregullave mundëson një shkallë të fuqisë parashikuese, shkenca mund të na japë fuqi mbi forcat e natyrës, të cilat janë me ndikim në marrëdhëniet që ne studiojmë.

Për fat të keq, shkenca mund të na mësojë vetëm se si janë të lidhura dhe të kushtëzuara faktet nga njëri-tjetri.Aspirata drejt njohjes së tillë objektive, i takon niveleve më të larta, për arritjen e të cilave arsyeja njerëzore është e paaftë. Megjithatë, është e qartë se njohja e asaj që është, nuk e hap drejtpërdrejt derën e asaj që *duhet të jetë*.[1] Ne mund të kemi njohuri më të qarta dhe më të

plota të asaj që ekziston dhe prapseprapë të mos jemi në gjendje për të nxjerrë një përfundim në lidhje me atë se çfarë qëllimi i aspiratës sonë njerëzore, pretendon të jetë.

Dija objektive na jep mjete të fuqishme për të arritur qëllime të caktuara, por qëllimi përfundimtar në vetvete dhe dëshira e madhe për të arritur tek ato, duhet të vijnë nga një burim tjetër. Ekzistenca dhe aktivitetet tona, e fitojnë kuptimin vetëm me vendosjen e një synimi të tillë dhe vlerave përkatëse.

> Njohja e së vërtetës në vetvete, është shumë pak në gjendje për të vepruar si një udhërrëfyes dhe ajo nuk mund të provojë as shfajësimin dhe as vlerën e aspiratës drejt asaj diturie të vërtetë. Këtu pra, ne përballemi me kufirin e konceptit thjesht racional të ekzistencës sonë.[2]

Shkenca pa fe, feja pa shkencë

Shkencëtarët e mëdhenj gjithmonë kanë pyetur: Nga ku do të vijë etika që lidhet me përdorimin e shkencës? Si mund të vendosim se cili duhet të jetë qëllimi ynë? Cila është rruga më e mirë për të gjitha qeniet njerëzore? Filozofët dhe shkencëtarët e mëdhenj janë ndier të hutuar nga këto pyetje. Disa, si Ajnshtajni, kanë shprehur pikëpamjet e tyre të paharrueshme: "Shkenca pa fenë është e çalë, feja pa shkencën është e verbër."

Në bazë të përvojës së tij shumë të pasur, Ajnshtajni pohoi se shkenca mund të krijohet vetëm nga ata që janë të mbushur tërësisht me aspiratën drejt të kuptuarit të së vërtetës dhe se burimi i ndjenjave të tilla qëndron në sferën e fesë. Ai mbrojti gjithashtu tipin e besimit që proklamon se rregullat që qeverisin botën e ekzistencës, janë racionale dhe për këtë arsye të kuptueshme për logjikën njerëzore. Ajnshtajni nuk mund ta konceptonte një shkencëtar të vërtetë pa këtë besim të thellë. Nga ana tjetër, në esenë e tij të famshme: *"Luftë atomike apo paqe",* Ajnshtajni thekson pafuqinë e shkencëtarëve për të influencuar mbi gjykimet morale:

> Unë mendoj se shkencëtarët atomikë janë të bindur se ata nuk mund ta zgjojnë dot popullin amerikan në lidhje me të vërtetën e epokës

> atomike duke u nisur vetëm nga logjika. Kësaj duhet t'i shtojnë fuqinë e thellë të ndjenjave, e cila është përbërëse themelore e fesë.[3]

Gjatë rrjedhës së tre shekujve të fundit, bota ra nën dominimin e kulturës perëndimore, mënyrës së saj të jetesës dhe të të menduarit. Kështu, bota tani është duke u ndikuar direkt dhe indirekt nga Perëndimi dhe se kontributi i kulturave të tjera për ecurinë e jetës botërore është relativisht i papërfillshëm. Pra, kur flasim për qasjen moderne të shkencës, ne mund të diskutojmë vetëm në lidhje me qasjen perëndimore, si përfaqësuesi i vetëm.

Njohuritë shkencore kanë nevojë për fenë, për t'u kthyer në një bekim për njerëzimin. Në të kaluarën, një numër shkencëtarësh arriti ta kuptonte këtë, por pastaj ata humbën kur hasën në një konflikt serioz mes fesë së tyre dhe rezultateve të studimeve të tyre shkencore. Ideja morale universale e kërkimit për njohuri objektive, ia detyron potencën e saj origjinale psikologjike, lidhjes me fenë. Megjithatë, në një kuptim, kjo lidhje e ngushtë ishte fatale për idetë morale. Rritja e madhe e shkencës natyrore, ndikoi fuqimisht në mendjet njerëzore dhe në jetën e tyre praktike. Duke parë atë që ndodhi në Perëndim, ne vërejmë se rritja graduale në përparimin shkencor, ka rezultuar në një rënie graduale në ndjenjat morale të njerëzve dhe lidhjen e tyre me fenë. Ky fenomen i përgjithshëm ishte i kufizuar në Perëndim, ndonëse ka pasur gjithashtu edhe disa incidente të krahasueshme në sferën individuale në botën islame.

Kur Kopernikut dhe Keplerit[4] iu është dashur të përballeshin me momentin e të vërtetës, ata zgjodhën një rrugë që dallonte dukshëm nga feja e tyre. Ndjenja sipas së cilës atyre u duhej të deklaronin atë që shihej qartë se përbënte të vërtetën, meqë kjo do të ishte edhe në respekt të urtësisë hyjnore, mbizotëroi, dhe kështu ata i shërbyen integritetit intelektual të njerëzimit. Qëndrimi i tyre kundër Kishës në mënyrë që të ruanin të vërtetën, në një kohë kur fryma moderne shkencore e Perëndimit ishte ende në foshnjërinë e saj, ishte një goditje e madhe për

dinjitetin e Kishës.

Që nga ajo kohë, një konflikt i cili në pamje të parë duket i papajtueshëm, ka ekzistuar ndërmjet dijes dhe besimit fetar, dhe njerëzit më të shkolluar arritën në konkluzionin se besimi fetar, duhej të zëvendësohej nga dija shkencore. Besimi, i cili nuk ishte i bazuar në njohuri shkencore, u konsiderua bestytni. Kjo mendësi solli një mënyrë negative të të menduarit në lidhje me fenë. Por problemi është më i hershëm sesa kjo mosmarrëveshje. Rrënjët e besimit perëndimor ishin judeo-kristiane dhe shumë kohë përpara se shkenca të shfaqej në Perëndim, Teurati dhe Bibla kishin humbur origjinalitetin për shkak të ndërhyrjeve njerëzore. Si rezultat, parimet themelore të besimit judeo-kristian, ishin larguar aq shumë dhe ishin bërë aq të parëndësishme për realitetet e natyrës dhe problemet e njeriut, sa ato kishin humbur të drejtën për të kërkuar ndonjë autoritet mbi dijen.

Tradicionalisht, ekziston një korrelacion midis fesë dhe moralit. Në disa qindra vjetët e fundit apo edhe më shumë, ne kemi parë një dobësim serioz të mendimit dhe të ndjenjave morale. Ky ka qenë shkaku kryesor i barbarizimit të jetës politike dhe kolektive në kohët e fundit. Ky barbarizim, së bashku me efikasitetin e tmerrshëm të teknologjisë moderne, përbën një kërcënim serioz për mirëqenien njerëzore.

Perëndimi filloi ta studionte natyrën në mënyrë të pavarur në fillim të shekullit të shtatëmbëdhjetë. Si rezultat, feja nisi ta humbiste influencën e saj në shoqëri. Pati një përpjekje për të ndarë dhe laicizuar tërë fushën e shkencës. Për fat të keq, kjo përpjekje ka pasur një efekt afatgjatë në të bërët e shkencës armik të fesë, e cila humbi respektin e saj në mesin e njerëzve të shkolluar. Në këto kohë u shfaqën shkencëtarë të mëdhenj, pa ndonjë njohuri rreth fesë apo vlerave morale. Për shkak të kundërthënieve të shumta në logjikën fetare të Perëndimit, ndikimi delikat i ndjenjave fetare filloi të venitej deri edhe në mendjet e shkencëtarëve të mëdhenj. Shumë teori kontradik-

tore u përpoqën të shpjegonin botën. Kjo është mënyra se si shkenca u bë (sipas kuptimit të fjalëve të Ajnshtajnit) "e verbër" në Perëndim. Të gjitha mjetet janë jo më shumë sesa instrumente të rëndomta, në qoftë se ato nuk kanë asnjë shpirt të gjallë pas tyre.

Që nga ajo kohë, Perëndimi i ka përqendruar energjitë e tij intelektuale në studimin e aspektit sasior të gjërave, duke zhvilluar kështu një shkencë të natyrës fizike. Frytet e dukshme të studimeve të tilla, kanë fituar popullaritet në mbarë njerëzimin kudo që ndodhet.

Shumica e njerëzve në Perëndim e identifikojnë shkencën me teknologjinë dhe aplikimet e saj. Ata kanë përfituar nga fuqia e teknologjisë dhe e përdorin atë për ta bërë jetën më të rehatshme dhe të sigurt, për të çliruar veten nga forcat e natyrës. Por shkenca nuk ka dhënë pothuajse asnjë kontribut për përmirësimin moral apo shpirtëror të tyre. Meqenëse shkenca natyrore kishte ndihmuar me sukses njerëzit që ta hedhin poshtë fenë si të paaftë për të udhëhequr mendjet racionale, asnjë burim autoritativ nuk mbeti për të udhëzuar njerëzit drejt veprave apo aspiratave fisnike. Kështu, shkenca dhe teknologjia u bënë vegla të dominimit, të drejtuara kundër pjesës tjetër të njerëzimit, mjete të përdorura për të shfarosur popuj të tjerë, për të fyer ose për të shkatërruar kulturat dhe besimet lokale, dhe për të zëvendësuar strukturat socio-ekonomike të vendosura prej një kohe të gjatë. Këto zhvillime i kanë privuar shumë njerëz indigjenë nga dinjiteti, vetëbesimi dhe udhëzimi.

Shkenca dhe shfrytëzimi

Shekulli i njëzetë dëshmoi një realitet dëshpërues: shfrytëzimin e shumicës së njerëzve nga një pakicë njerëzish të mirëpajisur shkencërisht, të cilët besonin se ata kishin të drejtën e trashëguar për kontrollin e botës. Kjo pakicë e fuqishme, kishte disa ndarje të brendshme, dhe si rezultat, konfliktet pasuese shkaktuan vuajtje të

pashembullta. Dy luftërat botërore, të ndihmuara nga përparimet më të fundit teknologjike, shkatërruaran miliona jetë njerëzish, thelluan cinizmin, dhe përshpejtuan zhdukjen e vlerave tradicionale morale në Perëndim dhe në të gjithë botën.

Fuqia e shkencës perëndimore, përkundër mendimit individual të çdo shkencëtari, është në anën e një shpërndarjeje në një përmasë monstruozisht të pabarabartë të pasurisë në botë. Shkencëtarët thonë se, edhe nëse popullsia globale do të trefishohet, të gjithë mund të ushqehen lehtësisht në qoftë se teknologjia shpërndahet bujarisht dhe përdoret siç duhet. Por realiteti është krejt ndryshe: Miliona njerëz vdesin nga uria, kequshqyerja, apo sëmundje lehtësisht të kurueshme dhe jofatale; miliona fëmijë mbeten të paarsimuar, jetojnë në varfëri të mjerueshme dhe kanë pak shpresë për një jetë më të mirë.

Njerëzit mendojnë se prosperiteti i pakufishëm material do të sjellë lehtësira qiellore në Tokë. Megjithatë, kjo ka shkaktuar ndërlikime të pafundme dhe një degradim të jetës njerëzore. Shkenca na dha fuqinë për të komunikuar në distanca të gjata, për të parë atë çfarë ishte dikur e fshehtë, për të shkuar aty ku askush nuk kishte shkuar më parë. Megjithatë, ajo gjithashtu na mori qetësinë tonë dhe paqen e mendjes dhe të zemrës, dëmtoi shqisën tonë të perceptimit estetik, dhe na shndërroi në krijesa pa ndjenja, pa emocione, dhe të mekanizuara, të ngërthyera në aspiratat për më shumë kënaqësi të kësaj bote apo lavdi të përkohshme.

Teoritë rreth jetës janë mjaft të bollshme në kohët moderne. Shumë prej tyre janë aq kontradiktore, sa njerëzit nuk besojnë më në stabilitetin apo vazhdimësinë e asaj që është e mirë dhe e vërtetë, dhe në këtë mënyrë nuk mund të ndërtojnë një kod të duhur mirësjelljeje. Njerëzit vënë në pikëpyetje gjithçka që ka lidhje me jetën. Por, aftësitë e tyre të kufizuara nuk i informojnë dot ata për ato që nuk mund të dinë, për arsye se disa pyetjeve që lindin në mendjet tona, nuk mund t'u jepet plotësisht përgjigje nëpërmjet arsyes. Vetëm feja mund të na thotë diçka dhe të na udhëzojë në lidhje me çështje të tilla.

Në Perëndim, madje edhe ata që mendojnë se fesë duhet t'i jepet një pozitë e respektuar në shoqëri, nuk janë të gatshëm ta lenë atë të dominojë të gjitha aspektet e jetës. Ata mendojnë se shkenca mund (dhe duhet) të konstatojë vetëm atë që është, por jo ajo që duhet të jetë. Feja në anën tjetër, mund (dhe duhet) të merret vetëm me vlerësimin moral të mendimit dhe të veprimit njerëzor, sepse ajo nuk mund të gëzojë të drejtën të flasë rreth fakteve apo marrëdhënieve mes fakteve. Njerëzit vërejnë një konflikt të mundshëm, kur një komunitet fetar këmbëngul në vërtetësinë literale apo të plotë të deklaratave të regjistruara në shkrimet e veta të shenjta-në këtë rast, Biblën. Kjo është fusha në të cilën zhvillohet lufta mes Kishës dhe shkencës (siç është rasti i Galileut dhe Darvinit). Nga ana tjetër, përfaqësuesit e shkencës, shpesh kanë tentuar për të arritur gjykime dhe përfundime në lidhje me vlerat themelore, në bazë të metodave shkencore. Përveç kësaj, ata e kanë bërë veten kundërshtarë të fesë formale.[5]

Qëndrimi Islam ndaj shkencës

Ne tani do të diskutojmë për qëndrimin islam ndaj shkencës, pikëvështrimin e tij të marrëdhënieve ndërmjet ligjeve natyrore (të vërtetat në të cilin shkenca moderne e mendon veten kompetente për t'u pyetur), dhe të vërtetat e fesë që, sipas Islamit, janë të arritshme dhe të kuptueshme për arsyen, edhe pse ato janë të ndërmjetësuara nga Shpallja.

Për të kuptuar shpirtin thelbësor të Islamit, një person ka nevojë të mbështetet mbi disa prej parimeve themelore të tij si uniciteti, ndikimi i fortë mbi zemrat dhe mendjet myslimane, dhe vizioni i qëllimeve përfundimtare të jetës njerëzore në këtë botë dhe në botën tjetër. Megjithatë, është e vështirë për t'i shprehur këto ide në kuptimin modern të lexuesve të cilët përdorin një tjetër mënyrë të të menduarit. Për të kuptuar këtë frymë thelbësore, është e mjaftueshme për të njohur se Zoti është Një dhe se Profeti, si marrësi dhe interpretuesi i Shpalljes dhe një simbol i krijimit, u

dërgua nga Ai.

Islami ka tri nivele të kuptimit. Së pari, të gjitha qeniet në univers janë myslimane në kuptimin se ato i janë dorëzuar Vullnetit Hyjnor. Së dyti, të gjithë njerëzit që pranojnë të ndjekin Kuranin dhe Sunetin[6] e Profetit janë myslimanë në kuptimin formal, meqenëse ata i dorëzohen me vullnetin e tyre këtyre dy burimeve. Së treti, është Islami i nivelit të njohurive dhe të kuptuarit të pastër. Ky është niveli soditës (gnostik), i cili konsiderohet si niveli më i lartë dhe më përfshirës i dorëzimit, pra kur një mysliman dorëzohet plotësisht ndaj Zotit dhe pasqyron intelektin hyjnor sipas shkallës së tij ose të saj. Duke pasur parasysh këtë, Islami e koncepton dijen dhe shkencën në një mënyrë që është rrënjësisht e ndryshme nga koncepti bashkëkohor perëndimor i kuriozitetit të jashtëm në lidhje me botën e jashtme dhe spekulimeve analitike për të kënaqur këtë kuriozitet.

Islami e bazon artin dhe shkencën në Unicitetin Hyjnor, i cili qëndron në zemër të Shpalljes. Ashtu siç veprat e mëdha të artit islamik si Alhambrat (e Spanjës Islame) apo xhamitë e Stambollit, të cilat sigurojnë elemente që të shtyjnë për të meditуar rreth Unicitetit Hyjnor të manifestuar në shumëllojshmërinë e tyre, po kështu edhe shkenca islame shpalos unicitetin e natyrës.[7] Synimi i shkencës islame në tërësi, dhe nëse flasim në mënyrë më të përgjithshme, edhe i të gjithë shkencave astronomike antike dhe mesjetare, është për të treguar unicitetin dhe ndërvarësinë e çdo gjëje të krijuar, në mënyrë që njerëzimi të mund të ecë përmes hulumtimit të unicitetit të universit, drejt parimeve të Shenjta, imazhi i të cilave është vetë njerëzimi.

Ndryshe nga shkenca perëndimore, shkenca islame kërkon të arrijë njohuri që kontribuojnë drejt përsosjes shpirtërore dhe çlirimit të atyre që janë në gjendje për të studiuar. Si rezultat, frytet e saj janë të brendshme dhe të fshehta dhe vlerat e saj janë të vështira për t'u dalluar. Për ta kuptuar këtë, çdokush duhet ta vendosë veten brenda perspektivës së saj dhe të pranojë se mjetet e saj ndryshojnë nga ato të shkencës moderne. Edhe pse shkenca

islame nuk ka pasur të njëjtin nivel arritjesh për sa i takon shkallës (ose llojit) të zhvillimit material, prosperitetit dhe dëshirës së paepur për përparim teknologjik, të shkaktuar nga shkenca moderne, kontributet e saj në matematikë, fizikë, mjekësi, biologji, gjeografi, arkitekturë, hidroteknikë, mjekësi dhe kimi, kurrsesi nuk janë të papërfillshme. Edhe ajo që është më e rëndësishmja, të gjitha këto kontribute kanë synuar të lidhin botën e këtushme me parimet themelore shpirtërore të Islamit përmes dijes.

Parimet themelore të shkencës islame janë në kundërshtim me ato të shkencës perëndimore edhe në aspekte të tjera. Për shembull, Islami thotë se natyra është një pëlhurë e simboleve për t'u lexuar dhe kuptuar sipas domethënies së tyre. Kurani është homologu i atij teksti (natyrës), i shprehur në gjuhën e njeriut. Të dyja, si natyra edhe Kurani, flasin për fuqinë e të Plotfuqishmit dhe Unicitetin Hyjnor. Kuptimi i Fuqisë së Tij, është i lidhur shumë ngushtë me kuptimin e thellë të krijimit të Tij.

Ndryshe nga Shkrimet e tjera fetare, Kurani i inkurajon të gjithë myslimanët për të lexuar dhe për të kuptuar natyrën. Ai përmban aludime, diskuton disa koncepte themelore shkencore, dhe pohon vërtetësinë absolute të të gjitha ajeteve të tij. Bucaille, një kirurg francez, pranoi se Kurani nuk përmban asnjë deklaratë të vetme që është e papranueshme, e parë nga një këndvështrim modern shkencor: "Marrëdhënia mes Kuranit dhe shkencës është *a priori* një surprizë, sidomos në faktin që ajo rezulton të jetë harmonike dhe jo përçarëse."[8] Në fakt, kjo është arsyeja përse asnjë shkencëtar mysliman nuk ka përjetuar ndonjëherë një *krizë besimi* apo *moment të së vërtetës*, të ngjashme me ato të përjetuara nga Kopernik, Galileu dhe të tjerët.

"Beso, që të kuptosh!"

Parimet islame gjithashtu thonë se shkenca, ashtu si të gjitha dijet e njeriut në përgjithësi, duhet të konsiderohet si e ligjshme dhe fisnike, vetëm nëse ajo është në vartësi të Urtisë Hyjnore.

Shkencëtarët myslimanë do të pajtoheshin me aksiomën e Shën Bonaventurës (vd. 1274): "Beso, që të kuptosh." Ashtu si ai, ata këmbëngulën se shkenca mund të ekzistojë vërtetë, vetëm në lidhje me Urtinë Hyjnore. Pra, një qasje e pavarur dhe thjesht racionaliste, kurrë nuk mund të dominojë rrjedhën e mendimit shkencor islam.

Në të kundërt, nën ndikimin e racionalizmit në rritje, Perëndimi eci përmes një serie veprimesh dhe reagimesh: Rilindja,[9] Reformacioni,[10] dhe kundër-Reformacioni[11], të cilat nuk kanë të ngjashme në botën islame. Duke qenë i çliruar nga çdo akt normativ ose vlerë shpirtërore, dhe i larguar nga Urtësia Hyjnore, Perëndimi përjetoi lindjen e një lloji të filozofisë dhe shkencës thellësisht të ndryshme nga ajo e paraardhësve të tyre mesjetare - një shkencë e natyrës, që merrej vetëm me aspektet sasiore dhe materiale të gjërave.

Ne tani do ta kthejmë vëmendjen nga burimet kryesore të frymëzimit për kultivimin e shkencës në mesin e shkencëtarëve myslimanë. Dr. Muhamed Khalid Aijazul i Universitetit të Damaskut thotë se:

> Në kontrast me 250 ajete të cilat janë të karakterit legjislativ, afro 750 ajete të Kuranit të Shenjtë, pothuajse një e teta e tërë Kur'anit, i nxisin besimtarët për të studiuar natyrën, për të reflektuar, për të përdorur në mënyrën më të mirë arsyen, si dhe për të ndërmarrë nisma shkencore, si një pjesë integrale e jetës së komunitetit.

Një shembull i tillë është:

> Ai është që krijoi shtatë qiej palë mbi palë. Në krijimin e Mëshiruesit nuk mund të shohësh ndonjë kontrast, prandaj drejto shikimin se a sheh ndonjë çarje?; Mandej herë pas here drejto shikimin, e shikimi do të kthehet tek ti i përulur dhe i molisur. (67:3-4)

Në një kuptim, ky është besimi i të gjithë shkencëtarëve, besimi që i frymëzon ata më fuqishëm. Sa më thellë që ata kërkojnë, aq më të mëdha janë çudia dhe emocionet e tyre, dhe aq më shumë shikimi i tyre (cilësitë e mendjemprehtësisë dhe të kuptuarit), kthehet tek ata i përulur. Kudo në Kuran ne ndiejmë një detyrim

ndaj dijes dhe shkencës, kur lexojmë vargje si këto:

> Në krijimin e qiejve dhe të tokës, në ndryshimin e natës dhe të ditës, ka argumente të qarta për ata që kanë arsye dhe intelekt. (3/190)

> Ne nuk i krijuam qiejt dhe tokën dhe gjithçka ka ndërmjet tyre pa një qëllim. (44/38)

Hirschfield shkruan:

> Ne nuk duhet të ndjehemi të befasuar kur zbulojmë se Kurani është gurra e shkencave. Çdo subjekt që lidhet me qiellin apo tokën, jetën e njeriut, tregtinë dhe profesionet e ndryshme është cekur herë pas here dhe kjo ka sjellë një numër në rritje të monografive të shumta, të cilat përmbajnë komentime mbi pjesë të caktuara të Librit të Shenjtë. Në këtë mënyrë Kurani ishte shkaktar i diskutimeve të mëdha, dhe për rrjedhojë, ai në mënyrë të tërthortë u bë shkak për zhvillimin e mrekullueshëm të të gjitha degëve të shkencës në botën myslimane. Madje ky proces nuk preku vetëm arabët, por nxiti edhe filozofët hebrenj për t'i trajtuar pyetjet metafizike dhe fetare sipas metodave arabe.
>
> Aktiviteti shpirtëror që gjallëronte dikur brenda kufijve islamë, nuk ishte i kufizuar vetëm për spekulimet teologjike. Njohja me shkrimet filozofike, astronomike dhe mjekësore të grekëve çoi në vënien në jetë të këtyre studimeve. Në shpalljet përshkruese, Muhamedi në mënyrë të përsëritur tërheq vëmendjen ndaj lëvizjes së trupave qiellorë, si pjesë e mrekullisë së Allahut, të nënshtruara në shërbim të njeriut dhe si të tilla, ato nuk duhet të adhurohen. [12]

Mendjet e ndritura myslimane, u përpoqën të zbulonin parimet fizike qe drejtojnë universin, sepse një ndërmarrje e tillë është pjesë e adhurimit të tyre të detyrueshëm. Ky detyrim është kaq i qartë në Kuran, sa Epoka e Artë e Islamit është e karakterizuar nga natyra e përhapur e shkencës në mbarë shoqërinë. Brian Stock ka vërejtur në përmbledhjen e tij perceptive *Shkenca, teknologjia dhe progresi ekonomik në Mesjetën e Hershme* që:

> Tipari më i dallueshëm është ... se shkenca në një formë apo një tjetër, ishte angazhimi me kohë të pjesshme ose me kohë të plotë i një numri të tillë të madh të intelektualëve, shumica prej këtyre njerëzve nuk ishin vetëm shkencëtarë; ata ishin në të njëjtën kohë universalistë, mjekë, astronomë, leksikografë, poetë dhe madje edhe teologë.

Pasi Krishtërimi u vendos në Perëndim, zonat nën kontrollin e tij ranë në barbarizëm. Megjithatë, vetëm 2 shekuj pas Profetit, bota islame nën kalifin Harun al-Rashid (sundoi 786-809), nga pikëpamja kulturore ishte shumë më aktive se në botën bashkëkohore të Charlemagne (sundoi 768-814), edhe pse kjo e fundit pati filluar më herët. Në kohën kur Kisha e kishte kufizuar zhvillimin shkencor, një numër i madh i studimeve dhe zbulimeve janë kryer nëpër universitetet islame.

Sarton, një profesor i historisë së shkencës në Universitetin e Harvardit, deklaroi në veprën e tij *Jeta e shkencës,* se themelet e shkencës moderne u hodhën nga qytetërimi i Mesopotamisë (në Irakun e sotëm), në të cilit dijetarët dhe shkencëtarët ishin priftërinjtë e asaj zone. Zhvillimi i dytë në shkencë erdhi përmes grekëve. Faza e tretë i takon rritjes meteorike të botës islame. Qytetërimit të saj që shtrihej nga Spanja deri në Indi, e pat udhëhequr botën shkencore për faktin se shumica e dijes së kohës së kaluar u shkëmbye ndërmjet dijetarëve myslimanë dhe përparoi duke u mbushur me ide dhe zbulime të reja. Duke filluar që nga shekulli i njëmbëdhjetë, dijetarët e botës kristiane, shpenzuan plot 200 vite duke përkthyer tekste arabe në latinisht. Kështu, Islami përgatiti terrenin për Rilindjen Evropiane, e cila nga ana e saj e udhëhoqi shkencën drejt zhvillimeve të reja në botën moderne.

Gjatë këtyre 400 vjetëve, për herë të parë në histori, shkenca fitoi një karakter ndërkombëtar, nëpër universitetet islame me famë botërore. Myslimanët e asaj kohe ishin më pranë frymës fetare nga ç'janë sot, gjë që provon se Islami as nuk i pengon e as nuk i frenon njerëzit më të shkolluar të epokës përkatëse të jenë edhe besimtarë, edhe shkencëtarë. Dija shkencore ishte binjakja e dijes fetare, ndaj nuk kishte asnjë arsye që kjo lloj marrëdhënieje të merrte fund.

Gjatë shekullit të njëzetë, reformatorët më të mëdhenj myslimanë u përpoqën për të predikuar mesazhin e plotë të Kuranit. Ata nuk bëjnë thirrje për kufizimin e myslimanëve vetëm në dije fetare, sepse ata e kanë kuptuar se shpërfillja e botës islame ndaj

shkencës pati bërë që myslimanët të braktisnin rrjedhën intelektuale dhe me kalimin e kohës, të humbisnin superioritetin e tyre ideologjik, social dhe politik. Dijetari i madh turk Said Nursi pohonte se suksesi i myslimanëve bashkëkohorë në lartësimin e Fjalës së Allahut, do të jetë në përpjesëtim me përparimet e tyre në shkencë, teknologji dhe qytetërim. Ai e ka paraqitur rëndësinë e shkencës me fjalët:

> Për myslimanët është një avantazh i madh fakti se Perëndimi ka ecur përpara në shkencë dhe dije, dhe për këtë arsye Islami mund t'u referohet më lehtë atyre se sa në kohët e mëparshme.[14]

Në fakt, Said Nursi është një shembull i një myslimani të vërtetë, të devotshëm, dashuria e të cilit për shkencën është deklaruar në shprehjen e tij të bukur: "Ekziston një tendencë në kozmos drejt përsosjes. Kështu krijimi i kozmosit ndjek ligjin e përsosjes."[15]

Një mentalitet i dominimit

Vendet e zhvilluara janë duke u përpjekur për të ruajtur monopolin mbi burimet dhe pasuritë e planetit. Shkencëtarët dhe intelektualë të tjerë të së shkuarës, tani janë kthyer në pronë private intelektuale e Perëndimit. Sipas Sayar:

> Edhe pse vendet në zhvillim kanë nevojë për ndihmën e vendeve të industrializuara për tejkalimin e problemeve ekonomike dhe ekologjike me të cilat përballen, këta të fundit nuk kanë ndërmend t'i ndajnë me Botën e Tretë resurset "e tyre" intelektuale; me fjalë të tjera, ata refuzojnë të transferojnë atje teknologjinë dhe dijen, megjithë nevojat e mëdha për to. Mendësia e tyre është: Ajo që është e juaja është edhe e jona, ndërsa ajo që është e jona, është vetëm e jona.[16]

Krahasojeni tani këtë, me hapjen e universitetit të parë në Evropë në Kordoba (Spanjën islame). Dituria u përhap në të gjithë Evropën nga burime myslimane. Në revistën shkencore prestigjioze *Nature*, Ghiles vëren:

> Në kulmin e saj rreth një mijë vjet më parë, bota myslimane dha një kontribut të shquar në shkencë, sidomos në matematikë dhe mjekësi.

> Bagdadi ishte në kulmin e tij dhe Spanja jugore ndërtoi universitete në të cilat u dyndën me mijëra njerëz: sundimtarët e rrethuan veten me shkencëtarë dhe artistë. Një shpirt i tillë i lirisë shkencore, i lejonte hebrenjtë, të krishterët dhe myslimanët të punonin krah për krah.[17]

Në botën islame, sipërmarrja shkencore pati një dimension ndërkombëtar. Shoqëria myslimane ishte shumë tolerante ndaj atyre që nuk i përkisnin asaj dhe të cilët kishin ide të tjera. Al-Kindi ka shkruar:

> Pra është e përshtatshme për ne që të mos na vijë turp të pranojmë të vërtetën dhe për ta asimiluar atë nga çfarëdo burimi që ajo vjen tek ne. Për ata që ngjiten drejt së vërtetës, nuk ekziston asgjë me vlerë më të lartë sesa vetë e vërteta, ajo kurrë nuk i lë në baltë apo përçmon ata që e kërkojnë atë.

Pra, qëllimi i shkencëtarëve myslimanë ka qenë për të zbuluar të vërtetën, për të mos e përdorur atë për të shfrytëzuar të tjerët, siç është bërë nga vendet Perëndimore në shekujt e fundit. Myslimanët e shihnin atë si trashëgimi e përbashkët e njerëzimit.

Gjatë shekullit të njëzetë, shumë shkencëtarë perëndimorë me influencë, e kuptuan se qëndrimi i qytetërimit të tyre ndaj shkencës, do ta çojë botën me siguri drejt katastrofës. Shumë prej tyre u përpoqën të gjenin një zgjidhje, dhe ndërkohë që bënin të tilla përpjekje, erdhën afër këndvështrimit islam. Shumica prej tyre, tani mendojnë se fesë duhet t'i jepet një shans në mënyrë që ajo të ketë impaktin e saj në normat dhe aspiratat, në një kohë kur shkenca dhe teknologjia janë shndërruar në instrumente djallëzore në duart e interesave cinike politike dhe tregtare të vendeve perëndimore.

Gjatë viteve të zymta të Luftës së Ftohtë, Ajnshtajni pati thënë:

> Ne, shkencëtarët, besojmë se ajo që ne dhe bashkëpunëtorët tanë bëjnë ose dështojnë të bëjnë, brenda disa viteve të ardhshme do të përcaktojë fatin e qytetërimit tonë. Dhe ne e konsiderojmë si detyrën tonë primare shpjegimin e kësaj të vërtete, për të ndihmuar njerëzit të kuptojnë gjithçka që është në rrezik, dhe për të punuar jo thjesht për pajtim, por për mirëkuptim dhe marrëveshje përfundimtare mes popujve dhe

kombeve me pikëpamje të ndryshme.

Në vitin 1990, në mbledhjen e një forumi global të udhëheqësve shpirtërorë dhe politikë në Moskë, Sagan[18] bëri thirrje:

> Të ndërgjegjshëm për përgjegjësinë tonë të përbashkët, ne shkencëtarët, shumë prej të cilëve të angazhuar prej kohësh në luftën kundër krizës së mjedisit, urgjentisht i bëjmë apel komunitetit fetar botëror për [bashkëpunim me] fjalë dhe vepra, dhe si për sigurimin e guximit që nevojitet, për të ruajtur mjedisin dhe tokën.

Një teori fushe e njësuar

Kjo qasje e orientuar nga feja, po fiton jehonë gjithnjë e më tepër në Perëndim. Për shembull, ne nuk kemi nevojë për t'i unifikuar forcat themelore (p.sh., gravitacionale, elektro-magnetike, të dobët dhe të fortë bërthamore) thjesht për të kuptuar se si funksionon natyra. Megjithatë, gjatë 30 viteve të fundit të jetës së tij, Ajnshtajni u përpoq për të gjetur një teori që do ta realizonte këtë. Edhe pse ai nuk mundi ta gjente dot këtë "teori të njësimit të forcave," ai kishte një besim të thellë se këto forca janë manifestime të ndryshme të së njëjtës natyrë dhe të njëjtit entitet. Hawking, një tjetër shkencëtar i shkëlqyer, e ka kaluar jetën e tij në kërkim të një teorie të njësuar dhe të vazhdueshme, që përfshin të gjitha misteret e universit në një grup ekuacionesh. Ai shprehet:

> Pastaj ne të gjithë, filozofët, shkencëtarët por edhe njerëzit e zakonshëm, do të jemi në gjendje për të marrë pjesë në diskutimin e pyetjes se përse ne dhe universi ekzistojmë. Në qoftë se ne do të gjejmë përgjigje për këtë, ky do të ishte triumfi përfundimtar i arsyes njerëzore-sepse atëherë ne do të njihnim mendjen e Zotit.[20]

Të kuptuarit (apo "leximi" siç shprehet Hawkingu) i "mendjes" së Zotit, ka qenë një nga qëllimet themelore të shkencëtarëve islamë gjatë Epokës së Artë të Islamit. Ky qëllim ishte më i lehtë për t'u ndjekur, sepse ai u mbështet nga Shpallja kuranore. Në të ardhmen, në dashtë Zoti, kurioziteti shkencor do të jetë tërësisht i motivuar dhe i udhëhequr nga Mesazhi i Allahut dhe kështu, do

të bëhet me të vërtetë një bekim për njerëzimin.

Referencat

- Bucaille, Maurice. *The Bible, The Qur'an and Science*. Indianapolis: North American Trust Publications, 1975.
- Einstein, Albert. *Out of My Later Years.* Westport, CT: Greenwood Press, n.d.
- Hawking, Stephen W A *Brief History of Time: From the Big Bang to Black Holes.* London: Bantam Press, 1988.
- Nasr, Seyyed Hossein. *Science and Civilization in Islam.* Cambridge, MA: Harvard Univ. Press, 1964.
- Nursi, Said *Hutbe-i Samiye.* Istanbul: Sinan Matbaasi, 1960.
- *Muhakemat.* Istanbul: Sozler Yayinevi, 1977.
- Sagan Carl. American Journal of Physics, vol. 58, nr. 7 (Korrik 1990): 15-19.
- Sayar, M. A. "Is Technology a Common Heritage of Mankind?" *The Fountain,* vol. 1, nr. 2 (Prill-Qershor 1993): 4-7.
- Sarton, George. *The Life of Science: Essays in the History of Civilization.* Free Port, NY: Books for Libraries Press, 1971.

DEGRADIMI MBARËBOTËROR PREJ MATERIALIZMIT SHKENCOR

Suat Yıldırım

Materializmi lindi në Perëndim në mesin e shekullit të tetëmbëdhjetë. Berkeley[1] e sajoi këtë term për shkak të një konfidence të pajustifikueshme në ekzistencën e lëndës. Termi më vonë filloi të përdorej për të identifikuar një lëvizje apo shkollë filozofike, që ia atribuonte origjinën e ekzistencës materies dhe që mohonte ekzistencën e gjithçkaje jomateriale. Termi materializëm gjithashtu mund të përdoret për të përshkruar një mënyrë jetese, e cila merr në konsideratë vetëm kënaqësitë materiale të jetës dhe rehatinë trupore, dhe shpërfill kënaqësinë e nevojave shpirtërore.

Meqenëse shkencëtarët natyrorë, studiojnë vetëm botën e dukshme dhe ndjekin një qasje ndijimore dhe eksperimentale, dhe meqë ata kanë tendencë të pranojnë si shkencore vetëm ato konkluzione të bazuara në metoda të tilla, botëkuptimi modern shkencor është mjaft i ngjashëm me materializmin. Megjithëse disa shkencëtarë mund të besojnë në Zotin dhe ekzistencën e subjekteve jomateriale (si p.sh., shpirti), tendenca moderne shkencore për nga natyra e saj është materialiste. Kështu, ne mund të themi se materializmi shkencor është më i rrezikshëm se filozofia materialiste, sepse idetë filozofike, mund të hidhen poshtë si teori duke pasur vetëm një ndikim të vogël mbi vendimet dhe jetën e dikujt. Në të kundërt, njerëzit duhet të mendojnë, besojnë dhe veprojnë në përputhje me përfundimet shkencore.

Materializmi shkencor gjithashtu ka një efekt të konsiderueshëm në mënyrën se si ne e menaxhojmë jetën tonë. Nëse ne nuk i japim asnjë rëndësi besimit në një Ditë Gjykimi, në një Qenie Su-

preme që sheh dhe dëgjon çdo gjë që ne bëjmë, që është i vetëdijshëm për çdo gjë që ne mendojmë, dhe do të na kërkojë llogari për veprat tona në këtë botë, atëherë ne do t'i kushtojmë vëmendje vetëm ligjeve laike dhe do t'i organizojmë jetët tona në përputhje me kërkesat e një jete të shkurtër, kalimtare. Për më tepër, në qoftë se të qenët shkencor do të thotë të jesh mohues ose të paktën dyshues mbi ekzistencën e çdo gjëje metafizike, dhe në qoftë se ne pranojmë zbulimet e shkencës si dije objektive dhe njohuritë fetare të sferës shpirtërore si bestytni, ne nuk kemi asnjë alternativë tjetër, përveçse për të jetuar si materialistë.

Duke pasur parasysh këto, materializmi shkencor dhe materializmi praktik që ai prodhon, janë përgjegjës, së bashku me lindjen e materializmit filozofik dhe komunizmit, për erozionin global të moralit dhe vlerave shpirtërore, rritjen e krimit dhe shkallës së përdorimit të drogës, padrejtësitë e kryera nga të fortët kundër të dobtëve, kolonializmit të pamëshirshëm që vazhdon në forma të maskuara dhe sëmundjeve të tjera moderne shoqërore dhe politike.

Edhe pse materializmi shkencor nuk e mohon (të paktën në teori) ekzistencën e të vërtetave përtej botës së dukshme, ai pranon se asgjë jomateriale nuk mund të dihet, ndryshe nga ideja se ajo mund të bëhet e njohur në të ardhmen, por nuk është e njohur për ne në këtë kohë. Filozofët materialistë mund të diskutojnë në lidhje me Ekzistencën e Zotit apo për ndonjë subjekt tjetër metafizik. Megjithatë, meqë materializmi shkencor argumenton se vetëm gjërat materiale mund të jenë të njohura, ai i bën njerëzit të mos mendojnë për vërtetat jomateriale. Ky qëndrim ka shkaktuar agnosticizëm, bindjen se vetëm gjërat materiale (të kundërta me Zotin apo gjërat metafizike) mund të jenë të njohura. Materializmi shkencor gjithashtu shkaktoi rritjen e shumicës së besimeve të rreme dhe praktikave moderne "mistike", për shkak se ai tenton t'i shpjegojë të vërtetat jomateriale në aspektin material dhe për këtë arsye zvogëlon cilësinë për sasinë dhe shpirtëroren për fiziken. Ne e vërejmë këtë më qartë në psikologji, psikiatri dhe psikoanalizë.

Materializmi praktik, një tjetër derivat i materializmit shken-

cor, tani është mbizotërues në mesin e njerëzve në mbarë botën, pavarësisht nëse njerëzit janë besimtarë apo jo. Shumica e njerëzve kanë parasysh zhvillimin ekonomik dhe përmirësimin e kushteve të jetesës kur flasin për zhvillim, duke i dhënë kështu përparësi jetës së kësaj bote. Meqenëse pasuria dhe burimet materiale shkaktojnë rivalitet dhe frymë konkurrence në marrëdhëniet ndërpersonale dhe ndërkombëtare, nuk kalon as edhe një ditë e vetme pa pasur ndonjë lloj përplasjeje apo konflikti nëpër botë.

Edhe në qoftë se nuk i llogarisim vlerat njerëzore, të vërtetat dhe idealet e larta, apo lumturinë shpirtërore, të cilat janë sakrifikuar për hir të zhvillimit material, prapseprapë qytetërimi modern i themeluar mbi materializmin shkencor, e ka dëmtuar njerëzimin. Produktet e shkencës zakonisht shfrytëzohen nga fuqitë e mëdha për të konsoliduar sundimin e tyre mbi botën. Përveç kësaj, zhvillimet në gjenetikë, biologji, fizikë dhe kimi, kërcënojnë përherë ekzistencën tonë të vazhdueshme. Qytetërimi modern, siç është vënë në dukje nga Said Nursi, është themeluar mbi pesë parime negative[2]:

- Fuqia, e cila priret drejt shtypjes.
- Rritja e ndjenjës së interesit vetjak. Kjo tendencë i bën njerëzit që të nxitojnë marrëzisht pas gjërave në mënyrë që t'i zotërojnë ato, dhe shpie në një rivalitet intensiv dhe konkurrencë gjithnjë në rritje.
- Botëkuptimi ose filozofia sipas së cilës natyra e jetës është lufta, dhe se ky realitet çon në konflikt të brendshëm dhe të jashtëm.
- Bashkimi i njerëzve mbi bazën e ndarjeve raciale, ndjenjë e cila është ushqyer nga gllabërimi i burimeve dhe territoreve të "të tjerëve" dhe që çon në përplasje të tmerrshme në mes popujve.
- Shërbimi që ai ofron është kënaqja e kapriçiove apo dëshirave të ringjallura. Ky shërbim i brutalizon njerëzit (qoftë nëse kënaqësia është e vërtetë ose jo).

Qytetërimi modern materialist nxit konsumin dhe për këtë arsye shpie në rritjen e nevojave të reja artificiale, numri i të cilave rritet ngaditë. Nëpërmjet fuqisë së propagandës dhe reklamimit për të shfrytëzuar tendenca të tilla ogurzeza, ai imponon kërkesat e tij mbi njerëzit. Jetesa sipas motos "prodho për të konsumuar dhe konsumo për të prodhuar", e shkatërron sensin tonë të një jete të ekuilibruar dhe shkakton shumë sëmundje mendore dhe shpirtërore. Një mënyrë e tillë e jetesës nuk ka hapësirë për thellësinë shpirtërore apo aktivitetin e mirëfilltë intelektual, për arsye se intelekti udhëhiqet nga pragmatizmi dhe "nevoja" për të fituar sa më tepër para.

Është shumë e diskutueshme nëse zhvillimet shkencore dhe ekonomike na kanë sjellë lumturi, nëse zhvillimet në telekomunikacion dhe transport kanë plotësuar nevojat tona dhe nëse ne kemi gjetur kënaqësinë e vërtetë dhe kemi zgjidhur problemet tona. Nevojat tona të përditshme janë rritur. Njerëzve në të kaluarën u nevojiteshin vetëm pak gjëra për të kaluar një jetë të lumtur, ndërsa ne vazhdimisht ndiejmë nevojën për të blerë gjëra të reja. Për të kënaqur çdo nevojë të re, kërkohet më shumë punë dhe prodhim, i cila, nga ana tjetër, stimulon më shumë konsumin. Kjo na bën ta shohim jetën si një garë apo proces lufte, që shpie në rritjen e një rivaliteti dhe konkurrence intensive. Kështu, meqenëse "fuqia qenka drejtësi", në një botë të tillë, vetëm të fuqishmit kanë "të drejtën" për të mbijetuar. Kjo është ideja që qëndron prapa këtyre qasjeve filozofike perëndimore apo teorive të tilla "shkencore", si ajo e evolucionit dhe seleksionimit natyror Darvinian, historicizmit, e të tjera.

Shkenca materialiste është gjithashtu përgjegjëse për shkatërrimin e vazhdueshëm të natyrës dhe ndotjen e mjedisit. Sa keq që natyra, ky libër madhështor dhe kjo ekspozitë e bukur e krijuar nga Allahu, i Gjithmëshirshmi, i Cili ia shfaqi atë njerëzimit për ta vëzhguar, studiuar, dhe për t'u ngazëllyer nga ajo, tani shihet nga shumë njerëz si asgjë më shumë sesa një grumbull plehrash apo mbeturinash. Edhe më keq, është katandisja e saj e vazhdueshme në atë që mund të quhet një djerrinë apo një plehërishte.

Ajri, ky dirigjent madhështor i urdhrave hyjnorë, tani është duke u shndërruar në një tym mbytës dhe në një vorbull të rrezikshme. Uji, ky burim i jetës dhe mirësive të tjera hyjnore, është kthyer ose në një përmbytës të rrezikshëm ose aty ku mungon, në një formues shkretëtirash të pamata. Dhe toka, si thesari e Hijeshisë dhe i Mjeshtërisë hyjnore, është kthyer në një shkretëtirë, e cila nuk është më aq produktive, madje për më tepër është bërë e paekuilibruar nga pikëpamja ekologjike.

Ne nuk ia ulim vlerat apo dënojmë studimet shkencore dhe arritjet e tyre. Përkundrazi, ne i mirëpresim ato me entuziazëm, si shenja dhe konfirmim i superioritetit njerëzor ndaj engjëjve. Kurani thekson se Allahu i ka krijuar njerëzit si qenie të cilat do të qeverisin tokën, të ndërgjegjshëm dhe në përputhje të plotë me urdhrat e Tij. Meqenëse ne zotërojmë vullnetin e lirë dhe nuk jemi të detyruar për të bërë asgjë me forcë, vetëm për këto karakteristika të cilat na lejojnë që të përmbushim funksionin tonë në krijim, Allahu na ka dalluar me dije të gjera dhe na ka bërë superior ndaj engjëjve.

Pra, ne e mirëpresim zhvillimin dhe zbulimin shkencor si pasojë e këtij superioriteti. Megjithatë, studimet shkencore mund t'i ofrojnë njerëzimit përfitime të vërteta, vetëm nëse ato kryhen nën drejtimin e rregullave jomateriale dhe metafizike, të përcaktuar nga Allahu. Qëllimi i tyre duhet të jetë krijimi i një qytetërimi të bazuar mbi parimet e mëposhtme:

- Përhapja e besimit, se është e drejta, dhe jo forca, baza reale e çdo qytetërimi të vërtetë. E drejta kërkon drejtësi dhe ekuilibër.
- Inkurajimi i njerëzve për virtytet, gjë e cila është një nxitje për dashuri të ndërsjellë dhe afinitet.
- Zhvillimi i një botëkuptimi apo filozofie, sipas së cilës natyra e jetës duhet të jetë ndihma reciproke, e cila çon në unitet dhe solidaritet, pa harruar se dhe në shmangien e luftës.
- Unifikimi i njerëzve nëpërmjet një besimi, vlerave dhe normave të përbashkëta, në mënyrë që ata të ecin drejt paqes së

brendshme dhe vëllazërisë.

- Udhëzimi i njerëzve për tek e vërteta. Progresi shkencor duhet të inkurajohet, në mënyrë që ai të mund t'i lartësojë ata nëpërmjet përsosjes morale, për në gradat më të larta të njerëzimit.

Ky është qytetërimi që Kurani propozon dhe e nxit njerëzimin që ta krijojë.

MATEMATIKA ËSHTË REALE: PSE DHE SI?

Bayram Yenikaya

Legjenda thotë se në derën e banesës së Aristotelit[1] shkruhej: "Ai që nuk di matematikë, nuk mund të hyjë." Unë nuk e di nëse kjo ka kuptimin që ata, të cilët nuk e njihnin matematikën nuk do të ishin në gjendje për të kuptuar Aristotelin, apo ishte thjesht një mënyrë për t'i nxitur njerëzit që të mësonin matematikën. Megjithatë, ne e dimë se matematika ka zënë gjithmonë një vend të rëndësishëm mendjen dhe jetën e shumë njerëzve. Teorema e famshme e Pitagorës[2] mësohet ende në shkollat nëntëvjeçare dhe ato të mesme. Çdo shekull ka kontribuar me diçka të vetën për matematikën, e cila tani është kthyer në një "gjuhë" universale, e studiuar në mbarë botën.

Ekzistojnë dy teori kryesore për thelbin e origjinës së matematikës. Njëra është ajo e cila i atribuohet Platonit,[3] dhe tjetra shkollës formaliste. Sipas Platonit, matematika ekziston e pavarur nga njerëzimi, dhe njerëzit e zbulojnë realitetin e saj objektiv, ashtu siç ne zbulojmë "ligjet e tjera të natyrës", të cilat ne priremi t'i quajmë "ligjet hyjnore të natyrës". Nga ana tjetër, shkolla formaliste pohon se matematika është një produkt i mendimit njerëzor.

Gjuha e numrave

Për të treguar ndryshimin mes këtyre dy shkollave, le të shohim mënyrën se si ato i perceptojnë numrat e thjeshtë (si p.sh., 7, 17, 41 etj), të cilët mund të pjesëtohen ose me veten ose me numrin 1 dhe me asnjë numër tjetër. Platonistët argumentojnë se numrat e thjeshtë ekzistojnë pavarësisht nga ne dhe kanë ekzistuar brenda një bashkësie me një pafundësi elementesh, qysh përpara se ne

t'i zbulonim ato. Nga ana tjetër, formalistët mendojnë se numrat e thjeshtë ekzistojnë për shkak se ato i kemi përkufizuar ne si të tillë, prandaj do të ishte e pa kuptim të vrisnim mendjen nëse ata janë të pafundëm apo jo. Ata pohojnë më tej se numrat erdhën në ekzistencë vetëm atëherë kur qeniet njerëzore filluan të numëronin. Një variant i njohur në lidhje me mënyrën se si kjo mund të ketë ndodhur, është ai që flet për një bari i cili vëndoste nga një gur në çantën e tij për çdo dele, dhe kështu mund të gjente nëse ndonjë dele ishte zhdukur, nga shoqërimi i çdo guri me nga një dele. Më vonë, njerëzit filluan t'u jepnin numrave emra të ndryshëm, dhe meqenëse dy duart e tyre kishin gjithsej dhjetë gishta, ata e patën më të lehtë për të llogaritur nëpërmejt sistemit me bazë 10. Kjo u pasua nga veprimet e mbledhjes dhe zbritjes.

Sipas formalistëve, edhe operacionet më të thjeshta matematikore, të tilla si katër veprimet themelore, përbëhen nga rregulla logjike, bazuar në aksioma të caktuara. Ata thonë se ne kryejmë veprime matematikore, duke shprehur rregulla të caktuara me anë të simboleve të caktuara. Për shembull, ne kemi marrë 5 dhe 7, një çift simbolesh kuptimi i të cilëve në botën fizike është i panjohur, dhe kemi vendosur në mes tyre shenjën plus, një shenjë e tretë kuptimi i së cilës në botën fizike është i panjohur, të pasuar nga një shenjë barazimi. Ne e dimë se duhet të shkruajnë 12 pas shenjës së barazimit, sepse aksiomat dhe rregullat e logjikës që ne jemi duke përdorur, na kërkojnë të veprojmë kështu. Kjo është pikërisht ajo që një makinë llogaritëse bën: Ajo ecën nëpërmjet operacioneve të nevojshme, pa e ditur se çfarë është duke bërë.

Le të supozojmë se mbledhja e numrave përbëhet vetëm nga aksiomat e zbatimit ose rregulla të caktuara logjike, dhe se ajo nuk ka të bëjë në mënyrë thelbësore me botën fizike. Nëse marrim simbolet e numrave tanë dhe i zbatojmë ato për objekte fizike si gurë dhe dele, ne duhet të ndjehemi të habitur kur tamam si në një mrekulli, 5 dhe 7 gurë apo dele të mbledhura së bashku (sipas të njëjtave rregulla si 5 + 7), të na japin në 12 gurë ose 12 dele. Ne do të mësonim atëherë se realitetet konceptuale abstrakte, në mend-

jen tonë, korrespondojnë me realitetin fizik në botën e jashtme.

Fizikani i njohur Paul Davies[4] ka deklaruar, se në qoftë se do të kishim jetuar në një gjithësi ku mbizotërojnë realitetet e ndryshme fizike, në një hapësirë ku nuk do të ekzistonte ndonjë gjë e llogaritshme, ne nuk do të ishim në gjendje të bënim pjesën më të madhe të llogaritjeve që bëjmë sot. David Deutsch, pretendon se numërimi doli në pah si rezultat i përvojës. Sipas tij, ne mund të merremi me aritmetikën për shkak se ligjet fizike lejojnë ekzistencën e modeleve fizike të përshtatshme për aritmetikën.

Feynman[5] i konsideruar si fizikani më i madh pas Ajnshtajnit, thotë në lidhje me matematikën, se problemi i ekzistencës është një problem mjaft intersant dhe i vështirë. Kur marrim fuqinë e tretë të numrave të caktuar dhe pastaj i mbledhim me njëritjetrin, marrim rezultate intersante. Për shembull njëshi në fuqi të tretë jep 1, 2 në fuqi të tretë jep 8 dhe 3 në fuqi të tretë jep 27. Mbledhja e këtyre 3 numrave jep 36. Shuma e 1, 2 dhe 3 është 6 dhe katrori e 6-s jep gjithashtu 36. Kur kësaj i shtoni fuqinë e tretë të 4, rezultati është 100. Shuma e 6 dhe 4 është 10 dhe katrori i 10 është 100. Nëse numri i tretë është 5, fuqia e tretë e së cilës jep 125, dhe ky numër i shtohet 100, jep 225, i cili është gjithashtu katrori i 10 plus 5, domethënë 15, e kështu me rradhë.

Sipas Feynman, ne mund të mos i kemi njohur këto karakteristika të këtyre numrave më parë, por kur vihemi në dijeni të tyre, e kuptojmë se ato ekzistojnë pavarësisht nga ne dhe kanë ekzistuar qysh përpara se ne t'i zbulonim ato. Ne nuk mund të përcaktojmë një hapësirë të caktuar për ekzistencëne tyre, sepse ne e ndiejmë këtë ekzistencë vetëm nëpërmjet konceptimeve.

Le të marrim një shembull tjetër: Ibrahim Hakë i Erzurumit, një dijetar sufi turk i shekullit XVIII dhe gjithashtu një shkencëtar, pati zbuluar një mënyrë se si të bëjmë provën e një mbledhjeje, mënyrë e cila ende sot mund të jetë e panjohur për matematikanët modernë. Në mënyrë që të kontrollohet saktësia e një mbledhjeje, mbledhim shifrat e secilit prej mbledhorëve. Për shembull,

le të mbledhim 154 me 275, shuma e saktë e të cilëve jep 429. Nëse mbledhim shifrat e secilit prej numrave, kemi 1+5+4=10 dhe 2+7+5=14. Pastaj zbresim 9 prej secilës nga dy shumat e mësipërme, që na japin përkatësisht vlerat 1 dhe 5. Hapi i tretë konsiston në mbledhjen e këtyre dy rezultateve, pra 1+5=6. Pastaj e vijojmë procedurën me shifrat e shumës që duam ta verifikojmë, pra në rastin tonë 429 dhe përsëri veprojmë njëlloj. 4+2+9=15 dhe pastaj zbresim 9: 15-9=6. Fakti që përfundimi doli i njëjtë, me një fjalë 6, tregon se mbledhja jonë është kryer saktë. Kjo metodë e provës së mbledhjes, ekziston pavarësisht nga ne. Ne nuk e kemi krijuar atë, por vetëm sa e kemi zbuluar.

Ashtu siç uji i ka ngritur peshë objektet e caktuara që përpara se Arkimedi ta zbulonte këtë, dhe ashtu siç objektet e hedhura në ajër apo një frut i shkëputur nga dega e pemës binte në tokë qysh kohë para se Njutoni të zbulonte ligjin e gravitetit, edhe numrat kanë karakteristika të shumta, ku vetëm disa nga të cilat janë zbuluar.

Fizikanti Heinrich Hertz thotë se ne nuk mund të mos mendojmë se formulat matematikore të zbuluara deri më tani ekzistojnë atje të pavarura prej nesh. Ne e dimë se këto formula kanë ekzistuar që përpara se ne t'i zbulonim ato, por ne nuk mund të përcaktojmë një hapësirë të posaçme për to. Matematikani Rudy Rucker mendon se ekziston, përveç hapësirës fizike, një hapësirë e mendjes, "*mindspace*", dhe se kjo është ajo që matematikanët studiojnë.

Matematikanët më të shquar pajtohen me pikëpamjet e Platonit. Gödel[6] është njëri prej tyre. Përpara Gödelit, ishte pothuajse një ide përgjithësisht e pranuar ajo sipas së cilës matematika është një funksion i punës së trurit të njeriut, dhe se ajo përbëhet nga mbledhja e rregullave logjikë që ne kemi krijuar ndërmjet simboleve të dy bashkësive. Ai argumentoi bindshëm se shprehjet e sakta matematikore kanë ekzistuar gjithmonë, edhe pse saktësia e tyre nuk është e mundur që të provohet gjithmonë.

Penrose,[7] një tjetër matematikan platonist, beson në ekzistencën

e të vërtetave apo realiteteve të thella në konceptimet matematikore përtej mendimeve të matematikanëve. Mendimi njerëzor është i orientuar për t'i zgjeruar në këto realitete të përjetshme, të cilat janë atje për t'u zbuluar si fakte matematikore nga dikush. Penrose citon numrat kompleksë si shembull. Sipas tij, këta numra përmbajnë një të vërtetë të thellë dhe të pakohë. Ai citon bashkësinë e Mandelbrot-it si një tjetër dëshmi e argumentit të tij. Kjo bashkësi zbulon faktin se edhe linjat, çiftet, dhe format e maleve dhe të reve, kanë qenë (ose janë) formuar në bazë të formulave të caktuara matematikore.

Çfarë na zbulojnë lulet?

Seria e Fibonacci-t gjithashtu nxjerr në pah disa gjëra interesante. E emërtuar sipas Fibonacci-t[8], një matematikan i njohur, kjo seri përmban numrat 1, 1, 2, 3, 5, 8, 13, 21, 34, 55, 89, 144, e kështu me rradhë, ku secila kufizë është e barabartë me shumën e dy kufizave paraardhëse. Pra 1 edhe 1 bëjnë 2, 1 edhe 2 bëjnë 3, 2 edhe 3 bëjnë 5, 3 edhe 5 bëjnë 8 e me rradhë. Kjo është seri që gjendet në natyrë. Për shembull, kur bëjmë numërimin e spiraleve të formuara nga fara në një luledielli, ne gjejmë se ato fara që janë të renditura sipas akrepave të orës janë 55, dhe se të tjerat, të renditura sipas drejtimit të kundërt me akrepat e orës janë 89. Të dyja këto shifra ndodhen në mesin e kufizave të njëpasnjëshme në serinë e Fibonacci-t. Ato mund të ndryshojnë sipas madhësisë së luledielit. Për shembull, ato mund të jenë 34 dhe 55 në një lule relativisht të vogël, dhe 55 dhe 89 në një lule me madhësi normale. Megjithatë, renditja është gjithmonë sipas numrave të njëpasnjëshëm të serisë së Fibonacci-t. Spiralet janë të rregulluara në një boçe pishe në pesëshe dhe në tetëshe. Ne mund të hasim në shifra të njëjta edhe në rregullimin e gjetheve të duhanit.

Një tjetër karakteristikë tejet interesante vërehet në numrat e petaleve të luleve. Një zambak ka 3 petale, ndërsa një luleverdhë ka 5 të tilla, një lulekadife ka 13, një luleshpatë 21, dhe një lulesh-

qerrë 34 ose 55 ose 89, në varësi të familjes së saj. Është e pamundur t'ia atribuosh këtë rregullim të mrekullueshëm natyrës injorante apo fatit. Nëse ADN-ja e një luledielli ose një bohçeje pishe përcakton numra të rastit për petalet apo spiralet e saj, si është e mundur të shpjegohet kjo përputhshmëri e tyre me kufizat e serisë së Fibonacci-t? Raporti ndërmjet kufizave të njëpasnjëshme të kësaj serie është afërsisht 7 me 4, i ashtuquajturi "prerja e artë" dhe i njohur në artin klasik si raporti më i kënaqshëm për syrin e njeriut. Në mënyrë që të shpjegojmë origjinën e këtij realiteti të mrekullueshëm, ne ose duhet të pranojmë se lulet e dinë se çfarë është më e këndshme për syrin e njeriut, ose se këtu është "dora" e të Vetmit, të Gjithëdijshmit, të Urtit, dhe të Mrekullueshmit, e cila është duke punuar në natyrë.

Me pak fjalë, Fibonacci zbuloi këtë karakteristikë të natyrës dhe tregoi se universi ka një rregull matematikor. Me fjalë të tjera, matematika është ajo degë e shkencës që studion rregullin e mrekullueshëm të gjithësisë, të cilin Urdhërdhënësi dhe Përcaktuesi Absolut, Ai i Cili përcakton një masë të caktuar për gjithçka, e ka krijuar.

SHËNIME[1]

Islami dhe shkenca: një vështrim i përgjithshëm

[1] Maryam Jameelah, *Modern Technology and the Dehumanization of Man* (Lahore: alMaktabat al-Arabia, 1983), 8.

[2] Hujiat al-Islam Imam Abu Muhammad al-Ghazali (1058-1111): Teolog dhe mistik i madh mysliman, vepra madhështore e të cilit *Ihjau Ulum-u al-Din* (Rigjallërimi i Shkencave Fetare), e bëri Sufizmin (misticizmin Islam) një pjesë të pranueshme të Islamit konservator. (prej kuratorit)

[3] Imam al-Ghazali, *Fatihat al-Ulum*, përkthyer dhe cituar nga Ignaz Goldziher në "The Attitude of Orthodox Islam Towards the Ancient Sciences," në Merlin L. Swartz, Studies in Islam (London: Oxford Univ. Press, 1981), 195.

[4] Jamal al-Din al-Afghani (1838-97): Politikan musliman, agjitator politik, dhe gazetar, besimi i të cilit në potencialin e një qytetërimi Islam të rigjallëruar përballë dominimit evropian, ndikoi në mënyrë domethënëse në zhvillimin mendimit islam në shekullin e nëntëmbëdhjetë dhe në fillimin e shekullit XX.

[5] Keddie, Nikki R., *An Islamic Response to Imperialism* (Berkeley: University of California Press, 1983), 107.

[6] Seyed Ahmad Khan (1817-98): Edukator mysliman, jurist, autor, themelues i Aligarh's Anglo-Mohammedan Oriental College, dhe forca kryesore udhëheqëse e Rilindjes Islame Indiane gjatë fundit të shekullit XX (red.) Al-Afghani dhe Khan ranë dakort në këtë pikë, por ishin kundërshtarë të ashpër gjetiu. Al-Afghani e akuzoi Khan se e ka shitur Islamin tek britanikët.

[7] W T Barry, *Sources of Indian Traditions* (New York: Columbia Univ. Press, 1958), 743.

[8] Ziyauddin Sardar, *Explorations in Islamic Science* (London: Mansell, 1989), 2.

[1] Shënimet në këtë kre janë përgatitur kryesisht prej kuratorit të përmbledhjes së artikujve, përveç rasteve kur është artikuluar e ndryshmja.

[9] Në ndonjë botim që ka të bëjë me Profetin Muhamed, emri apo titulli i tij pasohet nga fjalët "paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi Të," për të treguar respektin ndaj Tij dhe për shkak se ky është një detyrim fetar. Për sahabët e Tij dhe për myslimanët e tjerë të shquar, përdoret: "Allahu qoftë i kënaqur prej tij (ose prej saj)." Megjithatë, meqë kjo mund të jetë e bezdisshme për lexuesit jomyslimanë, këto fraza nuk janë paraqitur në këtë libër, me supozimin se ato nënkuptohen dhe se në këtë rast nuk bëhet fjalë për ndonjë shenjë mosrespekti.

[10] Për shembull, shih Pervez Hoodbhoy, *Islamic Science: Religious Orthodoxy and the Battle for Rationality* (London: Zed Books, 1991).

[12] Francis Chiles, "*What Is Wrong with Muslim Science?"* Nature (24 Mars 1983). Për një vështrim të përgjithshëm rreth individëve dhe arritjeve të kësaj periudhe, shih John David Yule (red.),*The Concise Encyclopedia of Science and Technology* (London: Phaidon, 1978.)

[13] George Sarton, *From Homer to Omar Khayyam*, vol. 1 i *Introduction to the History of Science* (Baltimore: The Williams & Wilkins Co., 1927), 17.

[13] Hoodbhoy, *Islamic Science*, 85.

[14] Al-Khwarizmi (780-850): Matematikan dhe astronom mysliman, veprat më madhore të të cilit mundësuan futjen e numrave hindu—arabikë dhe koncepteve të algjebrës në matematikën evropiane. Versionet e latinizuara të emrit të tij dhe titujt e librave të tij më të famshëm, janë përjetësuar në termat *algoritëm* dhe *algjebër*. (red.)

[15] Sarton, *From Rabbi Ben Ezra to ibn Rushd*, Vol. 2 pjesa 1 e *Hyrje*, 176

[16] Solomon Gandz, "The Source of al-Khwarizmi's Algebra," *Osiris* (Bruges, Belgium: The Saint Catherine Press Ltd., 1936), 1:264.

[17] Franz R. Rosenthal, *Science and Medicine in Islam* (London: Variorum Gower House, 1990), parathënie.

[18] Al-Biruni (973-1048): Një dijetar dhe shkencëtar mysliman, i cili ka dhënë të njëjtin kontribut në fizikë, metafizikë, matematikë, gjeografi, astronomi, mjekësi, astrologji, dhe histori. Gjatë udhëtimit të tij në Indi, ai mësoi filozofinë hinduiste, matematikën, gjeografinë, and teologjinë nga Panditët, të cilëve ai u mësoi shkencën dhe filozofinë greke dhe arabe. Metodat e tij shkencore, të marra së bashku me ato të shkencëtarëve të tjerë myslimanë, hodhën themelet e shkencës moderne. Ai është konsideruar si një nga shkencëtarët më të mëdhenj islamë të të gjitha kohërave. (red.)

[19] Seyyed Hossein Nasr, *Science and Civilization in Islam* (Cambridge UK: Islamic Texts Society, 1987), ix.

[20] Hoodbhoy, *Islamic Science*, 149.

[21] Ali Abdullah Al-Daffa, *The Muslim Contribution to Mathematics* (London: Groom Helm, 1977), 37. Shih gjithashtu, D. M. Dunlop, *Arab Science in the West* (Karachi: Pakistan, Historical Society, 1965), 11-12.

[22] Ahmad Y. Al-Hassan dhe Donald R. Hill, *Islamic Technology: An Illustrated History* (London: Oxford Univ. Press, 1986), 29.

[23] Hoodbhoy, Islamic Science, 77.

[24] Al-Hassan dhe Hill, *Islamic Technology*, 12.

[25] Sabian: Një popull tregtar në Arabinë e jugut, i cili fillimisht pat adhuruar trupat qiellorë, por që më pas përqafoi Krishtërimin ("Kristianët e St. John"), qysh nga koha e Profetit. Ata konsideroheshin si pjesë e "Popullit të Librit."

[26] Shih Al-Hassan dhe Hill, Islamic Technology, 13, 60-70 për një dokumentim më të zgjeruar të atyre, të cilët përhapën ide të tilla.

[27] Zijaud'din Sardar, *Islamic Futures: The Shape of Ideas to Come,* (Darul Ehsan, Malaysia: Pelanduk, 1988), 157.

[28] Hoodbhoy, *Islamic Science*, 115-16.

[29] Shën Agustini (vd. 604-605): Arqipeshkvi i parë i Canterbury; apostull i Anglisë dhe themelues i Kishës së Krishterë në Anglinë Jugore. Dy veprat e tij më të rëndësishme janë *The City of God* dhe *The Confessions*.

[30] Shën Pali (10?-67?): Hebre i shekullit të parë, i cili pasi kishte qenë një armik i betuar i Krishtërimit, u bë më vonë një figurë e rëndësishme në historinë e tij. [Megithëse ai nuk e kishte takuar kurrë Jezusin dhe as nuk kishte dëgjuar ndonjëherë predikimet e tij], ai u bë apostulli udhëheqës (misionari) i lëvizjes së re dhe luajti një rol vendimtar në përhapjen e Krishtërimit përtej kufinjve të botës hebreje, duke e kthyer atë në fe mbarëbotërore.

[31] Nicolaus Copernicus (1473-1543): Astronom polak, i cili propozoi idenë që planetet kanë diellin si pikë fikse, e cila duhet marrë si sistem referimi për rrotullimin e tyre; dhe se Toka është një planet, i cili përveçse rrotullohet rreth Diellit me periodë vjetore, rrotullohet gjithashtu brenda 24 orësh rreth boshtit të saj.

[32] John D. Yule (ed.), *The Concise Encyclopedia of Science and Technology*

(London: Phaidon Press Ltd., 1978), 245.

[33] Cituar në Hoodbhoy, *Islamic Science*, 27.

[34] Muhammad Jamaluddin El-Fandy, *On Cosmic Verses in the Qur'an* (Cairo: Supreme Council of Islamic Affairs, 1961. Shih fq. 20-25 dhe 330-37.

[35] Sardar, *Explorations*, 32-33.

[36] Maurice Bucaille, *The Bible, the Qur'an and Science* (Indianapolis: North American Trust Publications, 1978), 7.

[37] Fjala arabe *hadith*, zakonisht e përkthyer si *Tradita Profetike*, tekstualisht ka kuptimin lajme, rrëfenja, komunikim, apo bashkëbisdim, qoftë laik apo fetar, historik apo i kohëve të fundit. Në Kuran kjo fjalë shfaqet në kuptimin fetar (39/23, 68/44), në kuptimin laik apo të përgjithshëm (6/68), historik (20/9), dhe në kontekstin aktual apo bashkëbisedues (66/3). Profeti e përdori atë në sens të ngjashëm, për shembull kur pati thënë: "Hadithi më i mirë është Kurani." (Bukhari). Megjithatë, sipas Muhadithëve (Tradicionistëve [dijetarëve të Hadithit]), fjala është për "atë çfarë është transmetuar nën autorizimin e Profetit, veprat e Tij, thëniet, heshtja miratuese, apo përshkrimi i pamjes së tij fizike." Juristët nuk e përfshijnë këtë element të fundit në përkufizimet e tyre.

[38] Cituar në Sardar, *Explorations*, 34.

[39] Manzoori-i Khuda, "*Creation and the Cosmos*," Islamic Scientific Thought and Muslim Achievements: Punimet e *International Conference in Islamic Polity* (1983), 11:96113.

[40] Fazlu'r-Rahman, *Qur'anic Sciences* (London: The Muslim Schools Trust, 1981).

[41] Sardar, *Explorations*, 35-36.

[42] Sipas po aty., 42. Kjo teori mund të mos jetë e krijuar nga Khalifa. Mistiku *Ismaili* ' Ibn Hawsab al-Kufi e pat përdorur atë për të mbështetur teorinë e shtatë Imamëve plus dymbëdhjetë Huxhatëve. Por Khalifa e popullarizoi atë dhe madje zëvendësoi edhe shkronjat e Kuranit për t'u siguruar që kjo teori funksiononte. Ai shpesh shtonte një *nun* (n) dhe e zëvendësonte një *sin* me një *sad* (dy shkronja arabe), për të marrë numrin 19 apo një shumëfish të tij. Për një diskutim më të hollësishëm rreth veprës së tij, shih po aty., 37-42.

[43] Rashid Khalifa, *The Qur'an: The Final Scripture* (Tucson, AZ: Islamic Productions International, 1981), 177.

[44] Khalifa, 1985, f., 11.

[45] Khalifa, 1982, *Parathënie*.

[46] Khalifa, 1982, 88.

[47] Sardar, *Explorations* 40.

[48] Po aty.

[49] Ahmad M. Soliman, *Scientific Trends in the Qur'an* (London: Ta Ha Publishers, 1985), 3. Ai i mëshon idesë se konflikti i pretenduar mes shkencës dhe fesë, nuk ka qenë një konflikt ndërmjet parimeve themelore, por përkundrazi, ai ka ardhur për shkak të disa udhëheqësve të motivuar nga dëshira për të ruajtur interesat e tyre.

[50] Hoodbhoy, *Islamic Science*, 145.

[51] Po aty, 7.

[52] Ernest Renan (1823-92): Historian dhe kritik francez. Ai pati filluar të trajnohej për meshtar, por hoqi dorë në vitin 1845. Relativist dhe një person i interesuar për problemet themelore të natyrës njerëzore; ai e studioi fenë nga një këndvështrim historik, ndryshe nga ai teologjik. (wvvw.encyclopedia.com)

[53] Cituar në in Keddie, *An Islamic Response*, 85.

[54] Charles Darwin (1809-82): Natyralist anglez, i njohur për dokumentimin e tij të evolucionit dhe teorinë e funksionimit të tij, të (Darvinizmi). Teoritë e tij në lidhje me evolucionin, të propaganduara kryesisht në dy libra—*On the Origin of Species by Means of Natural Selection* (1859) dhe *The Descent Man, and Selection in Relation to Sex* (1871), kanë patur një ndikim të thellë në idetë shkencore të mëvonshme.

[55] Charles Darwin, *On the Origin of Species* (London: Penguin, 1985.), 458.

[56] Hoodbhoy, *Islamic Science*, 22.

[57] Po aty, 145.

[58] Seed Hossein Nasr, *The Need for a Sacred Science* (London: Curzon Press Ltd 1993), 71.

[59] Hoodbhoy, *Islamic Science*, 145.

[60] Po aty., xii.

[61] Po aty.

[62] Ahmad Mahmud Soliman, *Scientific Trends*, 1.

Shkenca dhe feja

[1] Cituar nga A. Karim në *Islam's Contribution to Science and Civilization*.

[2] Pakistan Quarterly ,Vol 4, nr. 3.

[3] Për këto citime, shih Abul Ala al-Mawdudi, *Towards Understanding Islam* (Kuwait: 11E30, 1970), 69-70, shënimi 1.

[4] Abul-Fazl Ezzati,*An introduction to the History of the Spread of Islam* (London: 1978), 378.

[5] Sir Thomas Arnoid and Alfred Guillaume (red.) *The Legacy of Islam* (Oxford UK: Clarendon, 131 [1947]), 9.

[6] *Indiculus Luminosus*, përkth. nga Dozy dhe cituar nga Ezzati, *Hyrje* 98-99.

[7] Cituar nga Ezzati, *Hyrje* , 235-37.

[8] M. Fethullah Gulen: *Understanding and Belief. The Essentials of Islamic Faith*, Izmir, Turkey, Kaynak, 1997), 309.10.

[9] David Hume (1711-76): Filozof, historian, ekonomist dhe eseist skocez, i njohur veçanërisht për empiricizmin and skepticizmin filozofik të tij. Ai besonte se asnjë teori e realitetit nuk është e mundshme dhe se nuk mund të ketë dije tjetër rreth diçkaje, përtej përvojës.

[10] Sir Karl Popper (1902-94): Filozof britanik i shkencave natyrore dhe shoqëriore i lindur në Australi, i cili i përkiste rrymës së metafizikës antideterministe, duke besuar se dija zhvillohet nëpërmjet përvojes së mendjes njerëzore.

[11] Rene Guenon, *Orient et Occident* (Istanbul: 1980), 57. Përkthyer në turqisht nga F. Arslan.

[12] Kjo ndodhi gjatë mbretërimit të Perandorit Konstantin (280?-337), perandorit të parë romak i cili përqafoi krishtërimin (312). Ai filloi ta zhvillonte perandorinë sipas parimeve të krishtera, duke e kthyer në një shtet të krishterë, dhe siguroi shtysën për një kulturë specifike kristiane, e cila përgatiti terrenin për lindjen dhe zhvillimin e kulturave bizantine dhe perëndimore mesjetare.

[13] St. Thomas (Thoma) Aquinas (1224/25-74): Teolog Domenikan Italian, dijetari më i shquar mesjetar. Megjithëse disa teologë modernë romano-katolikë nuk e konsiderojnë Shën Thomain aq gjenial, ai është i njohur megjithatë nga Kisha Katolike Romane si filozofi dhe teologu më kryesor prëndimor i asaj periudhe. (red.)

[14] Nicholas de Cusa (1401-64): Kardinal, matematikan, dijetar, shkencëtar

eksperimental, dhe filozof me ndikim, i cili e vuri thksin mbi natyrën e paplotë të dijeve njerëzore në lidhje me Zotin dhe Universin; Ptolemeu (zhvilloi veprimtarinë ndërmjet 127-45, Aleksandri [Egjipt]): Astronom i lashtësisë, gjeograf, dhe matematikan, i cili e pat konsideruar Tokën si qendrën e Universit ("Sistemi Ptolemejan").

[15] Shih Erich Fromm, *Escape from Freedom* (1982), 70-71.

[16] Pitirim A. Sorokin (1889-1968), Sociolog ruso-amerikan, i cili u pat burgosur tre herë nga regjimi carist. Pas Revolucionit të Tetorit, ai u angazhua në veprimtari antibolshevike. Ai emigroi në SHBA më (1923), dhe gradualisht u bë një profesor sociologjie në Universitetin e Minnesota-s (1924-30) dhe në Harvard (1930-55). Shkrimet e tij përshkojnë gjithë gamën e sociologjisë.

[17] Odiseu: Heroi i poemës epike me të njëjtin titull të Homerit dhe një nga figurat më të portretizuara në letërsinë perëndimore.

[18] Martin Luther (1483-1546): Prift dhe dijtar gjerman, pikëpyetjet e të cilit në lidhje me disa praktika kishtare, çuan në lindjen e Reformimit Protestant. Ai është një nga figurat qendrore të qytetërimit perëndimor, por edhe të Krishtërimit; John Calvin (1509-64): Reformatori i shquar protestant francez, dhe figura më e rëndësishme e brezit të dytë të Reformimit Protestant. Forma Kalviniste e Protestantizmit, mendohet të ketë patur ndikimin më të madh në themelimine botës moderne.

[19] Roger Bacon (1220-92): Filozof françeskan anglez, reformator në fushën e arsimit, dhe një figurë udhëheqëse e shkencës eksperimentale gjatë periudhës së mesjetës.

[20] Rene Descartes (1596-1650): Matematikan, shkencëtar, dhe filozof francez; i njohur si «babai i filozofisë moderne» për shak se ai ishte njëri nga të parët që iu kundërvunë Aristotelizmit skolastik. Ai e nisi nga dija metodologjikisht e dyshimtë, e bazuar në autoritetin, shqisat dhe arsyeja, dhe gjeti siguri në intuitën që ekziston kur dikush është duke menduar. Kështu, sipas tij: «Unë mendoj, prandaj ekzistoj.»

[21] Zoti i përdor engjëjt sepse Dinjiteti dhe Madhështia e Hyjnisë, kërkon që njerëzit të mos ia atribuojnë direkt Zotit atë çfarë atyre iu duket e papranueshme dhe në këtë mënyrë ta akuzojnë padrejtësisht Atë.

[22] Seyyed Hossein Nasr, *Man and Nature* (London : 1976) , 94-95.

[23] Jacques-Yves Cousteau (1910-97): Oficer marine francez dhe eksplorues oqeanesh , i njohur për studimet e tij të thelluara nënujore. (red.)

[24] *Sahih al Muslim* "Fitan," 110; *Sunan al-Tirmidhi* 'Fitan," 59.

Rastësia dhe botëkuptimi kur'anor

[1] Sipas fesë Islame, ato janë Kur'ani, dhe forma origjinale e Biblës, Teurati, Zeburi (Psalmet e Davidit), dhe "Fletët" e shpallura Abrahamit.

Çfarë domethenieje ka guri që bie nga lart

[1] Në këtë artikull unë nuk i kam marrë në konsideratë forcat e tjera themelore si atë elektromagnetike dhe bërthamore, të cilat kanë një efekt përcaktues në lëvizjen e objekteve. Të shprehura nëpërmjet formulave të caktuara matematikore, këto forca e bëjnë lëvizjen në univers edhe më të ndërlikuar.

[2] Said Nursi (1877-1960): Një nga dijtarët bashkkëkohorë më të mëdhenj myslimanë; të cilit shpeshherë i është atribuuar merita e ruajtjes së Islamit në Turqi gjatë një periudhe sekularizmi të detyruar dhe terrori zyrtar ndaj çdo shfaqjeje personale apo shoqërore të Islamit.

[3] Dukuria e tërheqjes është ngjarja më e thjeshtë e cila mund të ndodhë në univers. Merreni me mend tani mënyrën se si bleta bën mjaltin apo lopa prodhon qumështin, dukuri të cilat përmbajnë shumë më tepër lloje bashkëveprimesh, reaksionesh kimike, si dhe shkaqe-pasoja.

Universi nën dritën e fizikës moderne

[1] Max Planck (1858-1947): fizikan gjerman i fizikës teorike, i cili gjeneroi teorinë kuantike, me të cilën fitoi Çmimin Nobel për Fizikë në vitin 1918. Kjo teori revolucionarizuoi të kuptuarit tonë të proceseve atomike dhe subatomike.

[2] Albert Einstein (1879-1955): fizikant gjermano-amerikan, i cili ka zhvilluar teorinë speciale dhe atë të përgjithshme të relativitetit, i cili fitoi Çmimin Nobel për Fizikë në vitin 1921 për shpjegimin e tij të efektit fotoelektrik.

[3] Ernest Rutherford (1871-1937): fizikan britanik, i cili hodhi themelet për zhvillimin e fizikës bërthamore. (red.)

[4] Niels Bohr (1885-1962) fizikan danez, i cili ishte i pari që aplikoi teorinë kuantike e cila kufizon energjinë e një sistemi në vlera të caktuara diskrete, për problemin e strukturës atomike dhe molekulare. Për arritjet e tij, ai mori Çmimin Nobel për Fizikë në vitin 1922. Ai zhvilloi të ashtuquajturën Teoria e Bohrit e atomeve dhe modelin e lëngët të bërthamës

atomike.

[5] Wolfgang Pauli (1900-1958); Fizikant i lindur në Austri, fitues i Çmimit Nobel për Fizikë në vitin 1945 për zbulimin e tij të vitit 1925 të parimit të përjashtimit, i cili thotë se në një atom, dy elektrone nuk mund të kenë të njëjtën gjendje kuantike njëkohësisht. Ky parim lidhet në mënyrë të qartë me teorinë kuantike të vetive të vërejtura të atomeve.

[6] Werner Karl Heisenberg (1901-1976): fizikan dhe filozof gjerman, i cili zbuloi një mënyrë për të formuluar mekanikën kuantike me ndihmën e matricave (1925). Në 1927 ai botoi Parimin e tij të Papërcaktueshmërisë (ose pasigurisë) parim, mbi të cilin ai ndërtoi filozofinë e tij dhe për të cilat ai është i mirënjohur.

[7] Erwin Shrödinger (1887-1961): fizikan austriak i fizikës teorike, i cili kontriboi në Teorinë valore të materies dhe në bazat e tjera të mekanikës kuantike. Bashkëfitues i Çmimit Nobel për Fizikë 1933.

[8] Louis Victor de Broglie (1892-1987): fizikant francez, i mirënjohur për kërkimin e tij në teorinë kuantike dhe për zbulimin e tij të natyrës valore të elektroneve. Ai u nderua në vitin 1929 me çmimin Nobel për Fizikë.

Feja dhe shkenca: Përgjegjësitë e përbashkëta

[1] Albert Einstein, *Out of My Later Years* (Westport, CT: Greenwood Press), 26.

[2] Po aty, 22.

[3] Po aty.

[4] Johannes Kepler (1571-1630): astronom gjerman, i cili zbuloi tri ligjet kryesore të lëvizjes planetare: (1) forma e orbitës së çdo planeti, është një elipsë me diellin në njërën prej vatrave; (2) Një shpjegim sasior se sa shpejtësia e një planeti të rritet ndërkohë që distanca e tij nga dielli zvogëlohet; dhe (3) lidhja në mes të distancës mesatare të planetit nga dielli (gjysmëboshti i madh i elipsës) dhe kohës që nevojitet për të kryer një rrotullim të plotë rreth diellit (perioda). Këto ligje hapën rrugën për zhvillimin e mekanikës qiellore, domethënë aplikimin e ligjeve të fizikës në lëvizjet e trupave qiellorë. Puna e tij është një shenjë e qartë e treguesve kryesorë të teorive të mëdha shkencore si: thjeshtësia dhe universaliteti.

[5] Einstein, *Later Years*, 22.

[6] Suneti është regjistrimi i çdo fjale, vepre, dhe konfirmimi të të Dërguarit,

si burimi i dytë i legjislacionit dhe organizmit të jetës islame (i pari është Kurani). Përveç krijimit të parimeve dhe rregullave të reja, Suneti sqaron paqartësitë në Kuran duke u zgjeruar mbi atë që është përmendur vetëm shkurtimisht në të, specifikon se çfarë është e pakushtëzuar, dhe mundëson përgjithësime nga ajo që është deklaruar në mënyrë specifike dhe specifikime nga ajo që është deklaruar përgjithësisht.

[7] Seyyed Hossein Nasr, *Science and Civilization in Islam* (Cambridge, MA: Har-vard Univ. Press, 1964), 35.

[8] Maurice Bucaille, *The Bible, the Qur'an, and Sc*ience (Indianapolis: North American Trust Publications, 1975), no. 9.

[9] Rilindja: Periudhë në të cilën ka ecur qytetërimi evropian menjëherë pas Mesjetës. Pranuar përgjithësisht të ketë qenë karakterizuar nga një rritje e interesit në të mësuarit e dijes klasike dhe vlerave, ajo filloi në Itali në vitet 1300 dhe zgjati deri në vitet 1600. (red.)

[10] Reformimi: Revolucioni fetar brenda kishës perëndimore në shekullin XVI; drejtuesit e tij më të mëdhenj ishin Martin Luteri dhe John Calvin. Efektet e tij shumë të gjera politike, ekonomike, dhe sociale u bënë baza për themelimin e protestanizmit, një nga tri degët e mëdha të krishtërimit.

[11] Kundër-Reformacioni: Gjithashtu i njohur si Reformacioni katolik apo Ringjallja katolike, një periudhë që u shtri ndërmjet shekujve XVI dhe fillimit të shekullit XVII, kur Kisha Katolike Romake, i drejtoi përpjekjet e saj kundër Reformimit Protestant dhe drejt rinovimit/reformimit të brendshëm.

[12] Hirschfeld, *New Researches into Composition and Exegesis of the Qur*'an, 1902.

[13] George Sarton, The Life of Science: *Essays in the History of Civilization* (Free Port, NY: Books for Libraries Press, 1971), 146-66.

[14] Said Nursi, *Hutbe-i Samiye* (Istanbul: Sinan Matbaasi, 1960), 78.

[15] Said Nursi, *Muhakemat* (Istanbul: Sozler Yayinevi, 1977), 13.

[16] M. A. Sayar, "*Is Technology a Common Heritage of All Mankind?*" The Fountain vol. 1, nr. 2 (Prill-Qershor 1993): 4.

[17] Francis Ghiles, "What Is Wrong with Muslim Science?" Nature (24 Mars. 1983).

[18] Carl Sagan (1934-96): Astronom dhe autor shkencor amerikan. (red.)

[19] Stephen Hawking (1942 -): fizikan teorik anglez, teoria e eksplodimit

e vrimave të zeza të të cilit, shtrihet si mbi teorinë e relativitetit ashtu edhe mekanikën kuantike. Ai gjithashtu ka punuar në veçantitë e hapësirë-kohës.

[20] Stephen W. Hawking, *A Brief History of Time: From the Big Bang to Black Holes* (London: Bantam Press 1988), 175.

Korrupsioni në mbarë botën prej materializmit shkencor

[1] George Berkeley (1685-1753): peshkop anglikan anglo-irlandez, filozof dhe shkencëtar, i mirënjohur për filozofinë e tij empirike, e cila thekson se gjithçka shpirtërore ekziston vetëm për aq sa është perceptuar nga shqisat. (red.)

[2] Said Nursi, *The Letters* (London: Truestar, 1995), 2:310.

Matematika është reale: Pse dhe si?

[1] Aristoteli (384 pes-322 pes) filozof dhe shkencëtar grek, një nga dy figurat më të mëdha intelektuale të filozofisë së antikitetit grek (tjetri është Platoni).

[2] Pitagora (580 pes-500 pes): Filozof grek, matematikan, dhe themeluesi i vëllazërisë pitagoriane, që edhe pse fetare në natyrë, formuloi parimet që ndikuan mbi Platonin, Aristotelin, dhe zhvillimin e matematikës dhe filozofisë racionale perëndimore. Teorema e tij: Shuma e katrorëve të gjatësive të kateteve të një trekëndëshi kënddrejtë, është e barabartë me katrorin e gjatësisë së hipotenuzës.

[3] Platoni (428/27 BCE-348/47 pes) filozof grek, i dyti i treshes së madhe të grekëve të lashtë: Sokrati, Platoni dhe Aristoteli, të cilët së bashku hodhën njëfarësoj themelet filozofike të kulturës perëndimore. Duke u bazuar mbi jetën dhe mendimet e Sokratit, ai ka zhvilluar një sistem të thellë dhe të gjerë të filozofisë.

[4] Patti Davies, fizikan matematik dhe profesor i filozofisë natyrore në Universitetin e Adelaide (Australi); marrësi i 1995 i Çmimit *Templeton* për Progres në Religjion, për përpjekjet e tij për të zgjidhur dikotominë shkencë-fe.

[5] Richard Feynman (1918-1988) fizikan teorik amerikan, ndoshta figura më e shkëlqyer, me më ndikim, dhe ikonoklastik i pas Luftës II botërore në fushën e tij. Ai e ribëri nga e para Elektrodinamikën kuantike -Te-

orinë e ndërveprimit në mes të dritës dhe materies- dhe kështu ndryshoi mënyrën se si shkenca e kupton natyrën e valëve dhe grimcave.

[6] Kurt Gödel (1906-1978): matematikan austriak i lindur në SHBA, lëvrues i logjikës matematike, dhe autor i teorisë Gödel, e cila deklaron se në çdo sistem të mbyllur matematik, ekzistojnë pohime (apo pyetje) që nuk mund të provohen ose të hidhen poshtë në bazë të aksiomave brenda atij sistemi.

[7] Roger Penrose: (1931 -): matematikan dhe relativist britanik, i cili, në vitet 60, llogariti shumë nga tiparet themelore të vrimave të zeza.

[8] Leonardo Fibonacci (1170- 1240): Matematikan mesjetar italian i cili shkroi *Liber Abac*i (1202: Libri i Abacisë), vepra e parë evropiane rreth matematikës indiane dhe arabe. I njohur në anglisht si Leonardo i Pizës.